



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

T R A N S K R I P T

**I MBLEDHJES SË JASHTËZAKONSHME TË KUVENDIT TË REPUBLIKËS
SË KOSOVËS, E MBAJTUR MË 20 DHJETOR 2016**

**SA VANREDNE SEDNICE SKUPŠTINE REPUBLIKE KOSOVA,
ODRŽANE 20 DECEMBRA 2016. GODINE**

**DHJETOR - DECEMBAR
2016**

Rendi i ditës

1. Debat parlamentar lidhur me rastin “Astrit Dehari”, sipas kërkesës së 40 deputetëve nënshkrues

Dnevni red

1. Parlamentarna rasprava o slučaju Astrit Dehari, na zahtev 40 poslanika - potpisnika

Mbledhjen e drejtoi kryetari i Kuvendit, z. Kadri Veseli.

KRYETARI: Të nderuar kolegë deputetë,

I hap punimet e seancës së jashtëzakonshme të Kuvendit të Republikës së Kosovës me kërkesë të 40 deputetëve.

Fillojmë me rendin e ditës:

1. Debat parlamentar lidhur me rastin e Astrit Deharit, sipas kërkesës së 40 deputetëve nënshkrues

Të nderuar deputetë,

Grupi prej 40 deputetëve të Kuvendit të Republikës së Kosovës, në bazë të nenit 69, paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe nenit 38 të Rregullores së Kuvendit ka parashtruar kërkesë për mbajtjen e seancës së jashtëzakonshme lidhur me rastin e Astrit Deharit.

Ju njoftoj se Kryesia e Kuvendit, në mbledhjen e përbashkët me kryetarët e grupeve parlamentare, të mbajtur më 19 dhjetor 2016, e ka shqyrtuar rekomandimin e Komisionit për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, për Persona të Pagjetur dhe Peticione lidhur me peticionin e qytetarëve të Kosovës për zbardhjen e rastit të Astrit Deharit.

Kryesia e Kuvendit, bazuar në Rregulloren e Kuvendit, shtojca numër 2, fushëveprimi dhe përgjegjësitë e komisioneve parlamentare, pika 12, ka vendosur që lidhur me peticionin e qytetarëve të Kosovës për zbardhjen e rastit të Astrit Deharit, në rast se komisioni e vlerëson të arsyeshme, mund ta autorizojë kryetarin e komisionit që të paraqesë një deklaratë në seancë plenare të Kuvendit.

Shtojca numër 2: Fushëveprimi dhe përgjegjësitë e komisioneve parlamentare, pika 12.

Nën a): Pranohen për shqyrtim peticionet, të cilat janë bërë me shkrim, e kanë emrin e dërguesit dhe nënshkrimet përkatëse, janë të kuptueshme dhe tregojnë qartë objektin e tyre.

Dhe, jo më vonë se dy javë pune nga dita e marrjes së peticionit kryetari i komisionit e paraqet peticionin në komision, duke propozuar njëkohësisht edhe mënyrën e zgjedhjes ligjore ose mospranimin e peticionit.

Në rast se komisioni e vlerëson të arsyeshme për zgjidhjen e çështjes mund të autorizojë kryetarin e komisionit të paraqesë deklaratën në mbledhjen plenare të Kuvendit.

E ftoj kryetarin e Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike të Kosovës, zotin Zenun Pajaziti, që në emër të 40 deputetëve nënshkrues të paraqesë çështjen për të cilën është kërkuar debati.

ZENUN PAJAZITI: Faleminderit, zoti kryetar i Kuvendit!

Zonja ministre,

Kolegë deputetë,

Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike ka mbështetur nismën e deputetëve për të bërë një debat për rastin “Dehari”. I falënderojmë të gjithë deputetët që kanë nënshkruar.

Dua të sqaroj arsyetimin pse këtë debat parlamentar tash, meqenëse është fjala për një rast, i cili ende trajtohet nga institucionet e drejtësisë. Pra, nuk është asnjëherë mirë që në Parlament të debatohen raste të tilla, por se kemi pasur edhe të tjera raste, për të cilat deputetët e Parlamentit të Kosovës i kanë ngritur shqetësimet e tyre dhe të qytetarëve.

Dua të sqaroj po ashtu se kohë më parë nga Lëvizja “Vetëvendosje” është kërkuar një debat i tillë dhe ne kemi hezituar të bëjmë në atë kohë për shkak se ishim të interesuar të kemi edhe rezultate të mjekësisë ligjore, pra të ekspertëve, institucioneve përkatëse, në mënyrë që ta kishim më të ndriçuar rastin për të cilën ne sot po debatojmë.

Por, ne jemi këtu dhe sot i ftoj të gjithë që të jenë sa më korrektë dhe të bashkuar rreth trajtimit të një rasti që është shumë i ndjeshëm, një rast i cili më shumë se gjithçka tjetër duhet të ndriçohet, të ketë drejtësi, të trajtohet nga institucionet e drejtësisë dhe sa më pak ne këtu ta trajtojmë politikisht ose, për më tepër, të shfrytëzohet për motive dhe agenda politike.

Sidoqoftë, zonja dhe zotërinj,

Të nderuar deputetë,

Fatkeqësisht, pra, sot në Kuvendin e Republikës së Kosovës duhet të debatojmë për Astrit Deharin, për një qytetar të Kosovës, i cili në një fazë të jetës së tij gjendej brenda institucioneve të shtetit, pra edhe sipas ekspertizës së fundit vdekja e gjeti në burgun e Prizrenit.

Besoj që sot dhimbjen e familjes dhe të dashurve të viktimës nuk duhet ta lëndojmë edhe më shumë me debatin, tashmë të kërkuar edhe nga shumë qytetarë të Republikës së Kosovës.

Për këtë ne i shprehim edhe një herë ngushëllimet tona, por njëkohësisht shprehim edhe vullnetin dhe besimin tek organet kompetente që të punojnë në ndriçimin sa më të shpejtë të rastit dhe vënien në vend të drejtësisë.

Në njërën anë, dua të theksoj, pra, dhe ta bëj maksimalisht të qartë se ne jemi të gatshëm, në kuadër të kompetencave tona, të bëjmë krejt çka është e mundur që rasti të qartësohet deri në fund.

Ne duam si grup parlamentar po ashtu të kuptojmë se çka ka ndodhur me jetën e një të riu, pa marrë parasysh se a ishte apo nuk ishte i ndjeri në aktivitete për të cilat hetohej si i involvuar.

Megjithatë, jeta e një të riu pa marrë parasysh qëllimet, motivet, formën e jetës dhe përcaktimet politike e shoqërore është shumë e vlefshme dhe sidomos është edhe më e vlefshme kur ajo jetë është në duar të shtetit, pra, ne të gjithë duhet të na interesojë për secilën jetë, e cila përfundon kur ajo është në dorën e shtetit.

E menjëherë dua të shpreh, pra të betonoj interesimin tonë se ne duam saktësisht të dimë se çka ka ndodhur me Deharin, i cili jetën e tij e përfundoi në burg.

Sot, të nderuar deputetë, kërkoj nga të gjithë ju që gjithçka që keni për ta thënë, gjithçka që keni për ta treguar, ta tregoni këtu me korrektësi dhe të dalim nga këtu jo me dilema, por për t'i sqaruar dhe për t'i qartësuar të gjitha ato që kemi për t'i thënë, sidomos për rastin e Deharit. Gjithçka që e ka shtyrë atë të shkojë në burg, gjithçka që e ka shtyrë atë të shkojë deri te ai akt, gjithçka që ka bërë që ai sot të mos jetë në mesin e familjes së tij, në mesin e miqve të tij.

Unë besoj shumë se insistimi permanent i të gjithëve, por edhe i shoqërisë në tërësi duhet të ketë një kërkesë. Ajo kërkesë është që ne të jemi korrektë dhe në vazhdimësi të informuar nga institucionet përkatëse për të gjitha detajet e rastit.

Çka sot duam dhe çka ne mund të kontribuojmë është që në këtë debat, pra, të gjithë ne pa dallim, që paragjykimet, projeksionet, hamendjet dhe emocionet të mos i përfshijmë në kërkesën për qartësimin e rastit. Ne duam të gjithë vetëm një gjë: vetëm drejtësi! Nëse e arrijmë këtë qëllim, për qytetarët e Kosovës do të thotë se ne jemi duke punuar së bashku për të sqaruar një nga rastet më të vështira të kësaj natyre.

Qytetarët e Republikës së Kosovës, por më së shumti familja presin nga të gjithë ne të jemi të saktë, të matur dhe të qartësojmë, e jo të komplikojmë. Komplikimi shkakton dyshim, pasiguri dhe frikë te qytetarët, ndërsa qartësia ndërmjetëson, sjell besim, drejtësi dhe mundësi të tjera për të ardhme më të mirë.

Ne mendojmë që debati për rastin e Astrit Deharit duhet të jetë debat më shumë se sa ky debat në Parlamentin e Kosovës.

Ky debat nuk duhet të reduktohet vetëm mes deputetëve. Ne nuk kemi dëshirë që ky debat të përfundojë dhe të reduktohet vetëm si një debat mes parlamentarëve dhe partive politike. Ky debat gjithsesi duhet të jetë debat edhe i profesionistëve, i sociologëve, psikologëve, pedagogëve, kriminologëve dhe disiplinave të tjera, të cilat mund të kontribuojnë në qartësim. Pse po e them

këtë? Jo vetëm për rastin “Dehari”, por kohët e fundit ne jemi të ballafaquar me vdekjen e të rinjve, shumë prej tyre janë përfshirë edhe në luftëra jashtë vendit.

Pra, në debatin për të rinjtë, për formën e jetës, për stilin e jetës, ideologjitë, keqpërdorimet duhet të instalohen profesionistët e lëmenjve të ndryshëm, duhet të ndihmojnë shoqërinë dhe politikën me kyçjen e tyre, me sqarimet e me kontributin e tyre.

Ne duhet të qartësohemi si shoqëri në tërësi, vetëm një qartësim i këtij rasti do të kthejë ose do të forcojë besimin në shtetin, besimin në pushtetin dhe qytetarët e saj.

Ky debat nuk duhet të zhvillohet si debat mbi moralizimin ose për moralizimin me njëri-tjetrin.

Ne, ditët e fundit kemi dëgjuar shumë për termin “në duar të shtetit”.

Ne zonja dhe zotërinj, pak a shumë “në duar të shtetit” jemi çdo kund: në trafik, në shkollë, në spitale, në burgje. Ky shtet i krijuar me mund dhe me sakrificë dhe i menaxhuar nga vota e qytetarëve të saj çdo ditë e më shumë po ndërtohet, në ndërtim e sipër ka shumë të arritura, por ka edhe shumë sfida, e sfidat janë të natyrave të ndryshme, e një ndër to është edhe përgjegjësia që njerëzit kanë përgjegjësi institucionale, njerëz të edukuar në këtë vend, prej të cilëve pritet edhe më shumë. Pra, të jenë më të përgjegjshëm të gjithë ata kudo që janë.

Në këtë pikë, pra, duhet të zgjerohet debati ynë. Ne kemi në institucionet tona shumë njerëz të përgjegjshëm dhe të edukuar, të cilët duhet ta shtojnë përgjegjësinë dhe llogaridhënien e duhet, t’i kryejnë detyrat e tyre sa më mirë që do të mundën.

Ne jemi të vetëdijshëm se një pjesë e shoqërisë ka kërkuar dhe ka sensibilizuar strukturat politike, por të mos harrojmë dhe duhet të jemi të gatshëm të debatojmë edhe për motivet e të rinjve për të sakrifikuar pa marrë parasysh si dhe për çka.

Ne urgjentisht duhet të debatojmë se cili është mandati i partive politike, ku është kufiri mes asaj se si thuhet diçka, çka thuhet dhe cilat janë format apo modelet e zgjidhjes së problemeve shoqërore?

Ne jetojmë në Republikën tonë në një fazë ku deklaratimet janë të pamatura, shpesh ofendimet dhe kërcënimet janë bërë pjesë e retorikës, janë bërë norma shoqërore. Ne jemi duke jetuar në një kohë ku çdo gjë e krijuar me shumë mund e sakrificë mund të devalvohet dhe të mos ketë aspak rëndësi e vlerë. Këtë ne nuk ua kemi borxh të rinjve, gjeneratës së re të Republikës së Kosovës.

Të nderuar qytetarë,
Dhe të nderuar deputetë,

Ekspertiza që së fundmi doli nga institucionet e Republikës së Kosovës për rastin “Dehari” nuk ishte fundi i debatit, pra edhe më pastaj kishte diçka që ishte kontestuar, edhe një ekspertizë tjetër ose edhe një koment ose një dokument tjetër i një grupi ekspertësh.

Ne si grup parlamentar jemi të prirë t’u besojmë ekspertëve dhe institucioneve përkatëse të Republikës së Kosovës edhe për rastin “Dehari”. Por, meqenëse debatet janë të pafundme, ne jemi të gatshëm të kërkojmë ose të pajtohemi nëse një kërkesë e tillë del nga deputetët e Republikës së Kosovës, nga Kuvendi i Kosovës, që të kemi edhe një ekspertizë shtesë ose një super ekspertizë nga institucione kredibile ndërkombëtare apo kushdo qofshin ato, në mënyrë që një herë e mirë të sqarohet ky rast dhe të sqarohen përgjegjësitë e secilit që ka për gjithçka që ka ndodhur, për gjithçka që e ka shtyrë Astrit Deharin të gjendej aty, për gjithçka që e ka shtyrë të vijë deri te ai rast dhe përgjegjësinë e secilit person në institucionet e Republikës së Kosovës.

Pra, edhe një herë ju falënderoj dhe ju ftoj që të jemi sa më korrektë dhe të dalim nga këtu me një qëndrim, në mënyrë që rasti “Dehari” të jetë sa më i sqaruar, në mënyrë që të jetë një lehtësim edhe për familjen, edhe për miqtë e Astrit Deharit. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, i nderuar kryetar i Grupit Parlamentar, Zenun Pajaziti! Tani e ka fjalën kryetari i Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike të Kosovës, zoti Ismet Beqiri.

ISMET BEQIRI: Faleminderit, zoti kryetar!

Të nderuar kolegë deputetë,

I nderuar kryeministër Mustafa,

Lidhja Demokratike e Kosovës edhe sot, në këtë fillim të kësaj seance, shpreh keqardhjen dhe ngushëllimet për vdekjen e Astrit Deharit.

Ne si Lidhje Demokratike e Kosovës, deputetët tanë, besoj edhe të gjithë qytetarët e Kosovës prej momentit të vdekjes së të riut Dehari kemi qenë të interesuar të dihet dhe të thuhet e vërteta e vdekjes së tij.

Asnjëherë nuk kemi qenë që kjo temë të mos shtrohet edhe në Kuvend, por kjo të ndodhë pasi ta thonë fjalën e tyre organet kompetente, në këtë rast mjeku ligjor dhe ato hetimore, edhe pse kjo e fundit ende nuk ka përfunduar, sigurisht.

Në asnjë rast, në asnjë rrethanë nuk kemi qenë dhe nuk jemi që të marrim rolin e atyre që neve nuk na takon, që nuk e kemi, të marrim rolin e mjekut, hetuesit, prokurorit, gjykatësit, sepse ne kemi punuar me gjenerata e gjenerata që t’i kemi institucionet shtetërore. Ne dikujt duhet t’i besojmë, jo t’i besojmë asaj çka ne kemi dëshirë, çka neve na pëlqen, por t’u besojmë fakteve dhe argumenteve, nëse edhe ato, sipas dikujt, nuk mjaftojnë.

Duhet kërkuar rrugë ligjore, argumentuese, ato të kundërshtohen, por sigurisht nga njerëzit kompetentë, me argumente dhe nëse nuk u besojmë edhe atyre vendore, pse jo, të kërkojmë ndihmë edhe nga jashtë.

Edhe pse nuk besojmë që kemi aq paaftësi që rastet të mos i zbulojmë edhe vetë, organet tona kompetente, pra, por nëse duhet të kërkojmë ndihmë, duhet ta bëjmë atë.

Të nderuar kolegë deputetë,
Zonja dhe zotërinj,

Kaluan disa javë prej rastit të vdekjes së të riut Dehari dhe gjatë kësaj periudhe kohore konsiderojmë që fatkeqësisht, fatkeqësisht po e përsëris, është abuzuar, është keqpërdorur ky rast tragjik në forma dhe mënyra të ndryshme.

Sigurisht që edhe ne si institucione, edhe qytetarët, organizatat e ndryshme kanë pasur dhe kanë të drejtë ta ngrenë zërin dhe të kërkojnë të vërtetën, por askush nga ne nuk duhet shfrytëzuar raste të tilla të rënda për çfarëdo përfitimi, qoftë edhe nëse duket ose krijohet perceptimi i një përfitimi të tillë politik. Sinqerisht më vjen shumë rëndë ta them këtë, por nëse s'u vjen rëndë ta bëjnë ose të silltë kësi soji dikush tjetër, atëherë ne si LDK duhet ta themi këtë qartë që në asnjë rrethanë nuk guxojmë dhe nuk duhet ta politizojmë rastin e vdekjes së të riut Dehari, në asnjë rrethanë nuk duhet linçuar njerëz, gjykuar dhe aktgjykuar ndaj atyre dhe individëve nga kushdo qoftë, nga cilido subjekt politik, e kjo është totalisht e papranueshme se si është bërë në momente të caktuara nga subjekti i "Vetëvendosjes".

Të nderuar kolegë,

"Drejtësi për Astritin" është slogani dhe jo vetëm slogani që gjithsesi pajtohemi për këtë, por drejtësi, vlerësim e mbi të gjitha, po e theksoj, mbi të gjitha të vërtetën duhet ta dimë dhe këtë duhet dhe mund ta japin vetëm ata që janë kompetentë tani, pajtohemi apo jo.

Kërkojmë edhe më tej hetime dhe sqarime, pse jo, por përsëri këtë punë do ta vazhdojnë ekspertët vendorë, e nëse nuk u besojnë, edhe me ekspertë të huaj, por jo askush prej nesh me bajrak partiak, e jo me militantizëm, jo të flasim siç thuhet nga fundi i barkut, por të flasim me arsye dhe sinqerisht pa asnjë përfitim po e them, fatkeqësisht për të satën herë partiak, sepse është një rast i rëndë dhe tragjik.

Ne, si Lidhje Demokratike e Kosovës, kemi kërkuar edhe për shumë raste tjera, të nderuar kolegë, të ndodhura ndër vite, në rrethana e kohë të ndryshme, që çdo vrasje, apo edhe vetëvrasje, unë po flas tash për çdo humbje jete të shumë veprimtarëve të LDK-së, këtë po e theksoj jo për ta keqpërdorur seancën në asnjë rrethanë, por për ta përsëritur atë që e keni thënë me dhjetëra herë - të vërtetën duam ta dimë për të gjitha jetët e humbura. Thashë ndër vite, ne kemi të drejtë të dimë për çdo rast, obligim e kanë organet ta konstatojnë këtë, në mënyrë që të

hiqet nga dora dhe vullneti i njerëzve që edhe këtë ta keqpërdorin nëse nuk ka zbardhje të rasteve, atëherë edhe mund të vijë deri te situatat e tilla.

Ne kërkojmë, kemi thënë vazhdimisht, pse jo. Ne duam ta dimë edhe kush ka tentuar ta vrasë Ibrahim Rugovën, edhe shumë zyrtarë të tjerë që i kanë vrarë të LDK-së, por këtë e kërkojmë nga organet kompetente, sepse këta janë të thirrur që ta thonë këtë, sado që janë raste të rënda dhe të gjitha këto janë raste kriminale. Kërkojmë të vërtetën dhe rezultatet për të gjitha veprimet e mëhershme, e edhe të tashme. Ne kërkojmë dhe sigurisht kemi të drejtë ta dimë kush po e sulmon edhe eskortën e kryeministrit, kush po i sulmon institucionet, s'është me rëndësi pra i cilës parti. Dikush po i sulmon.

Kush po i djeg makinat? Duhet ta thonë organet këtë, sepse mua më lë të dyshoj që po e bëjnë njerëz të caktuar të partive politike, ose të një partie politike. Por, nuk jam ekspert, më bëjnë të dyshoj thashë, edhe kam të drejtë të dyshoj. Derisa nuk ka konstatim se kush po i bën këto dëme, pse jo? Nuk krahasohet, edhe një herë po e them, ju lus mos tentoni, nuk po krahasoj, por unë po e them mendimin, ne jemi të interesuar që të zbulohet çdo rast i çdo natyre. Normalisht vdekjet janë raste shumë më të rënda, vrasjet, vetëvrasjet janë raste shumë më të rënda, por edhe të tjerat hyjnë në domenin e obligimeve shtetërore dhe mos tentoni që t'i anashkaloni. Kush do prej nesh, këto s'mund t'i anashkalojë, sepse po flasim për rrezikim të sigurisë të vendit në momente të caktuara.

Të nderuar kolegë,

I thashë këto jo për të ikur nga tema për të cilën e kemi seancën, por edhe një herë po e përsëris për ta kërkuar të vërtetën, sepse shtetin e kemi dhe e bëjmë të mirë, më funksional, më të pranueshëm kur organet e tij janë funksionale, kompetente dhe japin rezultate në kontinuitet, në të gjitha periudhat, e jo të ngremë zërin pajtues ose mospajtues vetëm për një, dy, tre apo pesë raste, sepse krimet janë krime, veprat kriminale janë vepra kriminale, e shteti dhe organet e tij shtetërore, ato të drejtësisë e të gjyqësorit nuk mund të cilësohen të mira apo të këqija me fjalë të rastit, me vlerësime të shkëputura, por vlerësohen në bazë të punës dhe rezultateve, pa pretenduar se të gjitha krimet dhe kriminelët vihen para drejtësisë. Kjo fatkeqësisht mund edhe të mos ndodhë, kjo nuk ndodh fatkeqësisht ndoshta edhe në shtete të zhvilluara.

Të nderuar kolegë,

Seanca e sotme duhet të na shërbejë dhe të jetë vend ku, me gjithë peshën e rëndë të rastit, të mos flitet me fyerje, me etiketime, me vlerësime të rënda për njëri-tjetrin, por mbi bazën e argumenteve, mbi bazën e rezultateve, dhe ato të dhëna nga ekspertët, mbi bazën e nevojës që të ketë edhe më tej sqarime nga ata, që do të duhej ta bënë këtë punë në çdo rrethanë dhe në çdo kohë. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, zoti Beqiri! Fjalën e ka zoti Glauk Konjufca, kryetar i Grupit Parlamentar të Lëvizjes “Vetëvendosje”.

GLAUK KONJUFCA: Qytetarë të Republikës së Kosovës,
Deputetë të Kuvendit,

Unë e di që ky pushtet është i profesionalizuar në kidnapime, por nuk e kam besuar kurrë që do të vijë një ditë në Kosovë kur do të fillojnë të kidnapohen edhe seancat e jashtëzakonshme të Kuvendit të Republikës së Kosovës.

Në një vend ku mafia i hyn në shtëpi kryeprokurorit edhe ia terrorizon familjen, e pushteti del e vajton për vjedhje të telefonave, këtu gjithçka mund të ndodhë. Kjo seancë e jashtëzakonshme për Astrit Deharin u kidnapua nga PDK-ja dhe LDK-ja. Këtë seancë e filloi Lëvizja “Vetëvendosje”, kurse ky pushtet i përdori të gjitha metodat që kjo të mos ndodhte. Dy herë deputetët e caktuar të koalicionit qeverisës i tërhoqën nënshkrimet e tyre për shkak të trysnisë së pushtetit dhe me të drejtë duhet ta shtrojmë pyetjen: Pse po kidnapohet kjo seancë për Astrit Deharin?

Unë mendoj që përgjigjja është e thjeshtë dhe përgjigjja është e drejtpërdrejtë: Kjo po ndodh vetëm për arsye që të shmanget peticioni i 23 774 qytetarëve, i organizuar nga shoqëria civile.

Ky peticion nuk kërkon vetëm debat, siç po kërkon ju në këtë seancë. Ky peticion kërkon edhe adresimin e përgjegjësisë. Nuk është e mjaftueshme që ne vetëm të flasim këtu, vetëm të diskutojmë këtu për Astritin. Qytetarët kanë thënë me 23 000 nënshkrime që këtu duhet të adresohet përgjegjësia. Ne duhet ta ngremë zërin se kujt ka qenë përgjegjësia që Astrit Dehari e humbi jetën në burg. Aty kërkohet dorëheqja e ministres së Drejtësisë, aty në peticion kërkohet edhe dorëheqja e ministrit të Brendshëm, si dhe shkarkimi i të gjithë atyre që ndodhen në hierarkinë institucionale të burgut, që është vendi ku e ka gjetur vdekjen Astrit Dehari.

Këtë e kërkon peticioni i qytetarëve dhe kjo do të duhej të shqyrtohej në seancën e sotshme. Pikërisht pse po doni që ta shmangni këtë shqyrtim në seancën e sotme, e keni rrëmbyer këtë seancë në emër të PDK-së dhe LDK-së.

Zonja dhe zotërinj,

Pas 5 nëntorit, Kosova më nuk mund të jetë e njëjta. Deri më 5 nëntor, shteti i kapur i klanit “Pronto” i ka përdorur të gjitha metodat jokonvencionale kundër opozitës, duke filluar prej luftës speciale, që e bëjnë ndonjëherë edhe portalet mercenare, e deri te arrestimet e persekutimet politike nëpërmjet diktatit që ky pushtet e ushtron mbi drejtësinë. Por, më 5 nëntor dikush vendosi që ky konfrontim të shkonte një hap më tutje, përtej të gjitha këtyre metodave të deritashme, sepse në Burgun e Prizrenit vdiq një djalë i shkëlqyeshëm, një student i dalluar, një aktivist i zoti që nuk ia gjeje shokun, pra Astrit Dehari.

Vrasësin mund ta identifikojmë lehtë meqë në çastin që Astriti vdiq ai ndodhej në një institucion, që në instancën e fundit të kompetencës zinxhirore menaxhohet nga Qeveria nëpërmjet Ministrisë së Drejtësisë. Në këtë institucion, që është Shërbimi Korrektues i Kosovës, vdiq Astrit Dehari. Kanë kaluar gjashtë javë prej kur ndodhi ky krim i pashembullt dhe nuk ka qytetarë të Kosovës, qoftë partiak apo jopartiak, që nuk është tronditur e që nuk është lënduar thellë nga kjo vdekje mizore. Një vdekje e tillë që fillimisht shkaktoi vetëm tmerr e trishtim, u kthye në një dhimbje të gjithëmbarshme popullore e qytetare dhe që shkaktoi solidaritet mbarëkombëtar.

Por, duke kaluar ditët edhe vetë po e ndiej që dhimbja dhe mërzia po ia lëshon dalëngadalë vendin zemërimit dhe revoltës. Si është e mundur, 17 vjet pas çlirimit, që djemtë tanë më të mirë të kthehen në familjet e tyre në arkivol nga institucionet shtetërore, ku e humbin jetën dhunshëm dhe mizorisht? A e keni ëndërruar ndonjëherë një republikë të tillë? A thua si ndihen në këto momente ata mijëra burra e gra që dhanë gjithçka për lirinë e Kosovës, kur e shohin që në shtetin tonë ndodhin kaq gjëra të papranueshme dhe të pafalshme?

Ky është pikëllimi dhe dhimbja e vërtetë që e kemi. Na ka rënë të gjithëve të dëgjojmë këtyre ditëve të fundit se Astritin e vrau shteti. Ndonëse pajtohem me një konstatim, apo me një mendim që dëshiron ta shprehë një formulim i tillë, unë megjithatë po e marr guximin që këtë ta shpreh krejtësisht ndryshe: Astritin nuk e ka vrarë shteti! Astritin e ka vrarë mungesa e shtetit! E kjo do të thotë e ka vrarë pushteti, sepse pushteti në Kosovë e ka zhdukur shtetin. Pushteti në Kosovë e ka anuluar shtetin e Kosovës. Nuk ekziston më shteti në Kosovë, ekziston veç pushteti, se shteti do të duhej të ishte tërësia e strukturave të integruara institucionale që punojnë në funksion të interesit të gjithëmbarshtëm publik.

Por, në Kosovë kemi veç struktura të uzurpuara nga klanet partiake që i kanë vendosur këto struktura në shërbim të pasurisë dhe interesit kriminal grupor. Këto forca antishtetërore e luftojnë “Vetëvendosjen”, sepse te “Vetëvendosja” e shohin fundin e tyre si struktura uzurpatore. Meqë këto struktura kriminale nuk kanë kurrfarë mundësie më që ta zhvillojnë betejën dhe luftën politike në rrafshin e diskutimit dhe argumentit politik, ata po përpiqen që ta nxjerrin “Vetëvendosjen” jashtë politikës, që “Vetëvendosjen” ta nxjerrin në rrafshin e terrorizmit, aty ku krejt bota demokratike ka konsensus dhe bashkohet në kundërshtim. Dhe, si bëhet kjo?

Duke e dirigjuar komponentin hetues brenda Policisë, ashtu që të shpiken rastet, që t’i mvishen “Vetëvendosjes”, që të manipulohen dhe të shpiken prova të paqena dhe mbi to të arrestohen gjashtë aktivistë të “Vetëvendosjes” e të akuzohen për terrorizëm. Pastaj të gjendet në drejtësi ky Abdurrahim Islami, që rastit t’ia japë edhe dimensionin e përndjekjes penale. Këtij Abdurrahim Islamit frik ky pushtet ia ka punësuar djalin edhe në AKI, me qëllim që djali të shpikë prova e baba të ngrejë aktakuza.

Pra, struktura e procesit është kjo: Në fillim “Vetëvendosja” me dekret politik shpallet terroriste, pastaj konform kësaj duhet të shpiken provat, të fabrikohen situatat, të gjenden policët dhe prokurorët e pushtetit që ia bëjnë argatin këtij qëllimi.

Ja pra kush e vrau Astritin. Atë e vrau pikërisht kjo makineri, e cila strukturat e shtetit që duhet të të mbrojnë i kthen në struktura kriminale që ta marrin jetën.

Fytyra e kësaj makinerie janë tre njerëz këtu në Kosovë, e këta tre njerëz e kanë kthyer shtetin në këtë gjendje: Hashim Thaçi, Isa Mustafa dhe Kadri Veseli. Kurse për argatët e tyre që i shpikin provat e i montojnë proceset duhet ta marrë përgjegjësinë edhe ministrja Hoxha, ministri Hyseni, kryepolici Maxhuni, Nexhmi Krasniqi, Fatos Makolli, Abdurrahim Islami, e të gjithë këta të tjerët.

Shtrohet pyetja: Kur është vra Astrit Dehari? Unë nuk mendoj që Astrit Dehari është vrarë më 5 nëntor. Astrit Dehari është vrarë në momentin që e keni bërë terrorist. Atë ditë është vrarë Astrit Dehari, sepse një djalë i cili ka mundur të jetojë me familjen e vet në Zvicër është kthyer në Kosovë për t’i kontribuar vendit të vet, dhe çka i ndodh në vendin e vet? Pushteti i kriminalizuar e kap në shtëpi të vet, i hyn sikur terrorist në orën 4:00 të mëngjesit dhe ia fabrikon provat dhe e kategorizon për terrorizëm, i ngre aktakuzën.

Atë ditë është vrarë Astrit Dehari, e jo më 5 nëntor. Atë ditë unë e konsideroj ditë të vdekjes të Astrit Deharit. Kam besim të plotë që një ndryshim rrënjësor demokratik që i nevojitet këtij vendi, e që tashmë ka filluar, unë po besoj, e kërkon fundin e kësaj makinerie kriminale që gllabëron pa mëshirë jetën e qytetarëve të pafajshëm të Kosovës. Por, nëse nuk çmontohet ky mekanizëm, e tëra që mund të them është: Të mjerët ne ku do t’i rritim fëmijët tanë!

KRYETARI: Zoti Pal Lekaj e ka fjalën, kryetar i Grupit Parlamentar të Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës.

PAL LEKAJ: I nderuar kryetar i Parlamentit!

Kryeministër, ministra,

Familje Dehari,

Nga kjo foltore e Parlamentit të Kosovës si njëri nga njerëzit e këtij vendi të vuajtur e plot sakrificë, ju shpreh ngushëllimet e mija dhe të Grupit Parlamentar të Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës.

Të nderuar kolegë deputetë,

Të nderuar qytetarë të Republikës së Kosovës,

Sot jemi në këtë seancë të jashtëzakonshme për një rast që ka ndodhur para më shumë se një muaji e gjysmë, kur në Qendrën e Paraburgimit të Prizrenit humbi jetën një student, një djalë i ri,

Astrit Dehari. Prej kur ka ndodhur ky rast është shndërruar në kauzë për përfitime politike nga të gjithë taborët.

A është vrasje apo vetëvrasje? Kjo duhet të vërtetohet deri në fund dhe besojmë se më së miri do të ishte të ftohej FBI-ja për ekspertizë, si në rastin e Dino Hasanajt, se ata dinë ta kryejnë më së miri këtë punë.

Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës prej fillimit ka kërkuar debat të shëndoshë dhe zbardhje të këtij rasti nga drejtësia deri në fund e në mënyrë të plotë. Kjo nuk ka ndodhur deri më tani për arsye të pakuptimta, duke i dhënë kështu mundësi interpretimeve dhe ekspertizave nga të gjithë ekspertët, përveç atyre të vërtetëve.

Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës asnjëherë nuk ka tentuar të përfitojë nga raste tragjike të kujtdo qofshin, nuk kemi përfituar edhe atëherë kur të njëjtat i kemi pasur edhe brenda vetë partisë. Prandaj, duke parë këtë tendencë edhe sot këtu, ne refuzojmë të jemi pjesë e çfarëdo debati për këtë çështje, sepse konsiderojmë se kështu siç është e menduar dhe organizuar nuk i kontribuon zbardhjes të së vërtetës, por vetëm sa e rëndon atë.

Po e shfrytëzoj foltoren për një temë, që besoj se edhe i ndjeri Astriti do ta kërkonte, sepse është rast po kaq i rëndë për Kosovën dhe qytetarët e saj, ndërtimi i murit dhe rreziku i ndarjes së Kosovës. Urgjentisht, të mbahet interpelanca e përgjegjësve kryesorë që kanë lejuar që të ndodhë kjo.

Edhe një herë, i shpreh ngushëllime familjes Dehari dhe bashkëndjejmë me ta dhembjen. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Zonja Valdete Bajrami, kryetare e Grupit Parlamentar “Nisma”.

VALDETE BAJRAMI: Faleminderit, kryetar!

E nderuar familje Dehari,

Të nderuar kolegë deputetë,

Më lejoni që në emër timin, po ashtu edhe të grupit parlamentar t’i shpreh edhe një herë ngushëllimet e mia për humbjen e familjes Dehari.

E di që ne ndoshta nuk është dashur të debatojmë për këtë rast, por pasi që veç është vendosur tashmë dhe duke e parë situatën e pasigurisë nëpër burgjet tona, jemi të detyruar që edhe sot të debatojmë këtu. Por, fillimisht më vjen keq që në arsyetimin e kërkesës së deputetëve të nënshkruar thuhet se pasi që është bërë jehonë mediale po e shohim të rrugës të thërrasim një seancë të jashtëzakonshme për rastin e Astritit të ndjerë.

A do të thotë kjo, se vetëm pasi qenka bërë jehonë aq e madhe është thirrur kjo seancë nga ana e juaj? Çka ndodh me të gjitha rastet, me të gjitha shkeljet që ua bëtë të burgosurve, raste të cilat nuk patën dhe nuk kanë jehonë mediale? A duhet që vetëm të ndodhë tragjedia dhe ne të debatojmë, të reagojmë, të kërkojmë llogari, sepse sipas këtij arsytimi që ju e keni thirrur seancën e jashtëzakonshme po del se është jehona aq e madhe që ju ka shtyrë që të debatonit sot.

Sinqerisht, a keni pak ndjenja apo edhe këtu doni të bëni politikë? Deri këtu paskan ardhur sa që të mos ndjejmë ose të mos bashkëndiejmë dhembjen e familjes së të ndjerit? Sikur të mos udhëhiqeshin të gjitha institucionet nga njerëz tuaj dhe sikur ju nuk i njihni ata, ndoshta do të kuptoja arsyen tuaj që ju ta thërrisni këtë seancë. Por, sidoqoftë, jemi tash ku jemi. Ju, në vend se të kërkonit llogari nga ministri i punëve të brendshme, nga ministrja e drejtësisë, nga përgjegjësit e burgjeve, sepse të gjithë këta kanë përgjegjësi për secilën jetë që ndodhet atje, pa marrë parasysh se çfarë nacionaliteti kanë, pa marrë parasysh se çfarë feje, çfarë kombësie kanë dhe çfarë veprash kanë bërë. Institucionet duhet të ofrojnë siguri.

Unë kam disa pyetje për ju që jeni përgjegjës për drejtësi dhe siguri. Cila është siguria që ofrojnë burgjet apo qendrat korrektuese në vendin tonë? Cilat janë masat për të gjithë ata që nuk e kanë kryer detyrën e tyre, kjo vlen edhe për ju, ministra, pra për të gjithë ata që nuk mund të ofrojnë siguri për të burgosurit apo qoftë edhe ata që gjenden në paraburgim, sepse ky rast e ka dëshmuar që institucionet e sigurisë kanë dështuar në kryerjen e obligimeve që kanë, pra kanë dështuar në ruajtjen e jetës së të ndjerit Dehari.

Se kjo që ka ndodhë në Prizren nuk do të thotë që nuk mund të ndodhë edhe në qendrat tjera, pasi që tash ne e dimë, por edhe ju, zonja Hoxha dhe ju zoti Hyseni, e dini se siguria në burgje dhe në qendrat korrektuese nuk është në nivelin e duhur. Fatkeqësisht, janë evidentuar një varg parregullsish dhe shkeljesh nga ana e personelit zyrtar, të cilët nuk kanë qasje objektive dhe trajtimin e të burgosurve dhe realizimin e të drejtave dhe beneficioneve të para me ligj. Andaj, shqetësimi i të burgosurve dhe realizimi i të drejtave të tyre diskriminohet, manipulohet dhe është selektiv dhe kjo tashmë është dëshmuar në shumë raporte.

Shkeljet, parregullsitë që ndodhin vazhdimisht në këto qendra janë: kontrolli dhe siguria e qendrës korrektuese, kontrabanda, trajtimi joadekuat dhe selektiv shëndetësor, keqpërdorimi nga ana e zyrtarëve korrektues të së drejtës së të burgosurit në pushime, pra në vikend, qasje joserioze në trajtim të kërkesave të tyre, parregullsi në mospunën dhe personeli korrektues, mospërfillje të afatit të shqyrtimit të kërkesave të të burgosurve, përfshirë edhe lirin me kusht dhe shumë e shumë parregullsi të tjera, që ju tashmë i dini.

Lidhur me këto parregullsi përgjegjësia bie drejtpërdrejt mbi Ministrinë e Drejtësisë, e cila është treguar neglizhente dhe jokompetente në ushtrimin e përgjegjësi që ka, kjo u dëshmuar edhe në rastin tragjik të të ndjerit Dehari.

A është respektuar ligji në rastin e Astritit të ndjerë? Ligji kërkon respektim të parimeve, me këto ia siguron respektimin e dinjitetit të secilit individ apo të burgosur dhe trajtim human të tij, zbatim të sanksioneve penale në mënyrë të paanshme, jodiskriminim, eliminimin e veprave devijante dhe korruptive, ofrim të sigurisë, respektim të të drejtave të të dënuarve, mbi të gjitha sigurimin e jetës, gjë që ju dështuat t’ia siguronit Astritit.

Të gjitha këto isha e detyruar t’i përmend, pasi që pikërisht në rastin të cilin sot po e diskutojmë ka pasur deklarata skandaloze, duke filluar nga infermierja e burgut, pastaj drejtori i burgut dhe të gjitha ato deklarata, të cilat nuk përkonin asnjëra me tjetrën. Këtu ngritët dilema se kush i shtyri këta njerëz të dalin me këto deklarata kontradiktore? A duhet dikush të japë përgjegjësi për këto deklarata, të cilat tash e dy muaj e kanë vërshuar tërë vendin. Po të kishit pak ndërgjegje të pastër, në momentin që ka ndodhur ky rast, ju zoti Hyseni dhe zonja Hoxhaj, do të duhej të ofronit dorëheqje pa ua kërkuar askush, sepse ju jeni përgjegjës për sigurinë e të gjithë të burgosurve që ndodhen nëpër burgjet e Kosovës. E si po veproni ju? As që morët mundimin, që së paku të dilni në terren dhe të inspektoni burgjet pas këtij rasti e të shihni nga afër, se çfarë po ndodhë atje dhe me çfarë ballafaqohen të burgosurit. Çdo jetë aty brenda është përgjegjësi e institucioneve që ju i drejtoni, prandaj është momenti i fundit, kur ju duhet të largoheni nga ministrinë që i drejtoni, por edhe ata të cilët ishin përfshirë në këtë rast me anë të deklaratave kontradiktore, duhet të japin llogari.

Dhëntë Zoti që ky të jetë rasti i fundit!

KRYETARI: Faleminderit! Nga grupet parlamentare nuk janë të paraqitur. “6+”-i? Nuk është lajmëruar askush. Atëherë, ndërkohë kemi përfaqësuesin e Qeverisë. Zonja Dhurata Hoxhaj e ka fjalën.

MINISTRJA DHURATA HOXHAI: I nderuar kryetar i Kuvendit, zoti Veseli,

I nderuar kryeministër,

Të nderuar ministra,

Të nderuar deputetë,

Në lidhje me seancën e sotme, e cila i dedikohet humbjes së jetës së tani të ndjerit Astrit Dehari, fillimisht dua të shpreh keqardhje të thellë si dhe të them se kemi bashkëndjerë dhe bashkëndiejmë me familjen Dehari për humbjen e tyre.

Ministria e Drejtësisë dhe unë si ministre, pos që jemi të pikëlluar për humbjen e jetës së një të riu, i kemi ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme për zbardhjen e këtij rasti. Po ashtu, dua të theksoj që në fillim, se edhe përkundër faktit se ka pasur diskutime, deklarime nga më të ndryshmet në lidhje me këtë rast, unë jam përpjekur maksimalisht të rezervohem nga deklaratimet për faktin që të mos ndërhyj në hetimet e këtij rasti dhe me qëllim, që organeve kompetente t’u jepet hapësirë që ta kryejnë punën e tyre në mënyrë të pavarur dhe profesionale.

Ministria e Drejtësisë si institucion përgjegjës për menaxhimin e institucioneve korrektuese me të marrë lajmin për humbjen e jetës së Astrit Deharit ka autorizuar fillimisht inspektimin nga Inspektorati i Ministrisë së Drejtësisë.

Për shkak të ndjeshmërisë së rastit, Inspektorati ka bërë inspektim gjithëpërfshirës për veprimet dhe sjelljen e stafit ndaj të ndjerit Dehari.

Që nga momenti i pranimit të tij në Qendrën e paraburgimit në Prizren më 1 shtator 2016 është përgatitur raporti, të cilin e kam pranuar më 21 nëntor dhe i njëjti, për hir të transparencës, është bërë edhe publik.

Sipas raportit të Inspektoratit të Ministrisë së Drejtësisë konstatohet se nuk është gjetur asnjë veprim i ndërmarrë nga ana e personave përgjegjës në kuadër të institucionit, pra Qendrës së paraburgimit në Prizren i cili në çfarëdo mënyre do të ishte nxitës apo shkaktar i humbjes së jetës të ndjerit Dehari.

Megjithatë, Inspektorati ka rekomanduar se për shkak të neglizhimit të procedurave, të ndërmerren masa ndaj personave përgjegjës, dhe atë oficerit në detyrë, mbikëqyrësit të krahut si dhe personave tjerë përgjegjës të sigurisë në bazë të hierarkisë.

Në pajtim me të gjeturat dhe rekomandimet e Inspektoratit Ministria e Drejtësisë ka ndërmarrë veprime konkrete me ç'rast janë iniciuar procedura disiplinore ndaj 1 zyrtari korrektues, 2 mbikëqyrësve dhe ushtruesit të detyrës së drejtorit në Qendrën e paraburgimit në Prizren, të cilëve, po ashtu u është shqiptuar edhe masa e suspendimit si masë paraprake deri në përfundim të procesit disiplinor.

Me urdhër të prokurorit nga ekspertët e mjekësisë ligjore është bërë edhe ekzaminimi i trupit të të ndjerit Dehari. Ekspertët e mjekësisë ligjore nga në një proces transparent, me praninë edhe të mjekëve të propozuar nga familja dhe vëzhguesve nga EULEX-i, kanë konstatuar se i ndjeri Dehari është vetëvrarë.

Edhe Prokuroria e Shtetit ka dalë me njoftimin zyrtar se pas hetimeve preliminare rezulton se i ndjeri është vetëvrarë.

Bazuar në ndjeshmërinë e rastit, më 11 nëntor, pra para se të dalë raporti i Prokurorisë, i jam drejtuar Ambasadës britanike në Kosovë, nëpërmjet së cilës kam kërkuar përfshirjen e Policisë metropolitane "Skotland Guard" në hetimin e vdekjes së të ndjerit Dehari. Qëllimi i vetëm ka qenë eliminimi i të gjitha dyshimeve eventuale në lidhje me këtë rast.

Siç jeni në dijeni, kemi pranuar përgjigje nga ambasadori britanik, me të cilën ka shprehur mbështetjen që i jep Ministrisë së Drejtësisë në reformimin e sektorit të sundimit të ligjit, por gjithashtu edhe e ka njoftuar se Policia britanike nuk mund të ndërmarrë hetime në këtë rast, meqenëse rasti nuk lidhet me Britaninë.

Ambasadori britanik e ka theksuar rëndësinë që e ka kryerja e këtij procesi të hetimeve nga institucionet e Kosovës me paanshmëri dhe transparencë, si dhe me përfshirje të EULEX-it.

EULEX-i, në të cilin janë të përfaqësuar pra 28 vende anëtare të Bashkimit Evropian, në një deklaratë publike e ka njoftuar opinionin publik se ka përcjellë dhe monitoruar gjithë procesin në rastin “Dehari”, duke përfshirë edhe inspektimin nga Inspektorati i Ministrisë së Drejtësisë. Dhe EULEX-i vlerëson se i gjithë procesi ka qenë profesional dhe në pajtim me standardet përkatëse.

Ndërsa së fundi, kemi pretendimet e ekspertëve të angazhuar nga “Vetëvendosja”, të cilët e kanë kualifikuar vrasje, së bashku me avokatin Tomë Gashi.

Unë i kam dërguar letër kryeprokurorit dhe kam kërkuar nga ai që t’i hetojë edhe pistat të cilat i kanë hapur këta tre persona, pra kam kërkuar që të intervistohen në lidhje me këtë.

Të nderuar deputetë,

Jam thellësisht e shqetësuar për tendencën për t’i paragjykuar rrethanat e rastit dhe rezultatin. Janë bërë shumë deklaramë, të cilat vetëm sa e kanë nxitur opinionin publik duke u nxitur me përfundime para marrjes së raportit zyrtar nga Prokuroria, por pas daljes së Prokurorisë me raportin zyrtar.

Me këtë rast, ju bëj thirrje të gjithëve që të përmbahen nga deklaramet që paragjykojnë punën e institucioneve të Republikës së Kosovës dhe shfaqin mosbesim ndaj kësaj pune.

Ne, gjatë gjithë kohës po kërkojmë sundim të ligjit, transparencë dhe llogaridhënie.

Konsideroj se t’u besojmë institucioneve tona është më e pakta që duhet ta bëjmë në këto rrethana. Konsideroj se këtë ia kemi borxh edhe të ndjerit Astrit Dehari.

E kam thënë disa herë dhe po e them prapë, si ministre e Drejtësisë ju garantoj se Ministria ka bërë çdo gjë që është në dorën e saj për të siguruar transparencë të plotë dhe për të ndihmuar në zbardhjen e rastit, por gjithmonë me kujdes që të mos dëmtohet procesi dhe të mos ndërhyhet në punën dhe pavarësinë e institucioneve të pavarura.

Çdo ndërhyrje imja apo e Ministrisë së Drejtësisë, pas kalimit të rastit te Prokuroria, është ndërhyrje në pavarësinë e këtij institucioni.

Sa jam e njoftuar, Prokuroria është duke hetuar shkaqet e vetëvrasjes së të ndjerit. Pavarësia, pra, e Prokurorisë është një ndër shtyllat e sundimit të ligjit dhe duhet t'i lëmë ta bëjnë ata punën e tyre.

Ne jemi të interesuar që ky rast të zbardhet deri në fund, edhe në qoftë se kjo nënkupton edhe ekspertizë tjetër ndërkombëtare.

Për fund, i nderuar kryetar, kryeministër, të nderuar deputetë, të nderuar qytetarë, Dua edhe një herë të shpreh keqardhjen e thellë për këtë rast dhe dua të bëj thirrje që veprimet tona, e për aq sa është e mundshme edhe deklarimet tona, veçmas të personave me përgjegjësi dhe që ushtrojnë funksione publike, të bëhen në pajtim me ligjet në fuqi dhe të mos tentojmë të përfitojmë politikisht në çfarëdo forme nga tragjedi të tilla.

Le të mbetet në përgjegjësinë politike, përgjegjësinë profesionale dhe ndërgjegjen njerëzore e të gjithë atyre që në çfarëdo forme kanë tentuar dhe po tentojnë të keqpërdorin dhe të përfitojnë në çfarëdo forme nga kjo tragjedi. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Të nderuar kolegë deputetë, tani e kemi radhën për debat parlamentar nga deputetët, të cilët janë paraqitur për diskutim. Labinotë Demi-Murtezi, bëhet gati Melihate Tërmkolli!

LABINOTË DEMI-MURTEZI: Faleminderit, kryetar!

I shpreh ngushëllimet e mia familjes Dehari për rastin, humbjen e jetës të djalit të tyre, të ndjerit Astrit Dehari.

I nderuar kryeministër, ministra,

Të nderuar kolegë deputetë,

Ndjeva përgjegjësi morale të marr fjalën në këtë seancë, pasi që, si deputete e këtij Kuvendi, kam dhënë dy herë nënshkrimin tim për seancë të jashtëzakonshme për rastin “Dehari”.

Nuk e kam pasur asnjë lloj presioni, as në rastin e parë e as në rastin e dytë, as për të dhënë nënshkrimin, as për të tërhequr nënshkrimin. Të dyja rastet e kam dhënë nënshkrimin dhe kam qëndruar prapa nënshkrimit tim.

Pa diskutim, ky rast ka marrë jehonë edhe në popull, edhe te qytetarët. Kjo ka prekur ndërgjegjen tonë, moralin tonë dhe, pa diskutim, edhe ne si deputetë e si çdo qytetar i Kosovës prekemi edhe moralisht dhe flasim me emocione edhe në këto raste.

Ajo çka më bëri përshtypje më shumë dhe për çka u preka më shumë janë edhe akuzat e kolegëve se si patëm moral të nënshkruajmë për herë të dytë një peticion, një kërkesë për një

seancë, pasi të themi se rasti ka marrë jehonë. Është e vërtetë se rasti ka marrë jehonë, është e vërtetë se qytetarët i përcjellin këto raste dhe kjo ndoshta na detyron të dalim prej vetvetes ndonjëherë.

Sot po e shoh dhe po e vlerësoj brishtësinë dhe gatishmërinë time për të thirrur seancën për këtë rast dhe nuk e di sa ka qenë e mençur gatishmëria ime në të dyja rastet për të dhënë nënshkrimin tim për një seancë të jashtëzakonshme, gjithsesi prapë po kthehem te morali im, te njerëzorja ime.

Ne mbetemi sërish të pakënaqur me sistemin e drejtësisë në Kosovë. Kjo nuk do të thotë se pajtohemi me gjithçka që ndodh, me pasiguri në burgje dhe në gjitha institucionet e tjera korrektuese. Kjo nuk do të thotë se ne pajtohemi me të gjitha pakënaqësitë që ndodhin në vendin tonë, por nuk është se gjithmonë mund të bëjmë atë që dëshirojmë dhe gjithçka shpejt mund të arrihet ashtu siç ne dëshirojmë.

Dua të ngre edhe një çështje për kolegun e nderuar, Konjufca.

I nderuar koleg,

Sot ne po flasim për një vdekje konkrete, për një humbje konkrete. Organet kompetente le ta thënë fjalën e fundit, por nuk guxojmë ne si qytetarë fillimisht dhe si deputetë ta përdorim vdekjen si metaforë. Shumë njerëz në Kosovë janë akuzuar për terrorizëm, të gjithë janë lënduar, metaforikisht të gjithë janë vrarë, por sot po flasim për një vdekje konkrete.

Ka qenë shumë mirë e thurur deklarata juaj, të cilën unë e kam nënshkruar dhe pas së cilës kam qëndruar, se bashkë si deputetë, pavarësisht pozitë a opozitë, jemi për hetime të paanshme, për ekspertizë ligjore të paanshme, për zbardhje të fakteve sa më shpejt që të jetë e mundur për të qetësuar shpirtrat e familjarëve dhe të gjithë qytetarëve që kanë ndier dhe vazhdojnë të ndjejnë dhembje për humbjen e jetës së Astrit Deharit, por jo ta përdorim si metaforë as edhe një herë.

Unë nuk jam juriste, ose nuk kam përvojë në çështje ligjore, por i ftoj të gjitha organet kompetente që në mënyrën më të drejtë, më të shpejtë, më të organizuar e më cilësore të japin verdiktin e tyre, fjalën e fundit dhe përfundimtare që të qetësohen, po them edhe një herë, shpirtrat e familjarëve dhe të hetohet e të zbardhet rasti dhe të dëshmojmë se jemi shtet edhe ligjor, edhe demokratik. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Zonja Melihate Tërmkolli e ka fjalën. Nuk u lajmërova, Glauk, për replikë, po më vjen keq. Urdhëro, replikë!

GLAUK KONJUFCA: E nderuar deputete Labinotë!

Unë besoj seriozisht se jeni prekur dhe keni pësuar një dhembje kur Astrit Dehari ka vdekur. Veç, po të tregoj se mua më është copëtuar zemra kur ka vdekur, sepse e kam pasur vëlla, e kam pasur shok, edhe për më tepër, e kam pasur edhe asistent në punët e mia. Kam qenë në raporte të përditshme me të. E kam pasur prej shokëve më të mirë dhe shoku më i mirë më ka vdekur.

E kuptoni ju këtë gjë? Dhe, ndonëse ju besoj se jeni prekur shumë dhe keni dhembje, prapë mendoj se këtë dhembje nuk e shpreh më së miri zëri melankolik i dikujt, por vetëm e vërteta, vetëm raportet e Astritit që i ka pasur me njerëzit të cilët ai i ka dashur shumë dhe me të cilët ka bashkëpunuar. Sepse, dhembjen, jo gjithmonë, e shpreh më së miri vetëm zëri melankolik i dikujt.

KRYETARI: Zonja Labinotë Demi-Murtezi, kundërreplikë.

LABINOTË DEMI-MURTEZI: Nuk kam kërkuar dhe as nuk po kërkoj asnjëherë tentativë, as mënyrë, as melankolike, as metaforike për shprehjen e dhembjes. Atë e shpreh vetëm familja më së miri.

Nuk i kontestoj absolutisht raportet tuaja, as edhe një herë, nuk e ceka atë, se nuk e kam ditur çfarë raporte keni pasur, por vetëm si rast dhe tash po flasim për diçka konkrete, jo për vdekjen si çështje metaforike.

Absolutisht nuk ju akuzova, u ndjeva keq kur gatishmëria jonë u cilësua si jo e moralshme për arsyetimin pasi është bërë jehonë. Është bërë jehonë, nuk duam ta mohojmë, është bërë jehonë.

KRYETARI: Zonja Tërmkolli e ka fjalën. Nëse jua ka përmendur fjalën, jua jap fjalën. Pra, pas zonjës Tërmkolli e merrni fjalën ju.

MELIHATE TËRMKOLLI: Arben, mos provoko, se mirë e tha! E dëgjova mirë! Faleminderit!

Të nderuar deputetë,

Në fakt, atë që dua të them, ndoshta është pak e rëndë, por realiteti shumë herë është rënd i përballueshëm.

Po e them me shumë keqardhje që, zoti kryetar, Kuvendin e keni shndërruar në një paçavër. Ndërsa, këtë seancë, thjesht, me mënyrën se si e keni thirrur, mënyrën se si e keni quajtur - e jashtëzakonshme, është veç një pallavër. Kurrëgjë më shumë!

E jashtëzakonshme s'ka pse të jetë, kur e thërret shumica.

Në fakt, ka shumë përpjekje për përfitime politike. Leni përfitimet politike që po vijnë dhe po provohen të bëhen nga të gjitha anët, nga të gjitha anët po provohet të bëhen përfitime politike, fatkeqësisht.

Po më vjen shumë rënd t'ju dëgjoj këtu, me këto patetizma të pakuptueshme. Dilni, qani sa të doni atje jashtë! Leni patetizmat. Nuk është Kuvendi vend për patetizma. Kuvendi është vend për të zgjidhur probleme.

Keqardhja sot këtu është vetëm hipokrizi, e secilit që po e thotë. Kurrgjë tjetër.

Njësoj si edhe kërkesa që u tha këtu: jo, mos ndërhyri, jo mosndërhyrja në sistemin e drejtësisë, e të tjera, e të tjera. Ndërhyrja në sistemin e drejtësisë është bërë, moti është bërë.

Në fakt, pushteti kur ka bërë ndërhyrje në sistem të drejtësisë, është dashur bile të merren masa aty ku duhet, e jo aty ku s'duhet.

Ka vdekur një i ri. Ka mundur të jetë edhe më në moshë, ndoshta, por ka vdekur një i ri. Ka vdekur në burg. Në burg, kur është arrestuar dhe është mbajtur në arrest me muaj, me muaj, pa e ditur për çka, saktësisht për çka.

Mund të jetë krejt rastësi që ka qenë anëtar i "Vetëvendosjes". Unë po flas për një qytetar të Kosovës, e mund të jetë krejt i një tjetri orientim politik. Hiq s'është me rëndësi.

Prandaj, e kam thënë edhe pak më herët, po e përsëris edhe sot: prandaj duhet e vërteta. Dhe, e vërteta fillon nga kjo pikë që e thashë më herët. Nga këtu fillon edhe e vërteta, edhe drejtësia, edhe përgjegjësia. Këto janë tri elemente pa të cilat ne nuk mund ta zgjidhim as këtë problem dhe as probleme të tjera.

Pika nisëse është arresti me muaj e muaj, pa ditur pse. Zgjidheni këtë, të jeni të sigurt, do të dalë edhe e vërteta, edhe drejtësia do të bëhet, por edhe pak përgjegjësi. Ose, pak jo, por shumë përgjegjësi.

Dhe, në fund, këtij vendi i duhet edhe një pushtet, edhe një opozitë me fytyrë njeriu, njerëzor. Kaq. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Zonja Valdete Bajrami po insiston të marrë fjalën shkurt. Urdhëro!

VALDETE BAJRAMI: Faleminderit, kryetar! Vetëm edhe një herë për sqarim dhe po e lexoj arsyetimin.

Duke parë se është bërë jehonë e madhe në media dhe brenda shoqërisë sonë, prandaj këtu është esenca, zonja Murtezi. Veç pasi që është bërë jehonë, patjetër duhet të merremi me rastin. E çka ndodh me ato rastet të tjera, për të cilat nuk ka kush të bëjë jehonë për to?!

KRYETARI: Faleminderit! Tash vazhdojmë seancën, Driton Çausi e ka fjalën! Do të mundohem të shkoj në bazë të radhitjes si janë lajmëruar, pastaj të partive politike, ta keni parasysh që të jem më korrekt.

DRITON ÇAUSHI: Të nderuar qytetarë të Republikës së Kosovës,
Deputetë të pranishëm,

Më duhet të shpreh fillimisht shqetësimin dhe neverinë që pas gjashtë javësh dështimi absolut të institucioneve të sigurisë dhe të drejtësisë, e vetmja gjë që dëgjojmë nga përfaqësuesit e pushtetit dhe jo vetëm nga ata, dëgjova edhe nga opozita sot, është një përpjekje për të shmangur vëmendjen dhe një akuzë patetike për politizim dhe shfrytëzim politik të rastit. Ky besoj që është patetizmi më i madh që po e dëgjojmë.

Unë nuk e kam asnjë shpjegim, por nuk e di si e mendoni ju: një qytetar i Republikës së Kosovës humb jetën në mënyrën më tragjike të mundshme, një bashkaktivist yni vdes tragjikisht dhe ju pretendoni që një i dënuar politik nuk do të trajtohet nga ne dhe ne do të heshtim para kësaj tragjedie. Nëse ky është shfrytëzim politik, atëherë unë nuk e kuptoj ku është legjitimiteti i secilit qytetar, por edhe yni si subjekt politik, si bashkaktivist të kërkojmë drejtësi për Astritin.

Sot bëhen 45 ditë nga vdekja e Astritit Deharit, pra 45 ditë që kur qytetarët e Republikës së Kosovës nuk reshtin së kërkuari drejtësi për Astritin, dhe për humbjen tragjike të një bashkëqytetari të çmuar të tyre. E për kaq kohë kemi një pushtet, i cili u mobilizua duke i shfrytëzoi të gjitha instrumentet e veta për ta mjegulluar rastin dhe për ta mbyllur sa më shpejt si një përgjigje ndaj revoltës e cila u shpreh anembanë Kosovës.

Kur Grupi Parlamentar i Lëvizjes “Vetëvendosje” kërkoi një seancë të jashtëzakonshme për rastin “Dehari”, pushteti reagoi me presion ndaj deputetëve të tyre për të mos dhënë nënshkrime, për të tërhequr nënshkrime, kurse krerët e grupeve parlamentare, Zenun Pajaziti dhe Ismet Beqiri, kishin një arsyetim të vetëm pse nuk duhej mbajtur një seancë të tillë në Kuvendin e Kosovës. E ky arsyetim ishte se nuk guxojmë të ndërhyjmë në procesin e hetimeve derisa ky të mos ketë përfunduar.

Sot e dimë të gjithë, besoj, që ky proces i hetimeve nuk ka përfunduar, pra e shihni se ku shkon pafytyrësia e këtyre njerëzve, ku shkon hipokrizia e tyre dhe sa kanë ata ndjeshmëri për një rast si ky që po e trajtojmë sot.

Pa dyshim që njëri nga personat më përgjegjës për gjithë këtë farsë të rastit “Dehari” është kryeprokurori i Prokurorisë Themelore të Prizrenit, Sylë Hoxha. Më 18 nëntor, pra para më

shumë se një muaj, ai në një konferencë për media, duke u bazuar në një raport të autopsisë dhe pa pritur përfundimin e hetimeve konkludoi se Astrit Dehari kishte kryer vetëvrasje. Sot data shënon 20 dhjetor e ende nuk kemi përmbyllje të hetimeve dhe një raport për këtë rast.

Megjithatë, ai i dha vetes të drejtën t'i nxjerrë këto konkluzione para një muaji.

Ky veprim vetëm sa vërtetoi edhe një herë se në Kosovë nuk ka sistem të pavarur të drejtësisë. Kjo nguti shpjegim tjetër nuk kishte përveç ndërhyrjes së pushtetit në drejtësi.

Gjithë kjo përpjekje e Sylë Hoxhës që me një raport autopsie të mashtrojë opinionin u përcoll me një varg manipulimesh, me faktet të cilat edhe dua t'i trajtoj sot këtu.

Fillimisht më duhet të ndalem te përfundimet e këtij raporti të autopsisë dhe aspekti profesional në ndërtimin e këtij raporti.

Është e pabesueshme se si një ekip mjekoligjor mund të përpilojë një raport të tillë autopsie, ku mospërputhjet dhe gabimet fillimisht vetëm nga aspekti profesional janë skandaloze.

Në pikën e parë, nëse i keni parë këto përfundime të këtij raporti, konkludohet se vdekja vjen si pasojë e asfiksionit mekanike, kurse më tutje sqarohet se mekanizmi i vdekjes mund të ketë qenë një ndalje refleksive e zemrës, si pasojë e një refleksi vazo-vagal. Për të gjithë ata që kanë njohje elementare nga shkencat e mjekësisë, kjo mund të jetë një skenar i një filmi fantastik-shkencor, por nuk ka asnjë bazë shkencore.

Përveç kësaj, ngrihet një supozim i ngjashëm dhe thuhet se një mekanizëm tjetër mund të jetë “spazma laringale”. Si për rastin e parë, për supozimin e parë, si për rastin e dytë nuk ka asnjë dëshmi të mundshme që del nga autopsia që të nxjerrë një konkluzion të tillë.

Pra, lexoni autopsinë dhe askund nuk kemi një lidhje të tillë, e cila nuk ka bazë shkencore.

Këto lloj konstatimesh, të nderuar qytetarë, janë aq jokonsistente dhe të gabuara, sa edhe një student i mjekësisë do të ishte në gjendje t'i evidentojë dhe t'i hedhë poshtë ato.

Më tutje, dhe kjo është edhe më e rëndësishme, është manipulimi që me këtë raport u bë nga kryeprokurori Hoxha atë ditë të konferencës së tij.

Ai deklaroi, citoj: “Nga raporti i autopsisë rezulton se vdekja e të ndjerit Astrit Dehari ka ardhur si pasojë e asfiksionit mekanike, si pasojë e dëmtimeve të vetëshkaktuara, të cilat kanë qenë të shoqëruara me gjakderdhje të jashtme”.

Këto konkluzione i nxori pasi paraprakisht e kishte manipuluar këtë raport dhe duke e nxjerrë atë të riformuluar dhe të ndryshuar nga ai, të cilin e morëm më vonë. Pra, aty ishte aluduar dhe ishte shmangur e vërteta që lëndimet e vetëshkaktuara ishin shkak i vdekjes.

Raporti origjinal është pa numër rendor, kurse numrat rendorë që i vendosi Hoxha apo bashkëpunëtorët e tij ndryshonin të vërtetën e raportit dhe vendimet, të cilat sqarohen në raport si të vetëshkaktuara, që janë prerjet sipërfaqësore në dorë dhe në qafë që ndryshohen si shkaqe të vdekjes.

Pas vdekjes tragjike të Astritit kërkesa e familjes Dehari për ekspertë të pavarur në procesin e autopsisë ishte pranuar nga prokuroria.

Natyrisht që angazhimi i tyre në këtë rast nuk do të kishte kuptim pa një raport të tyre që ata do të nxirrnin duke i argumentuar gjetjet e tyre.

Ndryshe, pjesëmarrja e tyre ose lejimi i tyre në këtë proces nuk ka asnjë kuptim.

Në raportin e ekspertëve të pavarur dhe që kanë një kredibilitet të njohur edhe ndërkombëtarisht, argumentohet se kemi të bëjmë me një vdekje të dhunshme nga asfiksia mekanike e dhunshme. Aty konstatohen edhe lëndime në kokë, në parakrahun e majtë dhe të djathtë, të cilat klasifikohen si lëndime trupore të natyrës dhe të shenjave të vetëmbrojtjes.

Pra, në përfundimet e tyre konstatohet se vdekja është e dhunshme dhe se ka shenja të vetëmbrojtjes.

Cili ishte reagimi i institucioneve pas këtij raporti nga ekspertët, të cilët këto institucione i kishin pranuar si palë.

Kryeprokurori i klanit “Pronto”, Sylë Hoxha, deklaroi nuk do të marrim parasysh raportin e ekspertëve të pavarur. Pra, ftohen ekspertë të pavarur, lejohen, mirëpo mendimi i tyre nuk ka rëndësi. Kjo është farsa, e gjithë farsa e këtij procesi gjoja se do të lejohet edhe një mendim tjetër.

Të njëjtën e dëgjuam si nga ministrja sot, edhe nga të gjithë të tjerët.

Fillimisht opinionit i ofrohet një version, i cili shpërndahet që nga dita e parë se kemi të bëjmë me vetëvrasje, mandej konstatohet nga secili se hetimet nuk kanë përfunduar dhe se nuk guxojmë të paragjykojmë, dhe natyrisht të mos përfitojnë politikisht nga vdekja e një aktivisti pa u kryer këto hetime.

Të nderuar qytetarë të Republikës së Kosovës,

Deputetë të pranishëm,

Duke i parë të gjitha çfarë ndodhën që nga arrestimi i padrejtë, i pabazë, i aktivistëve të Lëvizjes “Vetëvendosje”, mbajtja e atyre në paraburgim e mosintervistimi i tyre, e së fundi edhe vdekja e dhunshme tragjike e Astritit dhe deklaratat e përfundimet që dolën pas kësaj ngjarjeje, lënë të nënkuptojnë që nuk kemi të bëjmë me shkarje profesionale, por me një proces tepër të dyshimtë e të montuar ndaj Lëvizjes “Vetëvendosje” dhe aktivistëve tanë.

Institucionet shtetërore kanë përgjegjësi për vdekjen e Astrit Deharit. Dhe, Lëvizja “Vetëvendosje” për asnjë moment nuk do të pushojë derisa të ketë drejtësi për Astritin dhe derisa këto institucione të çlirohen nga ky pushtet kriminal.

KRYETARI: Faleminderit! Nga Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës nuk ka të lajmëruar. Zoti Enver Hoti, nga “Nisma” e ka fjalën.

EVNER HOTI: Faleminderit, kryetar!

Të nderuar deputetë,

Fillimisht shfrytëzoj rastin t’i shpreh ngushëllimet më të sinqerta familjes Dehari dhe njëkohësisht të gjithë të rinjve dhe të rejave të Kosovës.

Ne sot jemi këtu për të trajtuar një çështje që është shumë e ndjeshme dhe e dhimbshme. Mendoj se është tepër e dhimbshme për të gjithë ne, e në mënyrë të veçantë për familjen e tij.

Nuk ka asnjë dilemë që zoti Dehari ishte në duart e pushtetit dhe sido që të jetë e vërteta rreth vdekjes së tij, në asnjë mënyrë dhe në asnjë rrethanë pushteti nuk mund të tërhiqet nga përgjegjësia që e mban dhe e ka rastin si të tillë, që nga burgosja e tij, që nga trajtimi i të gjitha procedurave e deri te humbja e jetës apo vdekja e zotit Dehari.

Dëgjuam këtu dhe kemi dëgjuar edhe më herët se janë ngritur disa pyetje si çështje dhe është kërkuar të dihet pse një pjesë e këtij grupi është liruar dhe një pjesë ka mbetur në burg? Mendoj që tani është koha edhe kjo të trajtohet, sepse është thënë në këtë Kuvend.

Po ashtu u tha më herët edhe nga shefi i grupit të PDK-së se duhet të dihen edhe rrethanat pse ka shkuar deri aty. Jo, zotëri, zoti Dehari nuk ka shkuar në burg, por ai është arrestuar nga pushteti dhe si i tillë është arrestuar me një aktakuzë tepër të rëndë, e cila ka përfunduar me humbjen e jetës së tij në çfarëdo rrethane dhe në çfarëdo presioni apo në çfarëdo mënyre.

Ne sot kemi pritur nga ministrja e Drejtësisë të thotë diçka tjetër dhe jo të bëhet pjesë e një retorike politike, krejtësisht retorike të zbrazët, por konstatimi është se sistemi i drejtësisë tanimë është rrëzuar, edhe ashtu ka qenë jofunksional, ka qenë i lënduar, por rasti i Deharit e dëshmon

se ky sistem i drejtësisë është rrëzuar. Prandaj, që më e pakta ajo që është dashur të ndodhë është dashur që ministrja e Drejtësisë dhe ministri i Punëve të Brendshme të japin dorëheqje dhe t'i lejohet një mundësi tjetër trajtimit të kësaj çështjeje.

Ne bëjmë thirrje që çështja të ndriçohet sa më shpejt dhe që organet kompetente të mos krijojnë huti akoma më tutje dhe të mos e lëndojnë edhe më tutje familjen dhe opinionin e gjerë.

Shikoni, neve po na hapen edhe dilema të tjera, sepse po na kthejnë në vite kur kemi dëgjuar edhe nga institucione të tjera që kanë mundur të jenë tepër funksionale e tepër ekspertiza, por gjithmonë vrasja e të rinjve apo humbja e jetëve të të rinjve të vendit tonë është përcjellë me dyshime dhe me fakte jo të dëshmuara nga institucionet përkatëse.

Trajtimi i tillë sinjerisht po krijon mosbesim të plotë te institucionet e shtetit. Faleminderit dhe bëjmë thirrje që e vërteta të ndriçohet sa më shpejt.

KRYETARI: Para se të vazhdojmë debatin, më lejoni të theksoj, të nderuar kolegë deputetë, se ju po e shini tashmë një kohë që nga fillimi i seancës po i bëhet presion Administratës. Ka ardhur një shkresë e dërguar në fillim nga një grup me shumë gabime drejtshkimore, Grupi i Shoqërisë Civile, pa nënshkrim, nuk kanë dhënë fare identitet, tash jemi duke u munduar, e kemi marrë një emër, është Vesa Gashi, thjesht peticioni i cili është drejtuar është nga Besa Luzha, Florina Duli dhe Rudinë Jakupi, kolegë deputetë. Po presim të marrin adresim, por të mos i bëhet presion Administratës, nuk ka qëllim askush të bllokojë diçka, asnjë iniciativë, po të paktën të ketë adresim, se të vijë në Kuvend, në mënyrë individuale dhe të mos pranosh të japësh, në fund mezi e kanë dhënë emrin Vesa Gashi. Po nuk e dimë a është emri i vet, se ajo çështje e vullnetit, a ju po e dini, do të thotë a është... Urdhëro, zonja Donika, fol publikisht, se nuk ke nevojë të bashkëbisedosh me mua, thjesht. Vesa Gashi, kush është Vesa Gashi, zonja Donika? Urdhëro!

DONIKA KADAJ-BUJUPI: Flas kur të më vij rendi dhe besoj shumë shpejt.

KRYETARI: Atëherë, pusho pak!

DONIKA KADAJ-BUJUPI: Përndryshe, mos paragjyko, nëse e ka shkruar emrin dhe mbiemrin, atëherë të paktën besoj që institucionet mund ta vërtetojnë nëpërmjet letërnjoftimit, është shumë e thjeshtë, nuk ka nevojë për shkencë dhe s'po di pse po duket aq e komplikuar.

KRYETARI: Në rend të parë, i është kërkuar nga personi zyrtar të japë të paktën emrin e mbiemrin, nuk ka dhënë as letërnjoftim, asgjë. Në qoftë se është peticioni juaj, është mirë zyrtarisht, ju drejtojeni, ne e fusim në seancë. Çështja është se proceduralisht Administrata e ka këtë problem, nuk e procedon, për arsye se nuk ka adresim.

Isha i detyruar për arsye se Administrata është në presion nga fillimi i seancës.

E vazhdojmë debatin. Ilir Deda, fjala për ju, pa grup parlamentar. Për korrektësi, jemi duke shkuar në bazë të radhës së paraqitjes, vetëm partitë politike, pa grup parlamentar, pastaj fillojmë prapë sipas radhës së paraqitjes së deputetëve.

ILIR DEDA: Faleminderit!

Zonja dhe zotërinj,

Kolegë deputetë,

Për fatin tonë të keq, tragjedia e familjes Dehari dhe rasti “Dehari” nuk është trajtuar në mënyrë çfarë duhet. Pse po e them këtë? Është hera e parë në 17 vjet në Kosovën e lirë që një aktivist politik vdes në duar të shtetit.

Dhe, ka qenë një tendencë e manipulimit të opinionit publik: a e ka vrarë veten a është i vrarë? Fakt është se një aktivist politik, i ri, ka vdekur në duar të shtetit, në vendin ku është dashur të jetë më i sigurti dhe pas një muaj e gjysmë në formën qysh është bërë, më në fund jemi mbledhur si deputetë pas shumë tentimeve që ta kemi një debat, por ky debat nuk mund të përfundojë në ajër, ky debat duhet të përfundojë me një vendim të prerë.

Tash nëse i shikojmë faktet, ato janë të tilla. Ne i kemi dy raporte, kemi një raport shtetëror “Rasti Dehari” dhe një raport të pavarur për rastin “Dehari”.

Këto dy raporte japin përfundime të ndryshme dhe, natyrisht, që në këtë kulturën politike, e cila është krijuar në Kosovë, institucioneve të shtetit nuk u besohet.

Nuk po them, Dhurata, që është problemi yt pse nuk i besohet, por kjo është fakt. Kuvendit nuk i besohet, Qeverisë nuk i besohet, domethënë drejtësisë jo se jo dhe kjo është puna jonë, e neve që jemi në politikë, ku e kemi sjellë situatën e tillë që askush të mos i besojë fjalës së institucioneve politike, e pse? Sepse ne 17 vjet jetojmë në kulturë të pandëshkueshmërisë. Atë që thuhet në çdo raport të shkruar për Kosovën dhe institucionet në Kosovë, kultura e pandëshkueshmërisë në Kosovë duhet të përfundojë.

E tash, ne jemi këtu duke debatuar për një tragjedi që një muaj e gjysmë, dhe në opinion publik për pandëshkueshmërinë dhe kërkesa më normale në situatën jonormale të cilën ne jemi është involvimi ndërkombëtar në zbardhjen e rastit. Kjo duhet të jetë mësim për ne. Çka do të thotë ky mësim? Që ka shumë më shumë punë që të largohet kjo kulturë e pandëshkueshmërisë, e cila është krijuar te ne. Sepse çfarë është ky diskutim? Prej Qeverisë vjen plotësim i kushteve formale a i hapave formalë që të thuhet që ne jemi duke bërë diçka. Po, jo. Kjo është e pamjaftueshme, sepse ndëshkueshmëria është substanciale, përgjegjësia është substanciale. Dhe përgjegjësia në bartësit e institucioneve publike është dorëheqja, e këtë duhet ta mësojmë ne. E ne çka jemi

mësuar deri tash, jemi mësuar të shohim njerëz në funksione publike, të cilët bëjnë çka t'u bie në mend dhe në fund mbesin aty, sepse nuk ka opinion publik, i cili bën presion në mënyrë të vazhdueshme që të përfundojë pandëshkueshmëria, kjo kulturë e cila është e krijuar.

Dhe, unë kisha kërkuar duke dëgjuar shumicën e grupeve parlamentare, të cilët po duket se e kanë një thirrje pak a shumë të përbashkët, nejtë, me dallime semantike, e ajo është: “Po duam hetim ndërkombëtar apo involvim ndërkombëtar në zbardhjen e këtij rasti”. Nuk do të ishte mirë që të hyjmë tash apo të vazhdohet me debat me ofendime personale, sepse mos harroni, duhet të jemi më njerëzorë, është tragjedia e një familje dhe ajo e kërkon që dikush prej jush të iniciojë mbledhje të grupeve parlamentare, pasi që ekziston një shumicë që është për involvim ndërkombëtar, të bëjmë një rekomandim dhe së bashku, mandej, me Qeverinë. Ka dështuar me Britaninë e Madhe, në rregull, ka vende të tjera prej të cilave duhet të kërkojmë me ngulm që të vijnë e ta zbardhin këtë rast. E kjo të jetë mësim për të gjithë në të ardhmen që të mos vijmë më në ditë të tilla, një, që të vdesë në duar të shtetit një aktivist politik, dhe dy, që të jetë fillimi i përfundimit të kulturës së pandëshkueshmërisë. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Agim Aliu, ndërkohë në qoftë se shkojmë në bazë të radhës, është Arbeni ose Besa. Besa, pasi është e gjinisë femërore, ka përparësi. Besa Gaxheri. Agim, fjala është për ju.

AGIM ALIU: Faleminderit, kryetar!

I nderuar kryetar i Kuvendit,

I nderuar kryeministër dhe të nderuar ministra,

Të nderuar kolegë deputetë,

Po mbajmë sot një seancë të radhës, një seancë të jashtëzakonshme, një seancë ku sërish po merremi me drejtësinë, një seancë, e cila në rrethana normale nuk do të duhej të mbahej, por ja që po e mbajmë për arsye që tashmë janë të njohura për të gjithë ne. Sepse tashmë e kemi hapur derën për një gjë të tillë, sepse tashmë kemi bërë diçka në të kaluarën që nuk do të duhej ta bënim dhe nuk po mund të ndalemi as sot që të bëjmë ndërhyrjen në punën dhe përgjegjësitë e institucioneve të pavarura.

Kjo po ndodh sepse po dorëzohemi para presioneve të caktuara dhe në një situatë të tillë sërish po bëjmë gjënë jo të duhur, atë të paragjyimit dhe të ndërhyrjes në punën e pavarur të institucioneve që e kanë këtë të drejtë të garantuar me Kushtetutë.

Shteti me institucionet e tij të pavarura nuk do të duhej të dorëzohej para presioneve dhe shantazheve e formave me ngjashmëri të tillë, por duhej treguar konsistent, i përgjegjshëm, profesional, shtet i barazisë qytetare dhe këmbëngulës në drejtim të realizimit të një shteti ligjor dhe të së drejtës për të garantuar se veprimet, vendimet, rezultatet janë të drejta dhe të pranueshme.

A e kemi një shtet të tillë të së drejtës sot? Sigurisht se jo. Por kjo nuk është shkaktuar vetëm për shkak të dobësive që janë rezultat i mënyrës se si është ndërtuar sistemi i drejtësisë dhe për këtë konstituim të drejtësisë shumë nga ne kemi qenë dhe vazhdojmë të mbetemi kritikë, dhe këtu kemi të drejtë. Por kjo nuk do të duhej të na i lidhte këmbët dhe të na humbasë besimin se duhet të mbështesim që ky sistem i drejtësisë të jetë edhe më i pavarur, jo vetëm në kuptimin formal, më profesional dhe më i besuar, mbi të gjitha, për ta garantuar një shtet të barazisë qytetare.

Sot më shumë se sa investim dhe mbështetje për shtetin dhe institucionet tona të pavarura, kemi mohim të tij, mosnjohje dhe tentim për rrënim deri në palcë të tij dhe kjo po ndodh fatkeqësisht nga grupe të caktuara, për qëllime të caktuara politike. Qëllimet dhe mospajtimet politike nuk duhet të na verbojnë para faktit se në thelb të funksionimit tonë si shoqëri qëndrojnë disa të drejta civile, përtej atyre politike, për të cilat duhet të bëhemi bashkë sa herë që ato shkelen, pa marrë parasysh se nga kush dhe ndaj kujt. Ligjet dhe institucionet janë aty për të na mbrojtur të gjithëve nga arbitrariteti, prandaj duhet bërë bashkë si për të mbrojtur të drejtat tona civile, ashtu edhe për të mos cenuar punën dhe përgjegjësitë e institucioneve, në mënyrë që të kemi një sistem të qëndrueshëm dhe të besuar, sepse fundja e fundit, rolet tona mund të ndryshojnë nesër.

Do të doja që si seancat e mëparshme për drejtësinë, e po ashtu edhe kjo e sotmja, të mos na bëhen çështje të debateve politike dhe të ndërhyrjeve në punët dhe përgjegjësitë e institucioneve tona të pavarura. Fatkeqësisht kjo ka ndodhur, por do të ishte mirë që, që nga sot, t'u vijë fundi këtyre debateve dhe ndërhyrjeve dhe që të punojmë të gjithë së bashku me më shumë përkushtim dhe vullnet politik në mënyrë që këto institucione, përkundër dobësive, brishtësisë, papërgjegjësisë të caktuara, cenimit, e tjera, t'i mbështesim më fuqishëm në efikasitetin, efektivitetin dhe profesionalizmin e punës së tyre, në mënyrë që në të ardhmen të kemi një siguri më të lartë juridike për të gjithë qytetarët tanë.

Edhe në shtetet me një shkallë tjetër zhvillimi dhe ndërtimi të sistemeve juridike, përkundër perfeksionimit dhe drejtësisë "ideale", mund të bëhen gabime, por kjo nuk shërben për qërim hesapesh me drejtësinë dhe me qëllim të përfitimit politik, sepse larg është ndikimi politik në tranzicione, por përkundrazi, kjo u shërben atyre për t'i forcuar ato dhe për të shtuar më shumë besimin në to. Seanca e sotshme duhet të japë porosi se institucionet e pavarura duhet të jenë më të përgjegjshme dhe më llogaridhënëse, si dhe më efikase në veprimet e tyre. Ndërsa, grupet politike duhet të jenë të panxituara dhe me veprime e maturitet politik e institucional.

Seanca e sotshme duhet t'i japë fund traumës, trajtimit të padrejtë dhe përdorimit për qëllime politike të tragjedisë së familjes Dehari, sepse ky është shërbimi më i keq që i bëhet familjes Dehari, drejtësisë, të ardhmes së Republikës së Kosovës.

Drejtësia e vërtetë për Astritin, solidariteti me zemër dhe shpirt në familjen Dehari mund të bëhet vetëm duke njohur Republikën me institucionet e saj, duke punuar që të shtohet besimi në

Republikën dhe në institucionet e saja, duke i lënë të qeta dhe që në mënyrë të pavarur, transparente, organet e drejtësisë të bëjnë punën e tyre. Më lejoni që duke e shprehur edhe njëherë dhimbjen dhe solidaritetin me familjen Dehari me rastin e vdekjes tragjike të Astritit, të kërkoj që drejtësia të vihet në vend pa kursyer gjithë potencialin profesional të brendshëm dhe të jashtëm, në mënyrë që e vërteta të fitojë. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Zonja Besa Gaxherri e ka fjalën, ndërkohë bëhet gati Albulena Haxhiu.

BESA GAXHERRI: Të nderuar kolegë deputetë,
Zoti kryeministër,
Kabinet qeveritar,

Unë personalisht kam qenë dhe jam kundër këtij debati, dhe kundër çdo debati i cili ka implikime të drejtpërdrejta në drejtësinë e këtij vendi. Bazuar në këtë që thashë, unë nuk do ta kisha marrë fjalën, por arsyeja që vendosa të marr fjalën sot është përgjigjja ime në pyetjen e nënës së Astrit Deharit, zonja Dehari, e cila në një emision televiziv në KTV më drejtohet mua personalisht me pyetjen: Pse Besa Gaxherri e quan djalin tim terrorist?! “Le të më përgjigjet”, thotë ajo.

Shumë e nderuar zonja Dehari, sot po e shfrytëzoj rastin që t’ju shpreh ngushëllimet më të thella dhe më të sinqerta si një nënë që kupton dhimbjen e një nëne dhe të përgjigjem në pyetjen tuaj. Unë nuk e kam njohur birin tuaj, Astritin, para vdekjes së tij as si emër. Astritit dhe 5 të tjerëve të akuzuar për të njëjtën vepër nuk ua kam ditur as emrin.

Faktikisht, unë kurrë, asnjëherë, në asnjë rast nuk kam theksuar asnjë emër të akuzuar për asnjë rast që kanë ndërmarrë aktivitetet e “Vetëvendosjes”, sepse unë kam aq njohuri dhe besim në drejtësinë, si dhe unë nuk kam asnjë qëllim personal me asnjë shqiptar të Republikës së Kosovës. Unë i jam drejtuar Kryesisë dhe Grupit Parlamentar të “Vetëvendosjes” dhe kam kërkuar nga ta që t’i distancohen nga veprimet e tyre të dhunshme. Kam kërkuar shpjegim edhe nga Prokuroria, të cilin shpjegim e kërkoj edhe sot: pse duhej të gjenden në selinë e subjektit politik armë të ftoha, molotov, gaz lotsjellës dhe maska? Vetëm maska thotë shumë, kush e fsheh dhe pse e fsheh fytyrën nga Lëvizja “Vetëvendosje”?

Kam kërkuar dhe kërkoj që Lëvizja “Vetëvendosje” duhet të jetë parti apo lëvizje politike demokratike ose duhet të thirret me një emër tjetër. Ky ka qenë diskutimi dhe deklarimi im, pas të cilit qëndroj edhe sot.

Të nderuar kolegë deputetë,
Pa mëdyshje vdekja e një djali të ri në burgun e Prizrenit, i cili është konsideruar dhe konsiderohet deri në fund të gjykimit i pafajshëm, është e dhimbshme dhe është tejet sfiduese për

institucionet e këtij vendi dhe për tërë shoqërinë e Republikës së Kosovës. Por, çfarë po duam ne nga kjo vdekje? Si po e trajtojmë këtë vdekje? Kush është i interesuar që ta shfrytëzojë këtë vdekje? A është e pranueshme sjellja e të gjithë neve ndaj kësaj vdekjeje?

Po filloj nga shteti, nga institucionet, të cilat me pakujdesinë dhe papërgjegjësinë e stafit, në radhë të parë të burgut, deklarimeve sharlatane nga njerëzit jokompetentë dhe pa pikë arsye, pra deklarimet e tyre dhe unë konsideroj se përgjegjësinë nuk mund ta mohojnë institucionet e vendit, qoftë është vrasje, qoftë është vetëvrasje.

Lëvizja “Vetëvendosje” është duke e përdorur dhe keqpërdorur edhe vdekjen e tij për përfitime politike. Familja, çuditërisht ekspozon dhimbjen dhe tragjedinë dhe të tërën e vë në funksion të kauzës së ulët të subjektit që i takojnë. Avokati i familjes, Tomë Gashi, pa fije konsiderate në mënyrë të paskrupullt tregon joprofesionalizëm dhe shtrembërim skajshmërisht të fakteve. E sot po i bashkohet edhe Kuvendi i Kosovës, duke rënë në kurthet e njerëzve, të cilët më së paku merren me dhimbjen dhe drejtësinë për Astrit Deharin.

Çdo subjekt politik në këtë Kuvend e ka kërkesën për drejtësi të pavarur, ndërsa po të njëjtit bëjnë ndërhyrjen më flagrante, duke futur në Kuvend pikat e rendit të ditës, si për shembull, kontestimet e gjykatave, vendimeve të gjykatave, kontestimin e të burgosurve të caktuar, si dhe edhe rasti i sotëm. Për ta mbyllur unë kërkoj që rasti të zbardhet deri në fund dhe të na vihen përpara shkaqet pse ka ndodhur vdekja. Në qoftë se familja kërkon, jo institucionet, sepse ne i kemi këto që i kemi, të mira, të këqija, duhet të punojmë çdo ditë që të jenë më të mira. Por, në qoftë se familja kërkon ekspertizë ndërkombëtare, kërkoj nga ju, zoti kryeministër, që ta mbështetni financiarisht këtë ekspertizë dhe ne të gjithë ta dimë të vërtetën për rastin në fjalë. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Zonja Albulena Haxhiu e ka fjalën, le të bëhet gati zonja Shukrije Bytyqi. Cilit? Mytahir Haskuka, fjala për ju, ndërkohë bëhet gati zonja Shukrije Bytyqi. Grupet parlamentare kanë të drejtë mes vete ta përcaktojnë radhitjen.

MYTAHER HASKUKA: Të nderuar qytetarë,

Deputetë dhe deputete,

Me të vërtetë kur po dëgjoj disa deputetë duke folur këtu po çuditem, domethënë se si mund të flasin në atë mënyrë në aspektin që të jemi korrektë, të jemi seriozë, të mos keqpërdoret rasti, të mos politizohet.

Në këtë rast, vetëm desha t’i pyes deputetët, të cilët folën në këtë aspekt. Çka është roli i Kuvendit së Republikës së Kosovës? Domethënë, roli i çfarëdo Kuvendi apo Parlamenti është që të monitorojë zbatimin e ligjeve. Në momentin që ligjet nuk zbatohen, vjen shkelja e të drejtave të njeriut dhe roli kryesor i deputetëve, faktikisht edhe juaji që i keni marrë votat e qytetarëve,

është të monitoroni zbatimin e ligjeve dhe të shikoni atëherë kur ka shkelje të të drejtave të njeriut dhe të kërkon llogari nga Qeveria.

Nuk është roli juaj ta mbron Qeverinë dhe t'i paraqitni perspektivat e Qeverisë këtu. Roli juaj është që t'i mbron qytetarët e Kosovës. Në këtë aspekt, këtu jo vetëm që po injorohet një e drejtë e pamohueshme, e cila garantohet edhe me Kushtetutën e Kosovës, edhe me ligjet, që është e drejta për jetën, e drejta për dinjitet të njeriut, e drejta e të akuzuarit, faktikisht në këtë rast, Astrit Deharit, të cilat të gjitha janë shkelur gjatë procesit të arrestimit të tij, por edhe me vdekjen e tij në burgjet e Republikës së Kosovës.

Në këtë aspekt, pasi ka ardhur deri te shkelja e shumëfishtë e të drejta dhe lirive themelore të njeriut, ne është dashur menjëherë, atë javë, domethënë javën kur janë mbledhur 40 nënshkrime, të mbajmë seancën e këtij Kuvendi dhe t'i diskutojmë këto shkelje ligjore dhe kushtetuese, ngase ky është roli ynë. Domethënë nuk kemi ne rol tjetër këtu, as të diskutojmë, por e kemi rolin të monitorojmë zbatimin e ligjeve. Në atë aspekt, sot ose faktikisht dje ka ndodhur edhe një shkelje tjetër. Ne më 29 nëntor kemi marrë kërkesën e peticionit të 23 mijë e 774 qytetarëve të Kosovës, të cilët kanë kërkuar që të jepet përgjegjësi institucionale për rastin e Astrit Deharit, ndër të tjera, të debatohet, por kërkesa kryesore e tyre ka qenë hetimi i pavarur dhe përgjegjësi institucionale, ngase ky është problemi i Kosovës, nuk ka përgjegjësi institucionale.

Domethënë, kurrë institucionet e Kosovës nuk japin përgjegjësi për shkeljet që u bëhen të drejtave të njeriut në Kosovë dhe, në atë aspekt, më 29 nëntor është dorëzuar peticioni në Kuvendin e Kosovës, ai është injoruar për tri javë dhe në momentin që Komisioni për të Drejtat e Njeriut, Peticione, Barazi Gjinore dhe Persona të Pagjetur e dërgoi kërkesën në Kryesinë e Kuvendit, deputetët e LDK-së dhe PDK-së, në një mënyrë të përshpejtuar, kërkojnë debat, duke i anashkaluar kërkesat e peticionit.

Domethënë, këtu tash ne kemi pasur një shkelje të të drejtave të njeriut, që i është bërë Astrit Deharit, por edhe aktivistëve të tjerë, të cilët janë në burgje pa u treguar për çka po akuzohen, tani domethënë me këto nënshkrime është shkelur edhe e drejta e peticionit të qytetarëve të Kosovës. Domethënë, e drejta për të kërkuar llogari nga Qeveria nëpërmjet peticionit. Domethënë, është injoruar totalisht kjo kërkesë dhe nëse i shikojmë kërkesat, fola edhe më përpara, kërkesa nuk është vetëm për debat parlamentar, por është për hetim të pavarur dhe transparent për rastin, dorëheqjen e udhëheqësve të Ministrisë së Drejtësisë, Ministrisë së Punëve të Brendshme, fillimin e menjëhershëm të ndjekjes penale të përgjegjësve që dështuan të garantojnë sigurinë e jetës së Astritit në institucionet e shtetit, shkarkimin e zyrtarëve përgjegjës në tërë zinxhirin hierarkik, trajtimin dinjitoz të Astritit në qendrën e paraburgimit dhe të vdekjes së tij dhe, po ashtu, domethënë, që Kryesia e Kuvendit, në bazë të nenit 38, paragrafi 1 të Rregullores së Punës së Kuvendit të thërrasë mbledhje të jashtëzakonshme.

Domethënë, tani për t'i ikur kërkesës së peticionit është thirrur ky debat pa i marrë parasysh kërkesat, edhe unë besoj që nëse ne këtu vetëm debatojmë pa i mbështetur ose pa i votuar kërkesat e peticionit, kjo është një shou medial më shumë dhe, si është thënë edhe këtu, për shkak të presionit medial, e jo për shkak të presionit qytetar. Unë besoj që Kosova mund të jetë shtet demokratik vetëm atëherë kur ju si deputetë do të mundoheni t'i mbron qytetarët e Kosovës ndaj institucioneve shtetërore, ngase të drejtat dhe barazitë rrezikohen nga institucionet shtetërore, nuk rrezikohen nga qytetarët.

Qytetarët kurrë nuk mund të rrezikojnë shtetin personalisht, por shteti mund t'i rrezikojë qytetarët dhe të drejtën e tyre, si ka qenë rasti i Astrit Deharit, të cilën na e vërtetoi kjo.

Në aspektin e përgjithshëm, folëm këtu edhe për besimin ndaj institucioneve, qytetarët nuk kanë pasur besim ndaj institucioneve deri në një masë dhe domethënë ka pasur njëfarë mosbesimi sidomos ndaj institucioneve të drejtësisë dhe të policisë, por nëse vazhdon me këtë temp dhe me këtë papërgjegjësi institucionale, ky mosbesim ndaj pushtetit do të kthehet edhe si mosbesim ndaj shtetit, dhe unë po frikohem që dita-ditës kjo Republikë, të cilën po duam ta ndërtojmë, nuk do të ketë pas kurrfarë mbështetje nga qytetarët ngase ata tanimë domethënë të gjitha problemet e tyre po mundohen t'i tejkalojnë vetë, duke mos u mbështetur në institucionet e shtetit.

Në atë aspekt besoj që ky duhet të jetë rasti më me rëndësi i Kuvendit të Kosovës që të tregojë që me të vërtetë Kuvendi i Kosovës i përfaqëson interesat e qytetarëve, e jo interesat e pushtetarëve. Mendoj që këto mund t'i bëjmë vetëm nëse i votojmë kërkesat e peticionit të qytetarëve, i cili i është dërguar Kuvendit të Kosovës më 29 nëntor. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Zonja Bytyqi, fjala për ju.

SHUKRIJE BYTYQI: Faleminderit, kryetar!

Të nderuar qytetarë të Republikës së Kosovës,

Të nderuar kolegë deputetë,

E nderuar familja Dehari,

Vërtet sot është shumë e vështirë të diskutojmë për një çështje kaq të ndjeshme, por mendojmë që është e rëndësishme, pasi që institucionet tona nuk e kryejnë punën e tyre ashtu si duhet. Vdekja e të riut Astrit Dehari brenda institucioneve shtetërore tregon papërgjegjshmërinë e këtyre institucioneve, e këtë papërgjegjshmëri dhe këtë mosfunksionim e rritin edhe më tepër deklaratat e përfaqësuesve të institucioneve më të larta shtetërore përgjegjëse për këtë vdekje.

Drejtori i Policisë Rajonale deklaroi se Astrit Dehari ka vdekur rrugës në spital për shkak të konsumit të tepërt të barnave. A thua, vërtet, drejtori i policisë nuk e di se si bëhet shpërndarja e medikamenteve mjekësore për të burgosurit që gjenden brenda? Mandej, përfaqësuesi, drejtori

korrektues tregon se ai ka vdekur pasi ka arritur në spital dhe një mori deklarimesh të tjera pa pikë ndërgjegjeje, pa pikë morali.

Ne mendojmë se vrasja e Astrit Deharit duhet të hetohet nga organizatat ndërkombëtare, të pavarura dhe kredibile. Por, ky hetim duhet të vijë pas dorëheqjes së instancave më të larta qeveritare, duke filluar prej ministrave, mandej Drejtorit të policisë, Drejtorit të shërbimit korrektues e tjerë. Nëse nuk bëhen këto dorëheqje, mendojmë që kjo tregon nivelin e mostransparencës, mospërgjegjësisë dhe qasjes jo të drejtë ndaj çështjeve shumë të rëndësishme, siç është edhe vdekja e njerëzve tanë brenda institucioneve shtetërore.

Vdekja e Astrit Deharit përpos që bën shkelje të lirive dhe të drejtave të njeriut, që neve na i garanton Kushtetuta e Republikës së Kosovës, ajo bie ndesh edhe me konventa ndërkombëtare që kanë për qëllim mbrojtjen dhe respektimin e lirive dhe të drejtave të njeriut. Fatkeqësisht, në Republikën e Kosovës, në qendrat korrektuese dhe në burgjet e Kosovës çdo vit ka ndodhur nga një vetëvrasje dhe institucionet tona nuk e kanë marrë asnjë hap për t'u dhënë llogari atyre familjeve që më të dashurit e tyre e kanë gjetur vdekjen brenda burgjeve.

Unë uroj dhe shpresoj që asnjëherë të mos kemi raste të tilla dhe rasti “Dehari” të jetë rasti i fundit që ndodh vdekja brenda institucioneve shtetërore. Faleminderit!

(Drejtimin e mbledhjes e merr nënkryetari i Kuvendit, z. Sabri Hamiti.)

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka deputetja Selviqe Halimi.

SELVIQE HALIMI: Faleminderit, nënkryetar i Kuvendit!

Të nderuar anëtarë të Qeverisë,

Kryeministër dhe ministra,

Të nderuar kolegë deputetë,

Edhe në Komisionin për Legjislacion e kemi pasur një debat për këtë çështje dhe aty kam deklaruar dhe po deklaroj edhe sot që deri sot asnjëherë nuk jam ndier më keq dhe nuk më ka ardhur më vështirë se sa të marr fjalën për një rast të tillë.

Diskutimet për raste të tilla dhe veprimet e tilla, ngjarje të tilla që ndodhin duhet të thërrasin në ndërgjegjen e secilit që është në institucione. Pavarësisht a është pozitë apo opozitë, pavarësisht a është në Kuvend apo Qeveri, pavarësisht a është në institucione të drejtësisë. Rastet e tilla mund t'i zgjidhin vetëm ata që ndajnë drejtësi. Ata që ndajnë drejtësi kanë misionin më të shenjtë në shtetet demokratike, sepse gjëja më e vështirë është të ndash drejtësi dhe të vish te e vërteta.

Në shtetet demokratike është qenësore që shoqëria nëpërmjet institucioneve të realizojë vullnetin qytetar dhe të veprojë e të punojë në interes të qytetarëve, në interes të përgjithshëm qytetar. Por,

edhe të kontribuojë në zhvillimin e shoqërisë nacionale dhe globale. Në vendet demokratike shtetet udhëhiqen nga shumica përfaqësuese qytetare, duke u monitoruar nga pakica përfaqësuese qytetare dhe nga shoqëria në përgjithësi. Por, është më se e vërtetë që vetë shoqëria nëpërmjet institucioneve krijon legjislacionin që mbron vetë qytetarët dhe institucionet që janë të autorizuar të veprojnë në interes të shtetit dhe të shoqërisë demokratike.

Gjithashtu, në vendet demokratike, ku sundon rendi demokratik i bazuar në shtetin e së drejtës, nuk ka dhe nuk lejohen akte të vetëflijimit, sepse demokracia nuk e lejon këtë. Të gjithë ata që në një shtet demokratik nxisin tendenca të tilla duhet t'i thërrasin ndërgjegjes së vet. Nuk mund të krijojmë precedent të demokracisë, sepse jemi të vegjël të ndryshojmë kahet dhe të ndikojmë në zhvillimin e teorisë së demokracisë.

Sistemi i drejtësisë duhet të mbështetet dhe të fuqizohet me të vetmin qëllim që të gjithë qytetarët të trajtohen barabartë para ligjit. Me rastin në fjalë, sistemi i drejtësisë nuk tregoi se të gjithë qytetarët janë të barabartë para ligjit, pavarësisht dyshimeve për veprat e kryera nga kushdo qofshin ato, për të njëjtën vepër, i njëjti grup trajtohet njësoj. Në Kosovë nuk ndodhi, pyetja është për sistemin e drejtësisë. Këtu vetë drejtësia shkallë e mbi shkallë, ashtu siç është e organizuar duhet të korrigjohet dhe të marrë masa për ata që veprojnë dyshkallshmërisht, dystandardshmërisht në raport me qytetarët e Kosovës.

Unë sot me keqardhje e them se e dëgjova për më shumë se njëqind herë fjalën “vdekje”, për më shumë se pesëdhjetë herë fjalën “kriminel”. A nuk jemi duke bërë cenim emocional të qytetarëve me këto fjalë? Po! T'i thërrasim ndërgjegjes, pozitë e opozitë, sepse nuk jeni këtu për të shkatërruar emocione qytetare, ato tashmë janë në një fazë që janë duke e marrë veten, duke u konsoliduar nga historia dhe nga lufta e dhembshme që kaluan këta qytetarë.

Politika nuk guxon të krijojë standarde në raport me qytetarët, standarde të ndërhyrjes, nuk mund të izolohet familja e asnjë politikani për shkak se dikush është në politikë dhe të gjithë të tjerët duhet të jenë jashtë institucioneve. Kjo është logjikë e gabuar. Këtë dikush e thërret me vetëdije dhe tenton të njollojë çdo gjë. Në institucionet e Kosovës ka aq njerëz të ndërgjegjshëm dhe profesionalë që besoj kanë më shumë ndërgjegje e profesionalizëm sa 120 deputetë që janë në Kuvendin e Kosovës, por atë ndërgjegje, atë profesionalizëm nuk guxojmë ta mbysim ne me retorika politike.

Nuk mund të jetë e keqe çdo gjë në Kosovë pse nuk më përshtatet mua. Dëshira e kujtdo qoftë nuk mund të kalojë në egoizëm dhe të shkatërrojë shoqërinë për të arritur qëllim, qoftë në pozitë apo në opozitë. Për të mos e zgjatur më shumë, kërkoj nga organet e drejtësisë që ta korrektojnë vetveten, të dalin me raporte profesionale për çdo gjë, sepse duke veçuar një rast që ndodh në qendrat e paraburgimit, ne pavarësisht në çfarë pozite jemi sot në Kuvend, po e krijojmë standardin e dyfishtë se sa i duam qytetarët dhe si i vlerësojmë ata.

Rasti në fjalë, që sot ne debatojmë, është rasti i fundit, kishte raste edhe më herët. Kishte raste të vetëvrasjeve e vrasjeve edhe jashtë qendrave të paraburgimit, edhe ata ishin anëtarë të subjekteve të ndryshme politike, edhe ata ishin veteranë apo invalidë të luftës që luftuan për të na çliruar ne dhe për të na ulur në këto karrige. Nuk u trajtuan me një seriozitet. Pse? Askush, sipas një parimi, nuk mund ta ndalë askënd të veprojë me jetën e vetë si të dojë. Po more, ka mundësi, sepse shteti për ata krijohet, që të mos shkatërrojë familje duke lejuar njerëzit të bëjnë veprime të liga, qofshin ato korruptive, qofshin ato me karakter penal, qofshin ato deri në vetëflirime, për këtë është shteti.

Kjo seancë duhet të thërrasë në ndërgjegjen e secilit ta korrigjojë vetveten në çdo veprim, kudo që është personi i autorizuar që të veprojë në emër të shtetit, pavarësisht a është përfaqësuesi i zgjedhur apo i emëruar në institucione. Kjo seancë duhet të thërrasë në ndërgjegjen e Qeverisë dhe ne deputetëve, që sa më shpejt që është e mundur të orientojemi drejtë zhvillimit ekonomik, sepse papunësia e çon vendin në katandisjen, për të cilën dikush mundohet ta shfrytëzojë për interesa të veta. As pozitës e as opozitës nuk i shkon përshtati dhe nuk i krijon poenë politike, kur një njeri më pak është në Kosovë, tenton ta politizojë se ndodhi për këtë apo për atë. Sociologjia dhe psikologjia e thotë një parim, duhet të merremi me shkaktarin e pasojës. Faleminderit!

KRYESUESI: Fjalën e ka deputeti Arben Gashi. Albulena Haxhiu të bëhet gati.

ARBEN GASHI: Të nderuar kolegë deputetë,

I nderuar kryeministër,

Tema që sot po diskutojmë është shumë specifike dhe e një rëndësie të veçantë, sepse përbën pikën më të rëndësishme të zhvillimeve politike në këto tre vjetët e fundit dhe po ashtu, sfidon bazat e ndërtimit të shtetit tonë. Vlerat, në të cilat ne si qytetarë besojmë, se janë vlera të demokracisë, barazisë para ligjit dhe të rendit juridik. Ajo çfarë ndodhi me rastin “Dehari” i vë në pikëpyetje këto vlera, si për nga përfaqësimi politik ashtu edhe nga reagimi institucional dhe shtetëror. Sa i përket përfaqësimit politik, ne sot duhet të kthehemi në kohën prapa, kur filloi kjo krizë institucionale, pse ndodhi ajo dhe ku përfundon.

Kriza erdhi sepse kishte një mungesë të theksuar të vullnetit për bashkëpunim ndërmjet pozitës dhe opozitës, sidomos për çështjet jetike të vendit. E kjo mungesë e vullnetit për bashkëpunim ndodhi në këto përmasa për herë të parë që nga fillimi i viteve të ‘90-ta. Megjithëse edhe fundi i viteve të ‘90-ta deri në vitin 2005 nuk ka qenë aspak i lehtë për shumicën e njerëzve në Kosovë e sidomos për zyrtarët e Lidhjes Demokratike të Kosovës, të cilët kanë qenë objekt i vrasjeve, dhunës fizike dhe verbale dhe po ashtu, vazhdimisht të kërcënuar. Por, në këto vite të vështira kishte një shpresë sepse kishte një lidhësi me vizion politik për të mos e zhytur vendin në luftë civile. Edhe përkundër ndodhive të mësipërme u arrit që të kalohet kjo fazë, megjithëse kostoja

ishte e lartë për njerëzit e LDK-së dhe familjet e tyre, të cilat akoma nuk i kanë të zbardhura këto raste.

Prej vitit të fundit skena politike është karakterizuar me dhunë fizike, me protesta në rrugë e në Kuvend, me gaz lotsjellës, me imponim të vendimmarrjes mbi hegjemoninë e votës së shumicës. Kjo klimë e ka bërë që shumë të rinj e të reja dhe familjarë të tyre nga ky proces i dhunshëm tranzicioni të kërkojnë rrugë të tjera për jetën e tyre. Disa duke braktisur përgjithmonë Kosovën, disa të tjerë duke kërkuar ndryshimin brenda, janë bërë pre e manipulimit për qëllime politike nga të gjitha palët. Sot politika në Kosovë përfaqëson gjuhën e urrejtjes, përçarjes, tradhtisë, vjedhjes, korrupsionit, nuk ka asnjë vlerë mbi të cilën qytetari ynë duhet të besojë, nuk ka asnjë besim mbi bazën e të cilit duhet të ndërtojë të ardhmen e vet dhe nuk ka asnjë shpresë, se e ardhmja e tij apo e saj do të jetë më e mirë.

Në një situatë të tillë u gjend Astrit Dehari, një djalë i ri, student i shkëlqyer dhe një idealist. Rrethanat në të cilat ai dhe secili qytetar i Kosovës u gjend, ndoshta ka vepruar me bindjen se do të bëjë më mirë për vendin, por veprimin për të cilin ai u akuzua është veprimi më i rëndë kundër çdo vepre dhe ideali, që ai mund të ketë pasur. Ndoshta, Astriti e bëri veprimin për të cilin u akuzua, për të cilin edhe do të duhej të dënohej, por sot jemi në një situatë krejt tjetër, sepse Astriti më nuk është në jetë, ai u largua nga kjo jetë dhunshëm, si vetëveprim, për shkak të rrethanave në të cilën u gjend apo si një veprim i një personi të jashtëm, kjo akoma nuk është zgjidhur nga organet kompetente. Dhe, drejtimin të cilin ka marrë ky rast, kam frikë, se do të mbetet përgjithmonë kështu, e pazgjidhur.

Të nderuar kolegë deputetë,

Unë jam njëri nga deputetët e LDK-së, që ka nënshkruar një kërkesë për një seancë të jashtëzakonshme të kërkuar nga Lëvizja “Vetëvendosje” dhe opozita dhe ky nuk është rasti i parë, që unë kam nënshkruar kërkesë të opozitës, ka qenë edhe më herët kërkesa për formimin e komisionit hetimor parlamentar për veprimtarinë e organizatës ilegale SHIK dhe nuk jam i vetmi deputet i LDK-së, që kam përkrahur këtë kërkesë. Në rastin për komisionin hetimor për organizatën SHIK jemi rreth 6 apo 7 deputetë të LDK-së, megjithëse kërkuesi i Komisionit Hetimor nuk ka qenë korrekt dhe informacionet që kanë dalë në medie kanë qenë të pavërteta lidhur me përkrahjen që ne i kemi dhënë. Por, t’i kthehemi rastit “Dehari”, se kjo nuk është tema tash.

Unë e kam përkrahur kërkesën e seancës së jashtëzakonshme, jo sepse unë jam me kauzën politike të opozitës, jo sepse unë i përkrah veprimet e Vetëvendosjes, jo sepse unë pajtohem me qëndrimet e tyre, unë e kam përkrahur thirrjen e seancës së Kuvendit, që të diskutojmë për rastin “Dehari”, sepse në rrethana të dhunshme, të shkaktuara apo të vetëshkaktuara nga të tjerët apo nga vetë ai, ka humbur jetën në Qendrën e Paraburgimit në Prizren një i ri. Tashmë, jemi në një situatë tjetër, ky rast i ndjeshëm politik mori një përfundim tragjik për Astritin, për familjen dhe

për secilin qytetar të ndershëm të këtij vendi. Çështje për të cilat unë kam kërkuar dhe përkrahur seancën kanë qenë, që ne të marrim sqarime për qëndrueshmërinë e sistemit tonë juridik dhe rendit shtetëror, sepse vlerat dhe idealet u përbaltën në konfliktin e zgjatur të ambicies së pafrenuar për pushtet nga palët politike.

Unë kërkoj sqarime për këto gjëra. Si ndodhi që një i paraburgosur, i akuzuar për terrorizëm, të jetë në një qendër paraburgimi të sigurisë së ulët? Pse u la ai i vetëm në dhomën e paraburgimit, për më shumë se një orë, siç shihet edhe nga videot, e asnjë gardian asnjëherë nuk e ka vizituar? Pse u la në posedimin e mjeteve të rrezikshme, të cilat mund të shkaktojnë vetëlëndim? Kjo ka të bëjë me rastin deri në momentin tragjik për Astrit Deharin, pas kësaj tragjedie fillon tragjedia e pafundme e paaftësisë së sistemit tonë shtetëror, për të menaxhuar një rast të ndjeshëm politik dhe specifik.

Si ndodhi që Prokuroria të dalë në vazhdimësi me deklaratat kundërthënëse? A është bërë hetim për prokurorët e përfshirë në rast? Si ndodhi që për më shumë se dy muaj të mbahet i arrestuar një i ri dhe asnjëherë të mos intervistohet nga organet e sistemit të Prokurorisë? Po, si veproi gjyqësori? Si veproi gjyqtari paraprak i lëndës, cilat masa ndërmori? Pse ndodhi që të deklarohet se nuk ka dhënë leje për vizita specifike dhe ato leje ishin dhënë? Cilat masa i mori Këshilli Gjyqësor? A mori ndonjë masë hetimore? A nxori ndonjë rezultat? A prodhoi ndonjë pasojë? Po, Policia e Kosovës, sa ka qenë e përfshirë në rastin pas arrestimit? Si ndodhi që të kemi deklarate kundërthënëse të drejtorit të Policisë në Prizren dhe pse ndodhi e gjithë ajo tollovi? A është bërë hetim i brendshëm policor për veprimet policore në rastin “Dehari” para dhe pas vdekjes tragjike? Ministria e Drejtësisë si organ përgjegjës për administrimin e burgjeve si ka vepruar?

Përveç raportit, që ministri e përmendi sot, kemi edhe kërkesën ndaj një vendi mik për përfshirjen e hetimeve, që për mendimin tim, është absolutisht e gabuar dhe e jo e duhur dhe përgjigja e Ambasadës Britanike është e saktë, sepse nuk mund të përfshihet një institucion hetimor i jashtëm jashtë juridiksionit të vet, nuk ka juridiksion për të hetuar në Kosovë dhe shtetasi nuk ka qenë shtetas britanik.

Pra, duke analizuar të gjitha këto ngjarje dhe rrethana politike dhe praktike, a mund të themi se kemi institucione stabile, të pavarura, të besueshme dhe hetimore me të gjitha këto panjohura? Kjo është arsyeja pse unë mendoj se Kuvendi është dashur të mbajë seancë të jashtëzakonshme dhe t’i diskutojë gjendjen politike në vend, e cila ka krijuar klimën e konfliktit dhe pasojat e rastit, si dhe si kanë vepruar organet shtetërore kompetente për këtë rast. Këto ishin dilemat e mija, të cilat vazhdojnë të mbeten dhe fatkeqësisht, sot nuk po marrin përgjigje.

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka deputetja Albulena Haxhiu. Të bëhet gati Zafir Berisha.

ALBULENA HAXHIU: Faleminderit!

Së pari më duhet të bëj një njoftim: Sapo ka ardhur shkresa nga Shoqëria Civile, ashtu siç edhe e kërkuat më përpara dhe unë ju lus, në emër të Grupit Parlamentar, që ta shpërndani tash tek deputetët, meqë deputetët janë në seancë plenare, mos ta leni në kutitë e tyre, por t'ua shpërndani tani.

Dhe, e njëjta kërkesë kërkon që të votohen rekomandimet e Shoqërisë Civile. Shpresoj që deputetët do ta lexojnë të njëjtën.

Sot bëhen 45 ditë prej kohës kur në duart e shtetit vdiq dhunshëm një qytetar dhe një aktivist politik në Qendrën e Paraburgimit në Prizren. Sikur të kishim një Kuvend dhe sikur të kishim deputetë, që përnjëmend përfaqësojnë dhe mbrojnë qytetarin e Republikës, nuk do të tentohej të heshte një vdekje e dhunshme e një qytetari në duart e shtetit. Por, ja që për fatin tonë të keq, sot jemi dëshmitarë të asaj, se ky Kuvend ka kohë që nuk përfaqëson interesat e qytetarëve, por ato private, biznesore, herë të deputetëve të caktuar, herë të Qeverisë, por herë të njerëzve të lidhur me ta.

Përndryshe, nuk mund të shpjegohet fakti se si ky debat u pamundësua, jo vetëm këtu në seancë plenare, por edhe në komisionet parlamentare. Dhe, meqë u përmend Komisioni për Legjislacion, meqë e drejtoj të njëjtin, po e theksoj faktin dhe po e bëj në dijeni, pra, për deputetët, sepse pikërisht në Komisionin për Legjislacion u kundërshtua thirrja e ministres së Drejtësisë. Pra, nuk u lejua thirrja e ministres e cila ka përgjegjësi direkte, sepse e njëjta merret me menaxhimin e burgjeve, madje nuk u lejua as thirrja e kryeprokurorit Sylë Hoxha, për të na njoftuar me rrethanat e vdekjes, dështimin e institucioneve, rrjedhjen e provave, kohën e vdekjes, për shkak se kishte deklarata kundërtë në vazhdimësi.

Madje, ky i fundit, pra Sylë Hoxha, tha se “nuk e kam ndërmend të raportoj në Kuvend, sepse është ndërhyrje në drejtësi. Si duket, Sylë Hoxhës nuk i pëlqejnë raportimet transparente për publikun, Sylë Hoxha preferon ndërhyrjet e “Prontos”, kam fjalën për ato të padukshmet, ato të nëntokës. Në fillim, menjëherë pas vdekjes së Astritit, dukej sikur institucionet e vendit, ato të sigurisë dhe drejtësisë, kishin marrë seriozisht veprimet që të çojnë deri te e vërteta. Në fakt, kishin qenë vetëm një farsë e gërditshme e njerëzve që po merren me rastin e astritit, e të cilët po tentojnë të drejtojnë opinionin publik drejt propagandës së tyre dhe larg së vërtetës.

Në kohën kur kërkohej sa më shumë kujdes dhe profesionalizëm për sqarimin e rrethanave të vdekjes tragjike, institucionet tona vazhdojnë të dëshmojnë të kundërtën. Deklaratat e rreme për rrethanat e vdekjes së Astritit nga drejtori i Policisë për rajonin e Prizrenit, Nexhmi Krasniqi, edhe nëse ato qenë bërë në nxitim, ato kurrë nuk u përgënjeshtruan nga asnjë instancë e Policisë së Kosovës apo e Ministrisë së Punëve të Brendshme.

Kundërthëniet për kohën e vdekjes:

- herë thuhet që Astriti vdiq në Qendrën e Paraburgimit, herë rrugës he herë në Qendrën Spitalore;
- kryeprokurori i Prizrenit Sylë Hoxha ende nuk ka konfirmuar zyrtarisht e publikisht orën e saktë, se kur u njoftua për rastin dhe nga kush e mori atë telefonatë apo cilëndo formë tjetër të njoftimit;
- dalja në publik e xhirimeve të plasura nga një televizion privat, pas pesë ditëve, dhe publikimi i ditarit në ca portale të regjimit;
- keqpërdorimi i raportit të mjekësisë ligjore nga kryeprokurori Sylë Hoxha, i cili doli në konferencë shtypi me konkludime ende pa u kryer hetimet, njësoj siç bëri sot ministrja e Drejtësisë;
- moslejimi i qasjes në provat e familjes dhe avokatit të familjes;
- raporti i ekspertëve të pavarur, të caktuar nga familja dhe jo nga “Vetëvendosja”, zonja ministre, por edhe deklaratat skandaloze të kryeprokurorit Sylë Hoxha, i cili thotë që nuk do ta marrë parasysh raportin e ekspertëve të pavarur, janë vetëm disa prej arsyeve se përse familja e Astritit, por edhe Lëvizja “Vetëvendosje” nuk i besojnë këtij sistemi e jo vetëm ne, por edhe ata mijëra qytetarë, mbi 23 mijë qytetarë, prej të cilëve veçse janë nënshkruar, domethënë e kanë nënshkruar peticionin.

Nuk i besojmë këtij sistemi, i cili arrestoi gjashtë aktivistë, duke ua veshur veprën më të rëndë që njih legjislacioni penal, atë të terrorizmit dhe pa asnjë fakt. Nuk i besojmë këtij sistemi në duar të të cilit vdiq një i burgosur politik.

Të nderuar qytetarë, ky sistem nuk mund të sjellë drejtësi. Sylë Hoxha dhe Metush Biraj nuk kanë asnjë kredibilitet, as moral dhe as profesional për t’u marrë me rastin e Astritit. Ata janë, thjeshtë, soji i prokurorëve të kapur dhe nuk duhet të merren me rastin e vdekjes së Astritit. Hetimi i tyre nuk mund të jetë as kredibil dhe as i paanshëm. Ende sot, përveç drejtuesve të Policisë, as Qendra e Emergjencave nga spitali rajonal i Prizrenit nuk ka publikuar zyrtarisht asnjë raport të plotë, përpos raportit të momentit, të cilat tashmë i ka grupi hetues.

Çdo e dhënë, si ajo se kur e pranuan rastin, çfarë ndihme i dhanë, sa minuta pas njoftimit mbërriti në Emergjencë, kush i njoftoi e plotë detaje, që në çdo rast duhet tu ishin dorëzuar që të shtunën në mbrëmje zyrtarisht prindërve dhe avokatit e padyshim, ato të dhëna që nuk prekin hetimet apo të dhënat tjera duhet të ishin bërë publike. Por, sigurisht, këto dokumente nuk mund të dilnin as për familjen as për avokatin e as për publikun, për sa kohë mbi to nuk ka orar mbi të cilin nuk është korrigjuar diçka, nuk ka konstatim mbi të cilin një tjetër zyrtar nuk thotë të kundërtën.

Sot, në emër të familjes Dehari, por edhe në emër të Lëvizjes “Vetëvendosje” edhe një herë, kërkoj që të ndërpriten hetimet që po zhvillohen nga ky grup njerëzish, tashmë të inkriminuar për

vdekjen e Astritit. Nuk mund të hetohet vdekja e tij nga ata që gënijën publikisht, nga dikush që vdekjen e Astritit e shpalli vetëvrasje dhe nga ata që kontaminuan prova.

Këto rrethana janë arsye, sepse për të hetuar krejt çfarë ka ndodhur duhet një hetim i pavarur dhe i besueshëm nga njerëzit me kredibilitet profesional dhe moral. Institucionet e kapura nuk mund ta bëjnë këtë, jo këto të klanit “Pronto”, këto do të nxjerrin rezultatin që duan vet, dhe ne nuk mund ta pranojmë këtë, por me këmbëngulësi do të kërkojmë drejtësi dhe do t’i shkojmë deri në fund.

Tash e sa kohë kemi dëgjuar mbi ligjin, drejtësinë e politizimin e çështjes, por asnjëherë nuk dëgjuam organet e Qeverisë dhe ministrat përgjegjës t’i kujtojnë publikut dhe vartësve të tyre detyrimet absolute që i ka shteti i Kosovës përballë qytetarëve në respekt të Kushtetutës dhe normave ndërkombëtare, të cilat ne i kemi pranuar si normë e brendshme e jona.

Po listoj disa më poshtë, meqë ministrja e Drejtësisë, as nuk do dhe as nuk mundet.

Rasti i vdekjes në burg i aktivistit Astrit Dehari përbën shkelje të rëndë të pesë, ose thënë më saktë, të katër parimeve themelore të Konventës Evropiane për të drejtat e njeriut, këtë konventë jetësuar në vendimet e Gjykatës së Strasburgut, sipas kuptimit të nenit 53, Kushtetuta e Republikës, Institucionet tona janë të detyruara ta zbatojnë dhe atë pikë për pikë.

Neni 2, e drejta në jetë si një e drejtë absolute dhe detyrimi shtetit për të mbrojtur njeriun nga marrja e jetës, sidomos kur ai është nën juridiksionin e tij direkt.

Neni 3, e drejta e çdokujt për të mos u keqtrajtuar, trajtuar çndershëm apo ushtruar trajtim degradues në qendrat e paraburgimit dhe të dënimit.

Neni 6, e drejta për një gjykim të pavarur dhe të drejtë, në të cilin shteti garanton të drejtën e viktimës për një hetim të shpejtë dhe të pacenuar nga interferimi politik.

Neni 8, e drejta në respektim të privatësisë, në kuptim të detyrimit të shtetit për të mos i dhënë publikut informacione paragykuese, që ndryshojnë rrjedhën e procedurës penale kundër dikujt, përpara se ai të jetë gjykuar në mënyrë të plotë dhe të pavarur.

Gjykata e Strasburgut ka vendosur në rastin tiranik kundër Rumanisë, që vendosja e të burgosurve në rrethana të terrorit psikik përbën vepër të torturës dhe degradimit njerëzor, të ndaluar me nenin 3 të Konventës.

Në Qendrën Korrektuese në Prizren ka ndodhur një ose më shumë herë, kur kjo rrethanë, në rastin e aktivistit tonë Astrit Dehari, është përsëritur në vazhdimësi, sepse ka ndodhur kur brenda

burgut Astriti është marrë në pyetje, është kërcënuar për ekstradim në Maqedoni dhe i është thënë, se “do të dënohesh 10 apo 20 vjet burgim”.

Sa i përket detyrimit të shtetit për një proces të pavarur, hetimi në rastet e vdekjeve në qendra paraburgimi, vendimi i Gjykatës së Strasburgut, pra një vendim i detyrueshëm për zbatim nga institucionet tona, sipas Kushtetutës, përcakton detyrimin e shtetit, konkretisht Ministrisë së Drejtësisë, që në rastet e vdekjeve në qendra paraburgimi, hetimi i shtetit për vdekjen duhet të jetë plotësisht i pavarur, i garantuar me cilësinë e bindshmërisë objektive. Pra, t’ua mundësojë familjarëve pjesëmarrjen e plotë në tërë procesin hetimor, për t’i arritur interesat legjitime të viktimës, është rasti Gjordan kundër Britanisë së Madhe, hetuesit e rastit të vdekjes në Qendrën e Paraburgimit duhet të mos kenë qenë më parë të përfshirë në asnjë rrethanë, qoftë edhe të lejuar në rastin e viktimës, që hetimi duhet të jetë i shpejtë, në mënyrë që të mos lejojë degradim të rezultatit dhe besueshmërisë publike për të, procesi hetues duhet të nxjerrë të dhëna që mundësojnë atributimin e përgjegjësi atyre që janë përgjegjës për vdekjen e tillë e jo t’i shkatërrojnë të dhënat e tilla duke konkluduar praktikisht për rastin, që hetimi të dërgojë në përcaktimin e shkakut dhe përgjegjësisë për vdekjen e atyre që janë përgjegjës, siç është vendosur nga Gjykata e Strasburgut, për rastin “Anxhelova” kundër Bullgarisë, t’i lejojë publikut marrje të mjaftueshme në përgjegjësi të atyre që janë përgjegjës, siç është vendosur në rastin “Eduards” kundër Britanisë së Madhe.

Dhe, para se ministrja e Drejtësisë, e kam këtë krejt në fund, të bëjë paragjykime, në fakt, fillimisht kërkonte nga ne që të mos e paragjykonim rastin, pastaj e njëjta e shpalli të vetëvrarë Astritin, para se e njëjta të mbajë konferenca qesharake, ose të bëjë shpifje para deputetëve të Kuvendit dhe qytetarëve apo të mbajë fjalime patetike, do të duhej që ta shqyrtonte seriozisht dorëheqjen. Jo vetëm ministrja e Drejtësisë, Dhurata Hoxha, por edhe ministri i Punëve të Brendshme, Skender Hyseni.

Dhe, meqë është këtu, unë po ia parashtroj disa pyetje: Pse nuk është shkarkuar drejtori i Prizrenit menjëherë pas vdekjes tragjike të Astritit? Pse ende nuk është shkarkuar drejtori i burgjeve? Pse nuk keni suspenduar menjëherë zyrtarët e qendrës korrektuese, domethënë, që në ditën e ngjarjes? Pse nuk i keni dërguar për ndjekje penale, sipas përgjegjësisë që kanë? A janë njoftuar zyrtarisht për vdekjen e Astritit familja Dehari, ashtu siç kërkon neni 99 i Ligjit për ekzekutimin e sanksioneve penale, nëse po, çfarë date dhe numri mbanë shkresa?

Secili i paraburgosur apo ata që vuajnë dënimin kanë rendin shtëpiak, i cili duhet të respektohet, këtu përfshihen obligimet edhe të stafit të qendrave korrektuese, pse kjo nuk është zbatuar në rastin e Astritit dhe çfarë duhet të ndodhë në një vend, sipas jush, që një zyrtar publik të japë dorëheqje?

Pra, unë pres përgjigje nga të dy ministrat, që tani. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Deputeti Zafir Berisha e ka fjalën. Nezir Çoçaj flet mbas Zafirrit.

ZAFIR BERISHA: Faleminderit, kryesues!

Unë me thënë të drejtën, nuk desha të kyçem në këtë debat, por sido që të jetë edhe si qytetar edhe si deputet, ndjeva obligim me e ripërsëritë mendimin tim rreth kësaj tragjedie, që i ka ndodhur familjes Dehari, për të cilën edhe njëherë shpreh shpirtërisht keqardhje nga pozicioni i një fjale popullore, se çdokush duhet ta ndjejë në lëkurën e vet për të mundur të jetë shpirtërisht, domethënë me familjen e cila i ka ndodhur kjo tragjedi.

Arsyetimi i thirrjes së seancës, domethënë, është një qasje joserioze për mendimin tim, për një çështje të ndjeshme dhe ky ishte edhe shkasi që unë t'i them dy-tri fjalë në këtë seancë plenare të jashtëzakonshme, për një çështje të ndjeshme, por që nuk është e jashtëzakonshme, se pas 40 ditëve po thirret seanca.

E gjithë ngjarja, mendoj, dhe tragjedia ka ardhur si rezultat i mungesës së përgjegjësisë së personave të caktuar në institucione dhe, kjo tashmë nuk do koment dhe kjo përgjegjësi është rezultat i kapjes së drejtësisë dhe mekanizmave të tjerë të shtetit nga parapolitika e partive në pushtet, të cilët duke vënë në pozita përgjegjëse njerëz të papërgjegjshëm, të cilët me logjikën e llastikut e shikojnë ligjin, natyrisht se ndodhin këto që kanë ndodhur. Mendoj se duke e pasur një qasje të kësaj natyre për institucionet, tragjeditë do të vazhdojnë në këtë vend, ku po venitet shpresa për një jetë më të mirë.

Deklaratat kundërthënëse sigurisht se e mjegullojnë edhe më shumë rastin dhe mosdhënia e përgjegjësisë për deklarata të papërgjegjshme, mendoj se dy ministrat që lidhen me ngjarjen dhe rastin vetë duhet të japin përgjegjësi, pasi që kanë zyrtarë të papërgjegjshëm në hierarki.

U theksua nga shumë kolegë deputetë se çështja duhet të trajtohet edhe nga mekanizma apo edhe nga vende të tjera ndërkombëtare, për të cilat unë nuk kam hiq besim dhe nëse këtë çështje e gjuajmë jashtë Kosovës, kjo do të thotë që ky rast të mos sqarohet për opinionin.

Po e them këtë sepse ka pasur raste në Kosovë kur janë marrë mekanizma ndërkombëtarë të caktuar, nga të cilët do të thotë nuk ka pasur kurrë transparencë të plotë dhe faktikisht me kalimin e kohës kanë mbetur në heshtje, nën hije.

Unë edhe një herë shpreh keqardhjen për tragjedinë, por në të njëjtën kohë shpreh edhe keqardhjen për nivelin e këtij Parlamenti, i cili po merret me çështje të cilat vërtet janë të ndjeshme, por qasja në këto çështje i përngjan më shumë një top ping-pongu që na bën joseriozë karshi opinionit dhe karshi qytetarëve dhe gjithsesi unë mendoj se duke u nisur prej Qeverisë, ministrave e deri te hierarkia atje poshtë të jepet përgjegjësi dhe njëherë e përgjithmonë të mësohen njerëzit në pozicione të caktuara se duhet ndier përgjegjës për punën që e bëjnë dhe natyrisht të japin përgjegjësi për punën që s'e bëjnë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Nezir Çoçaj e ka fjalën. Le të përgatitet Vjosa Osmani!

NEZIR ÇOÇAJ: I nderuar nënkryetar i Kuvendit,
Kryeministër, ministra,
Të nderuar deputetë,
Sot jemi mbledhur të diskutojmë për një rast tragjik, atë të vdekjes në burg të Astrit Deharit.

Ndonëse për një debat të tillë do të duhej pritur përfundimin e hetimeve në mënyrë që ta kishim të zbërthyer në detaje tërë rrëfimin. Fillimisht do të duhej të kishim të përfunduar hetimin e sulmit me granatë mbi Kuvendin e Republikës së Kosovës, për ç'gjë ishte arrestuar Astrit Dehari bashkë me aktivistë të tjerë të “Vetëvendosjes” si i dyshuar për një vepër terroriste.

Do të duhej të kishim të përfunduar hetimin mbi vdekjen e tij dhe në rast të kualifikimit si vetëvrasje, ashtu siç thotë edhe raporti i autopsisë, do të duhej të kishim hetime shtesë, të cilat do ta ndriçonin edhe arsyen që e kishte çuar të ndjerin drejt një akti të tillë.

Të nderuar kolegë deputetë,
“Vetëvendosja”, për fat të keq, qëllimisht shpërfill provat, qëllimshëm keqinterpretonte ngjarjen, qëllimshëm ndërton rrëfime të tilla në mënyrën që i konvenojnë asaj.

“Vetëvendosja” nuk pranon raportin e autopsisë të mjekëve ligjorë, nuk pranon hetimet e autoriteteve të drejtësisë kosovare, nuk pranon deklaratimet e Policisë së Kosovës, nuk pranon qëndrimet e drejtësisë së Kosovës. Pra, “Vetëvendosje” në fakt nuk pranon asgjë të Kosovës, siç nuk e pranon as shtetin, as flamurin, as simbolet.

“Vetëvendosje” në të vërtetë pranon vetëm diçka nga Kosova: paranë e saj. Atë nuk e refuzon dhe deputetët e “Vetëvendosjes” i pranojnë pagat e Kosovës, ndërsa mohojnë gjithçka tjetër të Kosovës. Të gjitha mund t'i bëjnë, por një gjë është e pafalshme: të luajnë me të vdekurit.

Të nderuar qytetarë të Republikës së Kosovës,
Ajo që është më shqetësuese për shoqërinë tonë, është shfrytëzimi i kësaj tragjedie për interesa politike, e cila fatkeqësisht po bëhet filozofi e politikës së “Vetëvendosjes” për të ardhur në pushtet.

Të nderuar kolegë,
Më lejoni që në fund të fjalimit tim të kërkoj që shtytësit dhe përgjegjësit, kushdo qofshin ata, të japin përgjegjësi morale, e sidomos ligjore, jo vetëm për rastin “Dehari”, por edhe për raste të tjera. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka deputetja Vjosa Osmani. Le të bëhet gati deputetja Donika Kadaj-Bujupi!

VJOSA OSMANI: Faleminderit, i nderuar kryesues!

Të nderuar deputetë,

E nderuar familje Dehari,

Ne do të jepnim shembull të mirë si Kuvend i Kosovës dhe si institucione në qoftë se prindërit e Astritit sot do të ishin këtu, duke treguar besim në këto institucione dhe duke treguar se nuk jemi në rrugë të gabuar.

Mirëpo, fatkeqësisht, siç u tha edhe nga shumë kolegë, këto 17 vjet pas luftës kanë dëshmuar një dështim total jo vetëm të sistemit politik, por edhe të sistemit të drejtësisë dhe në qoftë se nuk u besojmë vlerësimeve të njëri-tjetrit rreth mosbesimit të qytetarëve në sistem të drejtësisë, mjafton t'i lexojmë raportet çdo 6 muaj qoftë nga NDP, qoftë nga organizata të tjera ndërkombëtare, të cilat na e përplasnin këtë të vërtetë para syve.

Është shumë me rëndësi të thuhet se kush ishte Astriti, është me rëndësi që ishte i ri, sepse mbi 70% të qytetarëve të Kosovës që janë nën 30 vjeç një ditë duhet të ndërtojnë besim në institucionet e Kosovës dhe për momentin nuk e kanë, për fajin e të gjithë neve dhe po ashtu ishte me rëndësi të thuhet se u kthye nga Zvicra me ëndrra për Kosovën, së shpejti do të bëhej mjek, jo duke blerë nota, por, sipas atyre që e njihnin, me punë dhe studim të pashembullt dhe ishte një bashkëshort dhe prind në pritje.

Përtej përkatësisë politike, përtej akuzave për politizim të rastit, ne jemi përfaqësues të popullit, nuk jemi diplomatë këtu e të përdorim gjuhë diplomatike. Ne duhet të flasim gjuhën e qytetarëve, gjuhën e atyre 24 000 nënshkruesve, të cilët po kërkojnë hetim të pavarur dhe drejtësi për Astritin.

Pra, duhet të flasim edhe si prind, duhet të flasim edhe si qytetarë dhe duhet të kërkojmë që, në qoftë se kanë mbetur qindra vrasje e qindra vdekje të dyshimta të pandriçuara deri tani, të punojmë të gjithë bashkë që rasti i Astritit të bëhet simbol i drejtësisë në këtë vend.

Është e papranueshme të themi se shteti ka bërë gjithçka. Është po ashtu e papranueshme të themi se duhet t'u besojmë këtyre institucioneve dhe këtu përfundon gjithçka, sepse nga kolegët e mi, më herët, u përmend atentati ndaj presidentit Rugova, ndaj shumë kolegëve të mi që nuk janë zbardhur kurrë, dhe ne nuk u kemi besuar institucioneve vendore.

Ne kemi kërkuar themelimin e një Gjykate Speciale, ku këto çështje do të trajtohen nga ndërkombëtarë. Kemi kërkuar përgjigje nga EULEX-i, kemi kërkuar përgjigje nga UNMIK-u pikërisht për shkak të dështimit të sistemit tonë të drejtësisë.

Prandaj, tani të mohohet një përgjigje dhe një hetim i tillë i pavarur ndërkombëtar për raste të tjera, është e pafalshme, sidomos kur i kemi dy ekspertiza, me dy përgjigje dhe dy konstatime totalisht të kundërta. Njëra, pra kjo e porositur nga familja që përfshin një mjek nga Anglia, Besim Latifaj, i cili punon dhe është pjesë e NQS-sistemit publik anglez të shëndetësisë, ku nuk mund të hysh me të njohshëm, këtë e dimë të gjithë, dhe i cili ka kryer me mijëra e mijëra autopsi. Mirëpo atij nuk i besohet, e ndoshta është dashur patjetër të ketë emrin Majkel, Jon, apo emër tjetër.

E dyta, është me rëndësi që materialin e petitionit ta kenë deputetët. Unë nuk e di si kanë shkuar procedurat, mirëpo çdo letër që na ka ardhur prej secilit qytetar këtyre viteve na ka ardhur në boks, kjo s'ka ardhur fare, edhe pse u është drejtuar deputetëve.

Është me rëndësi të merret seriozisht fakti që përderisa është krijuar një mosbesim kaq i madh jo vetëm prej qytetarëve që janë jashtë institucioneve, por edhe prej neve brenda që jemi, patjetër institucionet përgjegjëse të kërkojnë vetë hetim të pavarur ndërkombëtar, sepse është i domosdoshëm dhe përkundër refuzimit të shtetit anglez, duhet të gjenden opsione të tjera.

Ky do të duhej të ishte patjetër konstatimi i parë i kësaj seance. Pra, Kuvendi i Kosovës të kërkojë hetim të pavarur ndërkombëtar.

Konstatimi i dytë që do të duhej bërë nga ana e këtij Kuvendi është përgjegjësia e shtetit për raste të tilla. Përgjegjësinë e shtetit për raste të tilla e ka çimentuar vetë Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës.

Po jua rikujtoj rastin e Diana Kastratit, e cila është vlarë nga bashkëshorti i saj. Nuk është çuar shteti ta marrë revolen në dorë dhe ta vrasë Dianën, mirëpo shteti nga ana e Gjykatës sonë Kushtetuese është konstatuar të jetë fajtor për shkelje të së drejtës në jetë të Dianës. Pse? Gjykata thotë se është detyrim i organeve shtetërore që jo vetëm të përmbahen nga marrja e qëllimshme e jetës, por gjithashtu të ndërmarrin hapa të duhur për mbrojtjen e jetës së individëve brenda juridiksionit të tyre.

Është detyrim parësor i shtetit që të sigurojë të drejtën në jetë dhe të ndëshkojë shkeljen e dispozitave, të cilat kërkojnë mbrojtjen nga shteti.

Gjithashtu obligim i shtetit, sipas kësaj Gjykate, është detyrimi pozitiv për autoritetet që të marrin masa parandaluese. Masa parandaluese për të parandaluar që një qytetar, në qendër korrektuese, në burg, në një vend që do të duhej të ishte i sigurt, ta humbë jetën pavarësisht se cili është përfundimi i njëres autopsi apo tjetres.

Duke e ngritur këtë detyrim pozitiv të shtetit, duke e pranuar këtë detyrim kushtetues nga neni 53 i Kushtetutës, ne si Kuvend i Kosovës do të krijojmë një precedent, një shembull të mirë të përgjegjësisë dhe të respektimit të detyrimeve që shteti i ka ndaj të gjithë qytetarëve të vet.

Nuk përfundon detyrimi i shtetit vetëm në dërgimin e disa letrave. Shteti e kryen obligimin e vet në momentin kur i ndërmerr të gjitha masat për mbrojtjen e qytetarit të vet.

Unë shpresoj shumë që familja Dehari, në qoftë se askush tjetër, do ta ndjekë deri në fund këtë rast dhe do të shfrytëzojë të drejtën e vet që ta dërgojë këtë rast në Gjykatën Kushtetuese, njëjtë sikur e kanë dërguar Gëzim dhe Makfir Kastrati, prindërit e Diana Kastratit, në mënyrë që edhe një herë kjo Gjykatë të konstatojë se cila është përgjegjësia e shtetit në raste të tilla kur qytetarët vdesin në duar të shtetit. Po e përsëris, vdesin. Pra, pa paragjykuar se cili ka qenë shkaku i kësaj vdekjeje të dyshimtë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e merr deputetja Donika Kadaj. Le të përgatitet Hajder Beqaj.

DONIKA KADAJ-BUJUPI: Të nderuar qytetarë të Republikës së Kosovës,
Deputetë të pranishëm,

Më 25 gusht të këtij viti Isa Mustafa, në një postim të tij në rrjetet sociale e drejtoi gishtin e dorës, atë me të cilin e nënshkroi “Zajednicën” kundër Lëvizjes “Vetëvendosje”. Specifikisht kundër aktivistëve më të mirë të saj, të cilët e kundërshtuan këtë marrëveshje.

Ai në këtë postim e ndërlidhi gazin lotsjellës në sallën e Parlamentit me hedhje të mjeteve shpërthyes në shtëpi private dhe televizionin publik dhe me gjuajtje me armë të rënda në ndërtesën e Parlamentit. Pra, kryeministri Mustafa dha verdiktin kundër “Vetëvendosjes”.

Këtë sot provuan ta bëjnë edhe disa, duke provuar të tërheqin paralele ndërmjet Astrit Deharit dhe të vrarëve në Siri.

A s’është kjo e turpshme?!

Pra, ju qysh në gusht dhatë verdiktin për subjektin më të madh opozitar në vend. Atëherë s’e kishte problem kryeministri të ndërhynte në drejtësi. Madje, të bëhej vetë polic, vetë hetues, vetë prokuror, vetë gjykatës në një gjyq publik.

Kështu, një kryeministër, në moshë goxha të shtyrë dhe me përvojë nga e kaluara e tij, urdhëroi praktikisht që të arrestohen 6 studentë, aktivistë politikë, në mënyrë që t’i privojë nga liria dhe t’ua pamundësojë rezistencën atyre që pamundësuan realizmin e projekteve të tij të dëmshme antikushtetuese e të parealizueshme që na i solli nga Beogradi.

Pas kësaj deklarate të kryeministrit, e gjithë makineria shërbyese e këtij regjimi, duke filluar nga policia, prokuroria, gjyqtarët e për të kaluar te drejtuesit e RTK-së u angazhuan në një fushatë të egër, që provonte me të gjitha format, por pa asnjë argumente, arsyetime e akuza për atë që do të ndodhë më 29 gusht.

Pra, këta orkestruan ngjarjet dhe deklaratat për të ardhur te dita kur do t'i gjykonin të rinjtë e pafajshëm, aktivistë politikë opozitarë vetëm pse të njëjtit përbënin rrezik për vendimet e tyre kuislinge.

Në mëngjesin e 29 gushtit, si zakonisht dhe siç zakonisht bëjnë regjimet totalitare, herët në mëngjes, u futën me dhunë të armatosur me njësitë speciale në shtëpitë e 6 aktivistëve.

Astritin e gjetën zgjuar, duke lexuar për të përgatitur provimin e radhës, madje një nga provimet e fundit të tij në Fakultetin e Mjekësisë.

Çka ndodhi pas kësaj dhe si u përpoqën që nëpërmjet goditjeve vdekjeprurëse ta shkatërrojnë Lëvizjen duke e shpallur organizatë terroriste, tashmë është e njohur për opinionin. Astritin, Egzonin e Attheun i ndalën në burg, kurse Frashërin, Adenë e Petritin, në arrest shtëpiak. Dhe, më 5 nëntor të vitit 2016, pra 45 ditë nga sot, spiralja e dhunës na çoi në tragjedi. Astriti u gjet i vdekur në qelinë e tij, në burg, në rrethana thellësisht të dyshimta, në vendin ku për jetën e tij ishte përgjegjës shteti dhe mbi të gjitha ky pushtet, i cili e arrestoi dhe e mbajti aty padrejtësisht.

Ajo çka ndodhi më pas, ishte përsëritje dhe thellim i veprimeve kriminale fillestare. Deklarata e kundërtënie, të cilat edhe më shumë rëndonin barrën dhe dhembjen e familjes dhe të miqve e bashkudhëtarëve të Astritit, u lansuan nga shërbyesit e regjimit.

Ndërkohë, që në periudhën pas luftërave ballkanike të viteve të 90-ta Astriti ishte rasti i parë kur një i burgosur politik vdes në burg, madje vdes në paraburgim, i pafajshëm, duke u mbajtur si peng për qëllime politike.

Rasti i Astritit tronditi opinionin dhe nxiti reagime të shumta të institucioneve, edhe ndërkombëtare.

Po e marr shembull Parlamentin Evropian, në kuadër të Komisionit të përbashkët për stabilizim-asociim, më datën 24 nëntor të vitit 2016, në Strasburg, ka përfshirë në rekomandime për Republikën e Kosovës si në vijim:

Pika 10, amendamenti: “I dërgoj ngushëllime familjes dhe miqve të aktivistit të ri politik, zotit Astrit Dehari, i cili vdiq në arrest, në rrethana të dyshimta dhe nxis autoritetet kompetente që t'i hulumtojnë thellësisht të gjitha rrethanat e vdekjes së tij, përfshirë çdo spekulim, akuzë për

përdorim të tepërt të forcës nga ndonjë agjent i zbatimit të ligjit si dhe për përgjegjësinë e mundshme të institucioneve shtetërore.

Deklaroj se në rast që ka ndodhur ndonjë veprim keqberës, atëherë duhet të përndiqet dhe të dënohet, e të përdoret si shembull”.

Erdhën edhe reagime nga ministri i Jashtëm britanik, i cili po ashtu ftoi për një hetim të pavarur. Reagan nëpërmjet deklaratave Sivil Reicht Difenden, u diskutua në Këshillin e Sigurimit, reagoi Internacionalja socialiste më 7 nëntor, ambasadori britanik më 8 nëntor, ambasadori amerikan po ashtu më 8 nëntor, ministri i Jashtëm britanik, deklaratë erdhi edhe nga Suzan Auer, sekretare e përgjithshme e një organizate joqeveritare në Zvicër, reagan organizatat qeveritare dhe joqeveritare nga Danimarka, asamblistë dhe deputetë, Partia Demokratike dhe Lulzim Basha, organizata të ndryshme vendore dhe ndërkombëtare, u angazhuan shoqëria civile nëpërmjet protestave të shumta dhe nëpërmjet peticionit, së fundi, ndërkaq ky Kuvend heshti.

Për më tepër, vepron kundër përpjekjes sonë të përkrahur edhe nga një numër i deputetëve të pozitës për një seancë të jashtëzakonshme, menjëherë pas vdekjes së Astritit, me aludimin dhe në emër të mospërzierjes në drejtësi, pikërisht bëri padrejtësinë më të madhe, duke mohuar drejtësinë për Astritin.

Madje, duke shkuar aq larg sa që disa prej deputetëve, të cilët fillimisht nënshkruan, u detyruan t’i tërhiqnin nënshkrimet e tyre.

Po tash, kur hetimet për Astritin s’kanë përfunduar ende, a nuk po interferoni ju në drejtësi? Pse u angazhuat në këtë seancë të improvizuar pa asnjë rekomandim? A është arsyeja e vetme sepse po përpiqeni t’u shmangeni rekomandimeve dhe kërkesave të 23.000 qytetarëve dhe shoqërisë civile, të cilët po presin jashtë. Na thoni a është kjo arsyeja që sot, në këtë mënyrë, e thirrët këtë debat?

Pavarësisht veprimeve tuaja, tani adresa e përgjegjësisë dihet. Tanimë po dihen edhe arsyet pse s’po dorëhiqeni. Sepse, s’jeni të gatshëm të hapni rrugë për hetime të pavarura, sepse ju mund të mbijetoni vetëm nga varësia e ndërsjellë që e keni.

Vetëm të varur nga njëri-tjetri ju mund të mbijetoni në një shtet, ku drejtësinë e bëjnë kriminelët dhe e pësojnë të ndershmit dhe të pafajshmit.

Kjo që po bëni ju sot është farsë e një tragjedie. Së pari montuat, tash tentoni të çmontoni rastin heshtazi. Por kjo tashmë është e pamundshme, sepse Astriti ka vdekur dhe se ju duhet të jeni përgjegjës për këtë. Ju keni për të dhënë përgjegjësi, sepse s’mund të ketë drejtësi pa përgjegjësi! S’mund të ketë drejtësi pa përgjegjësi dhe jeni ju përgjegjës!

Ne nuk do të ndalemi asnjëherë, me asnjë çmim dhe për asnjë ditë dhe do të vazhdojmë të kërkojmë drejtësi për Astritin. Vendosjen e saj e pengoni ju, madje po ju pengon edhe debati, ashtu siç ju ka penguar seanca, sepse i keni thirrur deputetët një nga një. Keni ushtruar presion, keni ushtruar shantazh, i keni kërcënuar dhe detyruar, madje ua keni shkruar tërheqjen e nënshkrimit, deputetë me emër e mbiemër.

(Ndërhyrje)

Ju jeni përgjegjës që s'lejuat që në Kosovën e pasluftës të ketë një mirëqenie të dinjitetshme për të gjithë të rinjtë e të rejtat që janë bashkëmoshatarë të Astritit. Mirëpo, falë punës dhe angazhimit të Astritit dhe dashurisë që ai kishte për vendin, Astriti ka shumë shokë dhe shoqe, të shumtë i ka edhe miqtë e kolegët, dhe e ardhmja është e tyre. Ndërsa, ju i keni ditët e numëruara në këtë pushtet, e besa disa edhe ditët e numëruara në liri.

(Drejtimin e mbledhjes e merr nënkryetari i Kuvendit, z. Xhavit Haliti.)

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Beqaj e ka fjalën.

HAJDAR BEQAJ: Faleminderit, kryesues!

I nderuar kryeministër,

Kabinet qeveritar,

Të nderuar deputetë,

Të nderuar qytetarë të Republikës së Kosovës,

Ne realisht, këtë që e tha edhe parafolësja, të gjithë këtu jemi të thirrur të kërkojmë drejtësi, dhe jo vetëm të bëjmë zhurmë për drejtësi.

Edhe kjo seancë mendoj se e ka këtë karakter dhe mendoj se është seancë e qëlluar. Këtë ta arsyetoj edhe në fjalimin tim.

Fillimisht i shpreh ngushëllime familjes Dehari për humbjen e më të dashurit të tyre. Fatkeqësisht, institucionet e Kosovës, në këtë rast institucionet e zbatimit të ligjit ende nuk e kanë besimin e të gjithë qytetarëve dhe politikëbërjes në Kosovë. Kjo ka shtyrë që ne si deputetë të Kuvendit të Kosovës të kërkojmë seancë të jashtëzakonshme parlamentare rreth rastit tragjik të humbjes së jetës së zotit Astrit Dehari në burgun e Prizrenit.

Të nderuar kolegë deputetë,

Ka qenë shumë johumane gjatë gjithë kësaj kohe përpjekja e deputetëve të “Vetëvendosjes” për të përfutur politikisht prej fatkeqësisë së rastit Dehari dhe tragjedisë së familjes së tij.

Është johumane të pretendohet të përfitohet politikisht, të gjithëve na duhet gjendja faktike. Gjendja faktike është interes i shtetit, gjendja faktike është në interes të të gjitha institucioneve, por edhe të familjes dhe të imazhit të vendit.

Keni folur çka keni dashur dhe keni bërë propaganda sa keni pasur qejf, kurse ne për hir të ndjeshmërisë së rastit, që të mos i lëndojmë familjarët e tij, kemi hezituar të themi edhe atë që tha ekspertiza mjeko-ligjore.

Për çdo vrasje apo vetëvrasje fillimisht hetohen motive që kanë shtyrë drejt kësaj. Cili mund të ishte motivi të vritet Astrit Dehari? Ai ka qenë thjesht njeri sikur të gjithë moshatarët e tij që e ka pasur jetën përpara, jetën të cilën ju Lëvizja “Vetëvendosje” ia keni mbushur me ideologjinë tuaj.

Askush nuk ka përfituar politikisht prej vdekjes së tij, përveç ju që po mundoheni të fitoni në tragjedinë që i ka ndodhur familjes Dehari.

Ju edhe vetë e dini se çfarë i keni shtyrë të bëni këta të rinj, duke ua shpëlarë trurin atyre.

Astrit Dehari nuk ishte i burgosur politik, siç keni propaganduar deri tani. Ai ishte në paraburgim nën dyshimin e veprës penale për terrorizëm. Këtë duhet ta thotë drejtësia, ai ishte i akuzuar dhe derisa nuk ka një vendim të prerë nga gjykata është vetëm i dyshuar, por ka qenë për vepër terrorizëm, jo i burgosur politik. Këtë duhet ta kemi të qartë, pavarësisht cilës familje i ndodh, në këtë rast familjes së nderuar Dehari.

Për mua është e paqartë nëse dikush dyshohet për terrorizëm dhe arrestohet për një vepër të tillë, si mund të lejohet nga organet e drejtësisë, në këtë rast të vizitohet nga ideatori, sekretari i “Vetëvendosjes”, Dardan Molliqaj. Edhe për këtë, mendoj që edhe drejtësia duhet ta bëjë një sqarim.

Ditari i të ndjerit Dehari, i publikuar në shumë portale në vend thotë shumë. Në ditarin e zotit Dehari thuhet se si sekretari i Lëvizjes “Vetëvendosje” i kishte thënë për faktet që kishin dalë në publik, sepse me këto fakte, sipas ditarit të tij, Molliqaj kishte thënë se do të merremi në Lëvizja “Vetëvendosje”. Këtë po e them në bazë të ditarit që u publikua në portale në Republikë të Kosovës.

Në ditarin e tij zoti Dehari ankohet se si i binte të fliste shumë pak me familjarët e tij për arsye që ju e pengonit, sepse asnjëherë nuk e keni lejuar të qëndronte vetëm me familjarët e tij, edhe pse familja është e shenjtë dhe njeriu ka nevojë edhe në gëzime, edhe në hidhërime të jetë afër tyre.

Nuk është e kuptueshme pse çdo herë në vizitën e familjarit të Astrit Deharit duhet të jetë edhe një zyrtar i lëvizjes tuaj.

Në bazë të kësaj, i bie se ju keni ushtruar regjim ndaj atyre djemve edhe në paraburgim, apo edhe ne tash mund të dyshojmë pse të jetë çdo herë dikush nga politika në paraburgim me familjen.

Mos mendoni se nuk dihet se si i keni përdorur ndikimet për ta lëshuar në arrest shtëpiak mbesën e kryetarit tuaj, zotit Visar Ymeri dhe djalin e ish-gjyqtares Marija Ademi, të cilët kanë qenë me të njëjtën aktakuzë, me të njëjtin grup, me të njëjtin dyshim. Nuk po them që kanë qenë as këta fajtorë, as ata fajtorë, por po flas në bazë të raporteve të prokurorisë dhe të policisë, që janë tashmë të njohura për publikun.

Ne të gjithë jemi të interesuar të zbardhet vrasja e Astrit Deharit, sepse zbardhja e këtij rasti është në interes të familjes, në interes të institucioneve të vendit, në interes të imazhit të vendit dhe në interes të të gjithë qytetarëve të vendit tonë.

Ne në këtë rast kemi dy raporte të publikuar kontradiktore. Një raport e kemi nga ekspertiza mjeko-ligjore, që unë si institucionalist, në këtë rast, jam ithtar që t'i besojmë, por kur kemi raste kur nuk pajtohet familja, atëherë kemi pasur edhe një ekspertizë tjetër, një raport që u lexua për publikun nga avokati i familjes, zoti Tomë Gashi. Këto dy raporte janë shumë kontradiktore dhe unë si deputet i këtij parlamenti mendoj edhe kërkoj që duhet të bëhet një subekspertizë, apo një ekspertizë e tretë, pavarësisht a bëhet vendore apo ndërkombëtare, që të zbardhet ky rast dhe të sqarohet me të vërtetë si e ka humbur jetën, tash në këtë rast i ndjeri zoti Astrit Dehari. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Ibishi e ka fjalën, të përgatitet Besa Baftija.

NUREDIN IBISHI: I nderuar zoti nënkryetar, kryesues i Kuvendit,

Të nderuar deputetë,

I nderuar zoti kryeministër dhe kabinet qeveritar,

Të nderuar qytetarë,

E nderuar familje Dehari, ngushëllimet më të singerta!

Së pari duhet të shpreh arsyen e nënshkrimit për seancën e sotme të jashtëzakonshme lidhur me rastin e Astrit Deharit si dhe mosnënshkrimin e mëhershëm me iniciativën e Lëvizjes “Vetëvendosje”.

Për seancën e sotme të jashtëzakonshme kam pritur se do të kemi një raport të Komisionit mjeko-ligjor dhe një të tillë jo të marrim nga mediat, tjetra është lidhur me petitionin duhet të kishim pasur raportin e Komisionit për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjimore, Persona të Pagjetur dhe Peticione lidhur me shqyrtimin e petitionit të 23 mijë e 774 qytetarëve.

Pra, të kemi një bazë, mbi të cilën do të kishim nisur edhe diskutimin dhe kjo është arsyeja pse atëherë nuk e nënshkrova me iniciativën e “Vetëvendosjes”, mendova që sot do t’i kemi këto dy materiale.

Mendoj që nuk është e mjaftueshme hyrja e iniciuesit të kësaj seance për vetëm shqetësim të opinionit, por për humbjen e jetës të një të riu në institucionin korrektues.

Në këtë rast, kur Astriti ka ndërruar jetë, mbajtja e një seance të jashtëzakonshme për rastin Dehari nuk është ndërhyrje në drejtësi, si pushtet i pavarur.

Habitem nga një numër i parafolësve kur shprehin mosbesim dhe skepticizëm të thellë në institucionet e pavarura, sikur hetimi nga prokuroria kompetente dhe policia, si dhe raportin e Komisionit mjeko-ligjor, kur apriori kërkohet ndihmë nga institucionet edhe ndërkombëtare për hetime, sikur që është rasti i Mbretërisë së Bashkuar “Skotland Guard” dhe ndonjë superekspertizë me ndihmë nga ndonjë ekip ndërkombëtar të pavarur mjeko-ligjor.

Kodi i procedurës penale e përcakton në mënyrë të saktë dhe kjo e drejtë mund të realizohet, por normalisht duke e pritur Komisionin apo Komisionin mjeko-ligjor të rregullt në bazë të kompetencës.

Deri kur do të na dërgojë mosbesimi në institucionet e pavarura të hetimit, domethënë edhe të Policisë, edhe të Prokurorisë vendore si dhe të gjyqësisë.

Ky nivel mosbesimi i institucioneve vendore të hetuesisë po na kujton task-forcën në rastin e vjedhjes në Dhomën e Dëshmive, për të cilën kam qenë kundër publikisht, të cilën edhe ua kam atribuuar çdo herë këtë kompetencë institucioneve vendore, e jo një krijese ad hoc, sikur që u krijua task-forca.

Lidhur me këtë kemi pasur rast të dëgjojmë shpesh nga autoritetet e Policisë së Kosovës, duke thënë se në procedurë është rasti i vjedhjes në Dhomën e Dëshmive, ndërsa vërtet është kompetencë e policisë së EULEX-it, ndërsa them që kjo është kompetencë e policisë vendore, gjegjësisht e Policisë së Kosovës. Kjo është sikur një lloj, të them ashtu, e pingpongut.

E ku është task-forca fantome, pra ajo u shkri sikur bora e parvjetme, si thotë një fjalë e popullit, rasti mbetet enigmatik dhe në kompetencë të askujt.

Prandaj, për fund kërkoj që institucionet dhe organet e pavarura dhe kompetente vendore të zbatojnë detyrat ligjore lidhur me këtë rast, e më pastaj të kërkohet hetim i pavarur ndërkombëtar.

Gjithashtu, institucionet kompetente duhet të kishin ndërmarrë edhe masa të menjëhershme ndaj përgjegjësve në këtë rast, të ishin më transparentë ndaj opinionit dhe të pengonin rrjedhën joligjore të provave dhe të dhënave në fazën e hetimit penal. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zonja Baftija e ka fjalën.

BESA BAFTIJA: Faleminderit, kryesues!

Të nderuar qytetarë,

Të nderuar deputetë e deputete,

Është detyrë e gjithë shoqërisë, përfshirë edhe partitë në pushtet, gjegjësisht ju deputetë të shumicës parlamentare, që sot të kërkonin përgjegjësi institucionale për vdekjen e dhunshme të Astrit Deharit.

Astritin e vranë, sepse cilado të kishte qenë mënyra e vdekjes së tij, Astriti vdiq në duar të shtetit. Prandaj, atë e vrau shteti, për të cilin Astrit jo vetëm qëndronte, por edhe punonte pa u ndalur. Për një shtet demokratik kujdesi për këdo të ishte i garantuar. Por shteti që tash e kemi është shteti ku në njërin anë të burgosë si të dyshuar për sulm ndaj ndërtesës së Kuvendit, e në anën tjetër institucionet e dala po nga ky shtet, siç është Universiteti i Prishtinës, gjegjësisht profesorët e Fakultetit të Mjekësisë, Astritin e vlerësojnë dhe e nderojnë si studentin e tyre shembullor. E pra ajo që kurrë s'e kemi menduar se do të ndodhë në shtetin tonë në liri, është dyshimi, akuza ndaj një studenti shembullor të mjekësisë.

Mbajtja e tij në paraburgim për 68 ditë, pa asnjë provë, e më pas të vdesë dhunshëm e të mos i afrohet edhe ndihma e parë në vendin ku mbahej i mbyllur nga shteti, a nuk është kjo privim i së drejtës për jetë me paramendim.

Deklaratat kontradiktore të dhëna menjëherë pas ngjarjes së tmerrshme çojnë në këtë drejtim.

Derisa thuhet se vdiq nga mbidoza e barnave, ka vdekur rrugës për në spital, ka ardhur pa shenja jete në spitalin e Prizrenit, ndërsa, në anën tjetër, në raportin e Qendrës Kosovare për Rehabilitimin e të Mbijetuarve të Torturës është evidentuar se Astrit Dehari është gjetur në qeli me puls dhe frymëmarrje, këtë fakt e ka evidentuar infermierja kujdestare.

Në bazë të asaj që ne kemi parë në incizimet e kamerave, nëse ato janë reale, ne jemi të bindur se nuk i është dhënë ndihma e duhur mjekësore në momentin e duhur, sepse shihet qartë në fillim vonesa e ardhjes së motrës që është rreth 4 minuta, mosreagimi i saj brenda në dhomë, duke e parë se ka qenë pa asnjë mjet të nevojshëm për animim. Ajo hyn në dhomë, qëndron 19 sekonda, del në korridor dhe vërehet qartë reagimi i saj shumë i ngadalshëm dhe mosmenaxhimi i situatës, sepse bartja e Astrit deri te dhoma e trajtimit shëndetësor, siç e kemi parë, bëhet jashtë çdo standardi.

Vonesa në reanimim dhe pa mjete të nevojshme ka ndikuar që Astriti të mos kthehet në jetë nëse vërtet është gjetur me shenja jete. Po e them këtë me përgjegjësi, sepse Komisioni për Shëndetësi ishim në vizitë të kësaj qendre, ku pamë ambulancën që është brenda Qendrës së paraburgimit në Prizren. Është tmerr se në çfarë kushtesh punohet aty, pa mjetet elementare të domosdoshme për reanimim, e që do të duhej t'i kishte çdo ambulancë shëndetësore, t'i posedonte të gjitha, e aq më shumë një institucion korrektues.

Çfarë mungonte aty? Nuk kishte ambuballon, nuk kishte laringoskop, tubues andotreal, nuk kishte defirbilator. Hapësira në të cilat afroheshin shërbime shëndetësore është jashtë çdo standardi, sepse në të njëjtën hapësirë punon mjeku i përgjithshëm, psikologu, psikiatri si dhe stafi i mesëm shëndetësor. Ata pretendojnë si i kanë dhënë ndihmën e parë, ndërkohë që nuk ekzistojnë mjetet, plus edhe vonesën nëse ia shtojmë për të bërë diçka të tillë, për të shpëtuar jetë.

Përgjegjësi tepër e madhe bie mbi ministrin e Shëndetësisë që i ka në përgjegjësi këto njësi shëndetësore brenda qendrave korrektuese.

U njoftuam që u pezullua punonjësja, por jo edhe eprorët e saj që e kanë detyrë t'i sigurojnë pajisjet për mbarëvajtjen dhe kushtet bazike për ofrimin e shërbime shëndetësore brenda këtyre qendrave.

Po ashtu, të dhënat e fundit të autopsisë të bëra nga ekspertë të pavarur nxjerrin si përfundim se vdekja e Astrit Deharit ka qenë e dhunshme që është shkaktuar nga asfiksoni apo mungesa e oksigjenit, e që është bërë nga mbyllja në mënyrë mekanike e organeve të rrugëve të frymëmarrjes.

Në anën tjetër, konkluzioni i nxituar, por jo pa qëllim, i nxjerr nga kryeprokurori Sylë Hoxha, i cili mes të tjerash iu referua edhe raportit të Mjekësisë Ligjore të Kosovës, është jo vetëm i pabesueshëm, por edhe një tentativë mashtrimi.

Edhe më laiku në fushën e mjekësisë e ka të qartë se ka mekanizma mbrojtës të organeve të frymëmarrjes, të cilët do të bënin të pamundur vetëshkaktimin e asfiksionit. Në atë mënyrë, këto mekanizma të organizmit njerëzor as qenia njerëzore me vetëdije nuk do të mund t'i kontrollonte dhe kjo normalisht do ta kthente edhe frymëmarrjen normale.

Unë jam me profesion mjek neonatologe, çdo ditë të jetës sime profesionale përballem në situata kur të porsalindurve duhet t'u asistoj, menjëherë pas lindjes, varësisht prej gjendjes së tyre.

Për këdo që nuk është e fushës mund t'u them me përgjegjësi të plotë se edhe një foshnjë e porsalindur që ka nevojë për ta ndihmuar për t'ia nxitur frymëmarrjen është shumë vështirë të vendosësh gypin në rrugët e frymëmarrjes vetëm nëse foshnja ka frymëmarrje, e këtë duhet ta bëjnë vetëm nëse i japim relaksant.

Sigurisht që ka qindra detaje të këtij lloji që nuk përkojnë me çfarë është shkruar në raportin mjekësor të autopsisë, ashtu edhe pretendimet e deritanishme të Prokurorisë së Prizrenit, ato detaje pa dyshim që do të jenë pjesë e një hetimi që do të duhej të jetë i pavarur dhe sigurisht i garantuar jo nga ata që e kanë kontaminuar gjithë procesin që prej fillimit. Duhet ta dini qartë që një komunitet i tërë mjekësor në Kosovë është duke ndjekur këtë proces me shumë vëmendje dhe nga të gjithë ata kemi marrë mendime, sugjerime, të cila të gjitha na çojnë, na dërgojnë në të njëjtin drejtim.

Ju përkohësisht i keni në dorë organet e hetimit policor, po ashtu padrejtësisht e keni në dorë edhe një pjesë të sistemit të drejtësisë, por ta dini, kjo nuk do të vazhdojë gjatë. Ne nuk jemi ndalur kurrë, tash jo vetëm që kemi vullnetin për të shkruar deri në fund të vendosjes së drejtësisë, por kemi edhe detyrim absolut për të bërë këtë.

Astrit Dehari ishte aktivist politik, ishte student i Kosovës, është shqiptari i ri që e donte atdheun pa asnjë kusht, por mbi të gjitha ishte biri i nënë Xhemiles, e prej 5 nëntorit është biri i të gjitha nënave të Kosovës.

Nëse për asgjë tjetër, atëherë për qetësinë e shpirtit të prindërve, të bashkëshortes, të motrës, të shokëve të Astritit pas kësaj vdekje misterioze do të duhej të bëhej një hetim i pavarur ndërkombëtar.

Dhe krejt në fund do t'u isha përgjigjur deputetëve të pozitës, të cilët ngrenë këtu skepticizëm apo thanë akuza të pabaza, kur thanë se Lëvizja "Vetëvendosje" nuk i njeh institucionet e Kosovës, nuk e ka njohur edhe raportin e fundit, të dhënë nga ekspertiza e mjekëve tanë. Mirëpo, unë po u them deputetëve, kolegëve të mi, se ne jo vetëm që nuk i njohim, por ne i mbrojmë institucionet e Kosovës, ne burgosemi për to, bile e paguajmë edhe me jetë, siç është rasti i Astrit Deharit.

Në rastin konkret të mjekët ligjorë si t'i besojmë mjekut ligjor Naim Haliti, kur i cili para 5 vjetësh ka dhënë një raport, i cili ka qenë për një vajzë që ka qenë e aksidentuar, ka dhënë raportin ku thuhet se ka pasur lëndime të lehta trupore. E njëjta vajzë sot është e palëvizshme dhe ka qëndruar për një kohë të gjatë edhe në komë.

Prandaj, ne edhe këtu në Kuvend si Lëvizje "Vetëvendosje" kërkojmë që të bëhet një hetim i pavarur ndërkombëtar. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zonja Safete Hadërgjonaj e ka fjalën.

SAFETE HADËRGJONAJ: Faleminderit, nënkryetar!

E nderuar ministre,

Të nderuar kolegë deputetë,

Për ditë të tëra kemi shikuar dhe dëgjuar një fushatë të ashpër dhe shumë manipuluese nga ana e “Vetëvendosjes”, duke përdorur viktimizimin e Astrit Deharit, e nëpërmjet kësaj fushate janë munduar të ndërtojnë një kauzë politike.

Gjatë gjithë kësaj kohe shuarjen e jetës së Astritit janë munduar ta shndërrojnë në një pretekst për mobilizim politik, me synim të vetëm përmbysjen e qeverisë e të institucioneve të shtetit, duke mos gjetur mjet as metodë.

Nuk dua të paragjykoj në rastin e Astrit Deharit, edhe pse jam e prirë t’u besoj institucioneve të Kosovës, sepse janë të vazhdojnë hetimet e pavarura, qoftë nga institucionet vendore, qoftë nga ato ndërkombëtare, sepse ka humbur jetën njeriu, është shuar jeta e një djali të ri, e një familje atdhetare dhe shumë të respektuar e të nderuar.

Jam për hetim të pavarur edhe të rasteve të tjera, ku shuhet jetë njerëzish. Jam për hetim edhe të vrasjes së Donjeta Pajazitit, e cila u zhduk në derë të shtëpisë së saj dhe u gjet pas disa ditësh e masakruar.

Donjetën e kam njohur, ishte një vajzë me karakter, të cilën secili do ta kishte dëshirë ta kishte vajzë, motër e gjithçka tjetër. Ajo kishte një ëndërr, t’i dilte krah ekonomikisht familjes dhe pikërisht derisa po jetonte ëndrrën e saj, dikush ia mori jetën padrejtësisht.

Dhe, nuk e di pse drejtësia po hesht, a duhet të politizohen rastet për t’u zgjidhur ato, kjo nuk i takon një shteti ligjor.

Kolegë deputetë,

Drejtësia duhet të jetë drejtësi për gjithsecilin, ne duhet ta bëjmë punën si deputetë, të angazhohemi fuqishëm në institucionet e drejtësisë të ketë zbatim ligji, të ketë rregull dhe t’i fuqizojmë institucionet e drejtësisë edhe me buxhet, nëse themi se duan drejtësi, duam rregull, duam shtet ligjor.

Drejtësia nuk duhet të zbatojë standarde as të organizatave joqeveritare, as të gazetarëve, as të partive politike, qofshin ato pozitive apo opozitive, por të zbatojnë ligjin, të respektojnë rregullat e demokracisë dhe standardet që ne i kemi vënë këtu në këtë Kuvend.

Pra, duhet të shtrohet pyetja pse disa aktivistë të “Vetëvendosjes” po i japin fund jetës së tyre me vetëvrasje? Po besoj se është në interes të shoqërisë të analizojnë arsyet pse po bëjnë vetëvrasje të rinjtë tanë? Prandaj, pajtohem me shefin e Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike të Kosovës që duhet të kërkojmë angazhim të profesionistëve, sociologëve, psikologëve, kriminologëve si dhe të tjerëve që mund të kontribuojnë në qartësimin e rasteve të tilla, por jo assesë për interesat e caktuara politike.

A duhet të analizohet ideologjia dhe inspirimi, por edhe mentaliteti antiinstitucional dhe antidemokratik i “Vetëvendosjes” që po instalohet te të rinjtë.

Po shumë të rinj në këtë subjekt politik ligji i “Vetëvendosjes” është më i rëndësishëm se sa ligjet e shtetit.

Identifikimi me ligjet e “Vetëvendosjes” është detyrë absolute e çdo aktivisti aty.

Nënshtirimi ndaj ligjeve të tyre verifikohet si akt patriotik dhe jo konsiderata apo respektimi i ligjeve tona dhe rendi juridik që e kemi.

Mbi këtë mendësi janë inspiruar aktivistët e tyre për sulme ndaj institucioneve shtetërore, duke manipuluar me logjikën se çdo gur i hedhur kundër institucioneve është akt politik në funksion të mbrojtjes së interesave popullore.

Si rezolutat i kësaj qasjeje këta e kanë sajuar edhe justifikimin ideologjik të dhunës, sepse për ta dhuna ndaj institucioneve shtetërore është rruga e duhur drejt “Vetëvendosjes”.

Nxitja e të rinjve për situata të pakthyeshme për ta dëshmuar lojalitetin ndaj udhëheqësve shpirtërorë të tyre është ngufatje e demokracisë.

Të izoluar totalisht nga çdo interaksion normal social dhe të mbyllur brenda standardeve logjike të grupit të tyre, ata të cilët ende janë të rinj dhe të paformësuar sa duhet po përdorin opsionin, të cilët asnjëri në shoqërinë tonë nuk do t’i dëshironte.

Të nderuar kolegë deputetë,

Ne si shoqëri e kemi për obligim të angazhohemi fuqishëm për të ndryshuar situatën ekonomike e sociale në të cilën ndodhemi, që të reflektojmë te të rinjtë tanë të mos zgjedhin rrugën e viktimizimit për hir të interesave politike.

Shtegdalja nga kjo situatë kur të rinjtë bien në kthetrat e interesave politike është dhe duhet të mbetet detyrim shoqëror dhe qytetar i pjesës më racionale të shoqërisë sonë që beson në vlerat e

liberalizimit, të integritit, të demokracisë dhe të lirisë individuale politike e shoqërore. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka zoti Rexhep Selimi, le të përgatitet Mexhide Mjaku-Topalli.

REXHEP SELIMI: Nuk e kisha të planifikuar ndoshta, por nuk mund të mos e vej në shprehje edhe një herë hipokrizinë e shumë prej deputetëve, sidomos mazhorancës, të cilët i fillojnë fjalimet e tyre me ngushëllime ndaj familjes. Ju e keni rastin ta ngushëlloni familjen, keni pasur rastin ta ngushëlloni familjen edhe në kohën kur ka qenë dera e hapur e familjes së tyre, kanë qenë dhjetëra-mijëra qytetarë të Kosovës atje, po keni rastin edhe tash e tutje ta ngushëlloni familjen nëse punoni për të sjellë drejtësi dhe të vërtetën për vrasjen apo vdekjen e Astrit Deharit në paraburgim.

Prandaj, kjo lloj hipokrizie me të vërtetë nganjëherë është dhe neveritëse.

Nuk mund të mos e nxjerrim edhe një herë në pah një lloj kronologjie lidhur me këtë ngjarje që ka pasuar dhe duket që nuk ka përfunduar veç me vdekjen e Astrit Deharit.

Dhe, në mes të kësaj jemi mes dy lloj klaneve. Në njërin anë kemi klanin “Pronto”, në anën tjetër kemi klanin e Zenunit dhe nganjëherë, të ngelur në mes të këtyre dy klaneve, po duket sikur është futur në target edhe Lëvizja “Vetëvendosje”, edhe familja Dehari dhe të gjitha ata që duan drejtësi dhe të vërtetën për rastin “Dehari”.

Tash, nga thirrësit e kësaj seance, të cilët u frikësuan ta zhvillojnë këtë debat më herët, dhe ne nuk e kemi thjesht problemin se kur duhej bëhet debati me herët apo më vonë, por çka duhet të rrjedhë e të pasojë nga ky debat, e sidomos nga përfaqësuesit e PDK-së dëgjohej në fillim me melankolinë e tyre të zakonshme në raste të tilla, kur thonë nuk është mirë të debatohet për raste të tilla. Me që nuk qenka mirë, sipas jush, atëherë pse e keni thirrur këtë seancë: si rezultat i presionit medial, unë nuk e besoj një gjë të tillë.

Pastaj, po ashtu thatë ju ftoj që të jemi korrektë, po ju a jeni korrektë fillimisht që të kërkonit nga të tjerët. Jo, nuk jeni as nuk keni qenë dhe duket që nuk e keni ndërmend të jeni korrektë ndaj asaj teme për të cilën ne flasim sot.

Normalisht që një gjë nuk mund ta bëjmë siç kërkon Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike që të bisedojmë pa dallim. Jo, nuk mund të bisedojmë pa dallim, sepse ne dallojmë shumë dhe pikërisht kjo është e mirë që ne dallojmë shumë.

Por, një çudi më vjen edhe nga Grupi Parlamentar i LDK-së, e cila në këtë rast kthehet në avokat besnik të klanit “Pronto” në këtë temë. Ata po na thërrasin edhe të mos e politizojmë këtë, i referohem fjalës së shefit të Grupit Parlamentar të LDK-së. Po thotë të mos e politizojmë, e ndërkohë përmend edhe tentim atentatin ndaj ish-presidentit Rugova. Po ai, a qenka politike, edhe ajo, edhe kjo, të dyja janë politike.

Pra, nëse janë politike, janë të dyja politike, e nëse doni të mos e politizojmë, atëherë bëjeni edhe ju të njëjtën gjë, e ne nuk ju ftojme ta bëni të njëjtën gjë.

Prej asaj çfarë dëgjuam sot, u përmend edhe vetëfliji, u përmend viktimizimi, u përmend politizimi, u përmendën shtypësit dhe kur e shoh krejt këtë fjalor, t’u them një gjë. Kosova pas luftës ka pasur Qeveri dhe pushtete herë më të dobëta, herë më të mira, herë më të këqija, veç pushtet më të poshtër Kosova kurrë nuk ka pasur prej pasluftës e deri sot. Ja, deri këtu shkon poshtërsia juaj sa që akuzoni të vdekurin, e sillni në bankën e të akuzuarit të vdekurit kur thoni se ai paska kryer akt terrorist apo duhet të vijë drejtësia edhe për atë çfarë akuzohet. Ja deri këtu ka degjeneruar mazhoranca parlamentare dhe qeveritare e Republikës së Kosovës!

U bënë 45 ditë nga vdekja e Astrit Deharit dhe normalisht që do të duhej ta nxjerrim edhe një herë një kronologji çka ndodhi prej asaj kohe.

Nuk mund ta fillojmë këtë temë nga dita e vdekjes së Astrit Deharit. Për të qenë nga ajo kohë, të mos i harrojmë edhe një herë kërcënimet që janë bërë këtu, në këtë parlament, edhe kërcënimet që janë bërë nga zyrat e Qeverisë së Kosovës, duke na kërcënuar me të ashtuquajturat vetëvrasje, duke thënë që ne nuk e presim protestuesit me kafe, nuk mund të mos e përmendim edhe një herë që vdekja e Astrit Deharit ka ardhur edhe pas akuzave dhe proceseve të montuara politike, siç janë ato kundër gjashtë aktivistëve, ku pesë prej tyre e kanë mbijetuar këtë proces deri tani.

Nuk mund të mos e përmendim edhe një herë që nëse qenkan terroristë e të akuzuar për terroristë, pse ata janë në shtëpi sot? A kështu silleni ju? Pra, vdekja e Astrit Deharit erdhi në një moment kur kulmi i poshtërsisë arriti deri atje sa që edhe vdekjen e Astrit Deharit u munduat ta fshihni. Po të mos harrojmë një gjë, sado që mundoheni të bëni eskivazhe, nuk mund t’i shmangeni përgjegjësisë, e morët të gjallë, e kthyet të vdekur dhe për këtë ju jeni përgjegjës, si pushtet, të cilët edhe këtu në këtë foltore, në momente kur ka ndodhur sulmi i ashtuquajtur terrorist, ju keni tentuar ta kontrabandoni një lloj rezolute. Normalisht që nuk mundët, por nuk u kënaqët me kaq dhe vazhduat që atë çfarë deshët ta bëni në Parlamentin e Kosovës, e bëtë në një proces të montuar politik. Por, pas asaj kohe, edhe sikur ne të donim të mos dyshonim në ju, edhe sikur ne të donim që, okej, t’i prisnim rezultatet e institucioneve, të cilat tashmë nuk kanë kredibilitet, ju vetë na bëtë që të dyshojmë, sepse ju deklaruat fillimisht që ai ka vdekur nga një overdozë e medikamenteve. Këtë e tha edhe vetë kryeprokurori Sylë Hoxha, pak momente pas vdekjes së Astrit Deharit.

Pastaj, raportet e infermieres në vendin e ngjarjes që ai ka qenë me frymëmarrje dhe puls normal.

Pastaj, a nuk kemi folur ne sa e sa herë për vjedhjet e dëshmive. A ju kujtohet, dhe shumë prej kolegëve shpeshherë kemi thënë që vjedhja e Dhomës së Dëshmive ka ndodhur së paku në dy raste, ku janë vjedhur drogë, janë vjedhur miliona, janë vjedhur dosje. Me rastin e daljes nga Dhoma e Dëshmive të videove dhe të ditarit të Astrit Deharit po rezulton që edhe ato të parat nuk paskan qenë vjedhje, por paskan qenë rrjedhje. Ju që i dhatë videon një televizioni dhe ditarin një portali tregoni se kujt ia dhatë drogën? Pra, edhe një herë dua të them ato nuk paskan qenë vjedhje, por paskan qenë rrjedhje, siç ka qenë rrjedhja edhe e videos dhe e ditarit të Astrit Deharit.

Ikja nga debati deri tani nuk ju bënë më të pafajshëm, të nderuar pushtetarë, ikja nga debati nuk shmang ballafaqimin, kjo që po bëjmë sot nuk është ballafaqimi ynë i fundit me këtë pushtet.

Prandaj, nga ky pozicion ju bëjmë përgjegjës për arrestimin dhe procesin e montuar politik ndaj gjashtë aktivistëve, pesë prej të cilëve kanë mbijetuar këtë proces. Ju bëjmë përgjegjës për mbajtjen e paligjshme në burg deri tani të aktivistëve të Lëvizjes “Vetëvendosje”, ju bëjmë përgjegjës për vdekjen e Astrit Deharit në burgun e Prizrenit, ju bëjmë përgjegjës për tentim fshehjen e provave dhe dëshmive gjatë procesit të ekzaminimit dhe mbi këtë përgjegjësi do të duhej, së paku, ju të reflektoni me dorëheqje.

Ne kemi çka të themi edhe në aspektin profesional, por me ato prova do të ballafaqohemi kur ju të jeni në gjyq.

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e kanë kërkuar kryetarët e grupeve parlamentare, zoti Pajaziti dhe zoti Beqiri.

ZENUN PAJAZITI: Faleminderit, zoti nënkryetar i Kuvendit!

Në fillim të këtij debati unë dhe shumë kolegë të tjerë deputetë kërkuam që të jemi sa më korrektë në trajtimin e këtij rasti.

Unë i kuptoj shqetësimet e disa deputetëve, edhe të Lëvizjes “Vetëvendosje”, shqetësime që nuk kanë të bëjnë më shumë se sa me rastin, me zbardhjen e rastit të Deharit, kanë për qëllim të involvohen e të kërkojnë, siç e thanë tekstualisht, ndërprerjen e hetimeve për ata që janë brenda dhe po hetohet nga institucionet e drejtësisë.

Po edhe një herë po ju them që askush, bash askush, çfarëdo lloj debati, çfarëdo lloj anashkalimi të temës, çfarëdo lloj tentimi për të përfutur prej këtij debati, askush nuk mund dhe nuk duhet t’i ikë përgjegjësisë. Edhe një herë i ftoj institucionet e drejtësisë që në mënyrë të pavarur të hetojnë

çdo rast, të hetojnë çdo moment, gjithçka që lidhet me të gjithë njerëzit që janë përfshirë në atë rast dhe po ashtu në mënyrë të veçantë të hetojnë rastin e vdekjes në burg të Astrit Deharit.

Dhe, për sqarim, edhe një herë, se u abuzua shumë me nënshkrimet. Ka qenë dhe mbetet, ka qenë kërkesë që të mos ngutemi të paktën pa dalë rezultati i autopsisë, të cilin rezultat qëllimshëm ju nuk po doni ta komentoni, po e komentoni gjithmonë një paraqitje të ngutshme të një polici ose një paraqitje tjetër të papërfunduar joprofesionalisht të një prokurori.

Kemi mjaft materiale të pjekura, të cilat janë komentua edhe nga institucione ndërkombëtare dhe bile janë falënderuar për profesionalizmin e treguar në rastin e trajtimit në mënyrë shkencore, mjekësore të rastit të vdekjes së zotit Dehari.

Prandaj, kërkoj edhe një herë që t'i kthehemi me maturi debatit për çka jemi sot këtu, t'u kthehemi me maturi kërkesave që i kemi legjitime, edhe të qytetarëve, për t'u zbardhur gjithë ky rast, por të ndalojmë ta përfitojmë ose të tentojmë të përfitojmë për momentin politik që nuk përfiton askush me rastin Dehari dhe me dhimbjen e familjes, të cilët ende janë në pritje të rezultateve përfundimtare të këtij rasti.

Pra, edhe një herë ju bëj ftesë që të jemi sa më korrektë në trajtimin deri në fund të këtij rasti. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Kundër-replikë, zoti Selimi.

REXHEP SELIMI: Zakonisht replikat thirren për të thënë diçka, unë nuk kuptova pse e more replikën, sepse asgjë kundrejt asaj çfarë thashë unë t'i nuk reflektove, t'i veç e shfrytëzove rastin të thuash diçka gjoja për replikë.

Prandaj, edhe një herë po ta jap rastin, pse e kërkove replikën, na thuaj se nuk mora vesh asgjë.

KRYESUESI: Faleminderit! Hajde, pasi ta dha vetë Rexha, vazhdo!

ZENUN PAJAZITI: Rexhë, e di mirë ku e ke fjalën, e di mirë edhe ti. Mos e keqpërdor tendencën tonë të jemi korrektë edhe ndaj këtij rasti, edhe ndaj familjes. As ti, as unë, as Lëvizja "Vetëvendosje", as ky Kuvend nuk duhet ta pengojë drejtësinë për t'u marrë me krejt hetimin e këtij rasti e krejt atyre njerëzve që janë brenda, edhe pikë, kjo është kërkesa e parë.

Edhe e dytë, po ta sqaroj për nënshkrimet që u përmend disa herë, thjesht gatishmëria jonë ka qenë dhe mbetet për të debatuar për të gjitha rastet. Kemi pritur të dalë një ekspertizë, të cilën ju po e injoroni, nuk po merreni me të, por po merreni me raste të tjera që s'kanë të bëjnë fare me këtë rast.

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Beqiri e ka kërkuar fjalën, për replikë.

ISMET BEQIRI: Faleminderit, nënkryetar!

Ndoshta edhe më herët kam pasur arsye të reagoj, por me të vërtetë duke e ditur temën dhe për çka e kemi thirrur rastin, jam munduar të përmbahem, por po i them zotit Selimi, asnjëherë në jetën e tij, as ai, ose po e pyes ai dhe subjekti tash që i takon, kur një ditë kërkuan të zbardhet qoftë një rast ndaj veprimtarëve të LDK-së, edhe të presidentit Rugova, kurrë asnjëherë nuk e kanë bërë, e para.

Dhe, e dyta, dallimi mes nesh është shumë i qartë. Ne mund t'i kemi dyshime tona, ne kërkojmë të zbulohet rasti i fundit i zotit Dehari, por kërkojmë nga organet kompetente, nëse edhe kjo nuk mjafton, e kam thënë fjalën time, pse jo super ekspertizë, pse jo hetim ndërkombëtar, kujt po i pengon zbulimi i së vërtetës, kujt po i pengon?

Prandaj, thuama vetëm një rast, se je në jetën politike, zoti Selimi, se për këtë subjektin tënd nuk po flas hiq, qoftë nëse nuk pajtohesh politikisht me udhëheqësin shtetëror që e kemi pasur, si udhëheqës shtetëror ke mundur të thuash ndonjëherë në jetën tënde një fjalë, se është tentuar të vritet presidenti Rugova, kryetarë komunash, e po flisni për politizim. Kur i kemi bërë aq problematike ne, jo nevojën që të zbulohen, po jo këtu në seancë, sepse ne s'mund ta zbulojmë këtë dhe as grupi e as Komisioni hetimor që po thirrni në SHIK. Këtu kanë punë organet e hetuesisë, ato le ta zbardhin rastin të çdonjërit, por ju këtë nuk e ndjeni në shpirt, ju veç i bëni në momente të caktuara, sepse edhe Ibrahim Rugova ka familje, edhe shumë të vdekur, të vrarë të LDK-së kanë familje, u është lënduar zemra, për këto ju kurrë...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESI: Faleminderit! Kundërreplikë, zoti Selimi.

REXHEP SELIMI: Zoti Beqiri, e kam thënë edhe në këtë foltore, nuk ta thashë tash, e kam thënë edhe në këtë parlament, por po ta them edhe një herë, edhe si grup parlamentar. Qite atë copë nënshkrim aty ku duhet dhe pastaj ke të drejtë të flasësh që së paku ti ke kontribuar diçka për zbardhjen e atyre, për të cilët je ankuar tash e në gjithë jetën tënde politike. Pra, qite nënshkrimin për themelimin e Komisionit hetimor, por ti nuk e qet, sepse sot je në Qeveri me ata që i ke akuzuar për ato vrasje, prandaj t'i nuk e qet. Ti ndoshta do ta qesësh nesër kur s'je në Qeveri me ta, por për aq sa je në Qeveri, t'i nuk po e qet, madje t'i nuk e ke qitur atë nënshkrim as kur ke qenë gjoja kundërshtar i tyre në mandatin e kaluar. Qe dy mandate ta kërkojmë nënshkrimin, qite atë copë nënshkrimi dhe u krye, kaq.

KRYESUESI: Faleminderit! Hajde, po e shkelim edhe me ty, një minutë Ismetit.

ISMET BEQIRI: Zoti Selimi, në qoftë se ka mbetur puna me atë copë nënshkrimi të zbulohen këto raste që 17 vjet, kjo është një demagogji edhe hipokrizi juaja, sepse edhe po ta bëjmë komisionin, nuk është Komisioni hetimor që i zbulon ata banditë edhe ata vrasës, kushdo qofshin ata, i cilido subjekt politik, po ta them ty, sepse ju mos harroni një gjë, keni qenë në këto subjekte politike, zoti Selimi dhe po ta them me përgjegjësinë e plotë, është mirë ta shohë secili veten, por organet kompetente e bëjnë, jo Komisioni hetimor, gabim e ke. Unë nuk merrem me hetime, unë nuk jam hetues, nëse do ta bësh ti atë punë, bëje.

KRYESUESI: Faleminderit! Jo, të lutem Rexhë, mjafton, keni dalë jashtë temës edhe ia kam dhënë fjalën shumë më herët zonjës Mjaku-Topalli, fjalën e ka zonja Mjaku-Topalli.

MEXHIDE MUJAKU-TOPALLI: I nderuar nënkryetar,

E nderuar ministre,

Të nderuar kolegë deputetë,

Vdekja e Astrit Deharit është e dhimbshme. Për faktin se një djalë i ri, një student shembullor nuk jeton më, për faktin se kjo është një humbje e madhe për familjen e tij të çmuar. Për faktin se vdekja e tij u përdor dhe po përdoret politikisht, duke tejkaluar çdo limit njerëzor dhe duke na rrëfyer kështu degradimin.

E dimë se gjatë këtyre ditëve opinioni qytetar ka qenë i traumatizuar me deklarata e konstatime për vdekjen e ndodhur në burgun e Prizrenit, duke prejudikuar dhe kualifikuar këtë vdekje si vrasje, prejudikim me motive të qarta politike.

Në natyrën opozitare është që të gjitha problemet apo keqmenaxhimet e pozitës t'i ngrejë në nivel shqetësues dhe ato t'i prezantojë para qytetarëve si dështime, por të bësh kauzë politike mbi një tragjedi të rëndë, të një familjeje, kjo më së paku i bën nder opozitës dhe më së paku mund të quhet e moralshme.

Në një shoqëri të organizuar dhe të qytetëruar, kjo ngjarje do të duhet të trajtohej dhe të hetohej nga organet e hetuesisë dhe të drejtësisë, pa asnjë lloj presioni opozitar apo presioni të shoqërisë civile.

Në këtë rast opozita kërkon drejtësi për Astritin, edhe ne të njëjtin gjë e kërkojmë, po ashtu edhe qytetarët e Kosovës. Por ne kërkojmë drejtësi siç parasheh ligji, procedurat dhe rendi juridik i shteteve të civilizuara.

Tragjedia e një të riu me të shpejtë u cilësua me fjalët më të paduhura, u cilësua vrasje, duke mos pasur asnjë informacion paraprak, pastaj u cilësua vrasje makabre, vrasje shtetërore, vrasje e dhunshme dhe këto të gjitha u bënë jo rastësisht.

Qëllimi ishte mobilizimi i militantëve politikë për të nxitur trazira dhe natyrisht si herëve të tjera, sulm me gjithçka në institucionet legale të dala nga vota e qytetarëve. Ky nuk është standard i drejtësisë, ky nuk është koncept i demokracisë, të sulmohen institucionet e shtetit jashtë, e kur nuk mundën jashtë, atëherë të bëhen edhe brenda.

Drejtësia për Astritin duhet të vijë pas një hetimi gjithëpërfshirës dhe duhet të kalojë nëpër disa etapa.

E para, Policia dhe organet e hetuesisë duhet të hetojnë gjenezën e këtij problemi, i cili fillon me sulmin me mjete shpërthyes në institucionet e shtetit dhe hedhjen e bombave në shtëpitë private të udhëheqësve të institucioneve. Sot e dimë që janë hapur hetime për disa qytetarë, kryesisht të rinj. Sado që Policia të jetë efikase në kapjen e njerëzve të dyshimtë për sulme të tilla, ky vend nuk do ta gjejë qetësinë përderisa nuk identifikohen urdhërdhënësit e këtyre sulmeve, përderisa nuk identifikohet truri i tyre.

Në institucionet korrektuese u përmend edhe më herët se ka pasur edhe dhjetëra vetëvrasje. Pse nuk është ngrit asnjëherë zëri juaj? Pse nuk lejohen që institucionet legale të drejtësisë të japin mendimin profesional, së pari Instituti i Mjekësisë Ligjore dhe pastaj hetuesia dhe nëpërmjet këtyre raporteve të arrihet e vërteta. Në të gjitha sistemet e drejtësisë raporte valide dhe zyrtare konsiderohen raportet nga institucionet legale të shtetit. Në rastin konkret kemi pasur një raport legal të Institutit të Mjekësisë Ligjore dhënë Prokurorisë së shtetit, i cili apriori kontestohet, kurse merren si valide mendimet e disa ekspertëve privatë.

Nga incizimet u pa se dera ku qëndronte i ndjeri Astriti për asnjë moment nuk ishte hapur. Nga kjo gjasat që ai të ketë bërë vetëvrasje janë më reale. Nëse ai bëri vetëvrasje kush e detyroi Astritin të marr një hap të tillë. A i duhet hetuesisë kohë për ta vërtetuar këtë? Pse atëherë opozita nxiton me prejudikime për këtë rast? Krejt në fund dua të them se siguria i një vendi mund të rrezikohet në forma të ndryshme, por rreziku më i sofistikuar është atëherë kur tentohet të instrumentalizohen masat popullore në emër të patriotizmit, në emër të një kauze të paqenë dhe këto masa të nxirren në rrugë për mbrojtjen e atyre pseudo kauzave.

Këto kauza në emër të patriotizmit shpesh e kanë dëmtuar në fundament përpjekjen tonë për liri dhe pavarësi, duke na lënë ose të dobët në organizim ose të vonuar në procese. Shpesh këto manipulime me kauza të paqena janë bërë pa vetëdijen tonë në korolacion me ambiciet e armiqve tanë shekullor dhe ne u kemi bërë shërbim atyre. Pra, e kemi dëmtuar vetë qenien tonë. Mbase organet e sigurisë së Republikës së Kosovës, Këshilli Kombëtar i Sigurisë do të duhej që të gjitha këto zhvillime brenda nesh t'i analizojë në këndin kritik dhe bashkë me aleatët tanë tradicionalë të nxjerrin konkluzionet e sakta se çka po ndodh këtu, çka po ndodh mes nesh. Këto zhvillime që e kanë ndalur ecjen e shtetit tonë a e kanë adresën këtu tek ne dhe a burojnë nga egoja për pushtet apo nga të panjohurat tona. Mos ndoshta e kanë adresën tek armiku ynë i

deri djeshëm apo burojnë nga një super fuqi e lindjes që me agresionin e saj të pandalshëm po tentojë të shtrijë ndikimin e saj në Ballkan, në përgjithësi e natyrisht edhe në vendin tonë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Ismajl Kurteshi e ka fjalën.

ISMAJL KURTESHI: Faleminderit!

Deputetë të nderuar,

Padrejtësia shpesh lidhet me ndonjë veprim të caktuar, por ndonjëherë ajo ndodh pikërisht duke mos vepruar.

Për rastin e Astrit Deharit shteti gjithsesi është përgjegjës për shkak të mosveprimit ose për shkak të veprimit kundërligjor. Sipas fjalorit të gjuhës së sotme shqipe, fjala “drejtësi” do të thotë “vërtetësi”, veprimtaria e organeve gjyqësore të mbështetura në ligjshmëri. Pas vdekjes tragjike të Astrit Deharit, më 5 nëntor të vitit 2016 në Burgun e Prizrenit, në rrethana ende të pasqaruara me të drejtë familja Dehari dhe qytetarët e Kosovës po kërkojnë zbardhjen e këtij rasti dhe pastaj masa ligjore ndaj përgjegjësve, pra po kërkojnë drejtësi.

Pushtetarët të trembur nga drejtësia, gjegjësisht e vërteta kërkesën për drejtësi po e cilësojnë si kërkesë politike me qëllim të shmangies së familjes Dehari dhe qytetarëve të Kosovës, por edhe shumë personaliteteve e institucioneve ndërkombëtare nga kjo kërkesë e zakonshme njerëzore. Kjo kërkesë që sidomos pas deklaratave kundërthënëse të pushtetarëve, si Astriti vdiq nga mbi dozimi me barëra, pastaj Astriti nuk ka përdorur barna, Astriti vdiq në spital, pastaj Astriti vdiq në qeli, Astriti u gjet me frymëmarrje të rregullt dhe deklarata të tjera që më vonë u demantuan nga vetë shteti si të pavërteta.

Këto deklarata kundërthënëse kanë bërë që familja dhe qytetarët ta humbin besimin në organet shtetërore. Në raste të tilla është krejt normale të kërkohet që të mësohet e vërteta, kur kësaj i shtohet edhe deklarata e prokurorit se të gjitha provat janë në duart e organeve shtetërore e të nesërmen ato prezantohen nga një televizion privat vetëm sa e rritin mosbesimin.

Pas të gjitha këtyre deklaratave të pavërteta kush mund t’i besojë konstatimit të paargumentuar të Prokurorisë se Astriti është vetëvrarë. Nivelin e mosbesimit e rritën edhe pengesat e dy partive në koalicionin qeverisës në këtë Kuvend për mbajtjen e një seance të jashtëzakonshme për këtë rast. Në këtë situatë kërkesa për hetime të pavarura është normale, madje është e domosdoshme. Pushteti që gjithsesi është përgjegjës për vdekjen në burg, të cilido të burgosur që nuk vdes nga vdekja e natyrshme ka vetëm një mundësi për ta hequr dyshimin se vdekja e Astritit që ka qenë e dhunshme nuk ka qenë edhe e organizuar.

Vetëm aprovimi me kohë i kërkesës së familjes së Astrit Deharit dhe qytetarëve anembanë vendit për hetim të pavarur do t'i hiqte këto dyshime, në të kundërtën shteti përveçse e merr barrën e përgjegjësisë që nuk është kujdesur për jetën e Astritit ai ngarkohet edhe me barrën se po e fsheh organizatorin e vdekjes së Astritit nëse organizatori nuk është vetë shteti. Pasiguria brenda institucioneve të shtetit është shqetësim i arsyeshëm i qytetarëve të Kosovës, këtë shqetësim askush nuk guxon ta thjeshtësojë duke cilësuar si kërkesë politike të atij ose këtij subjekti, por është e domosdoshme të analizohet gjendja në institucionet në fjalë dhe të propozohen, por edhe të ndërmerren masa për rritjen e sigurisë që do të ndikojë në kthimin e besimit të qytetarëve në shtetin e tyre.

Kuvendi i Kosovës nëpërmjet një trupi të pavarur duhet të identifikojë defektet në sistemin e organeve përgjegjëse për jetën e të arrestuarve dhe qytetarëve në përgjithësi dhe pastaj të propozojë masa që e ngrehin në nivelin e duhur sigurinë e të gjithë qytetarëve të privuar nga liria dhe jo vetëm të tyre. Kuvendi i Kosovës do të vihej në shërbim të qytetarëve vetëm atëherë kur të arrijë të udhëhiqet nga logjika e forcës së argumentit, e jo kështu siç po vepron aktualisht kur po udhëhiqet nga argumenti i forcës.

Ky Kuvend është i obliguar që sot të mos injorojë kërkesat e 26 mijë qytetarëve që kanë nënshkruar peticionin, por t'i shqyrtojë ato kërkesa dhe të deklarohet përmes votimit për kërkesat e qytetarëve të saj. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka Nait Hasani, s'është këtu. Emilija Rexhepi e ka fjalën

EMILIJA REDŽEPI: Zahvaljujem predsedavajući!

Poštovani kolege poslanici, poštovani građani. S obzirom da sam ja jedan od poslanika koje je dao svoj potpis mojim kolegama iz "Vetëvendosja" za vanrednu sednicu koja trebala biti posvećeno slučaju Astrita Deharija i nisam povukla svoj potpis, niti je neko od strane rukovodstva PDK ili parlamentarne grupe to zahtevao ili tražio od mene kao što su mnogo govorili iznosili u javnosti, niti ja to dozvoljavam.

Poštovani kolege poslanici to i to sam radila iz ljudskog i moralnog aspekta smatrajući da je jedan mlad život nestao ugušenje. Kao i da parlament mesto kome treba govoriti, trebamo svi tačno znati kako se to dogodilo, zašto i zbog čega, da li neko stoji iza toga ili ne, koji su motivi jednog izgubljenog mladog života.

Kao poslanik iz redova Bošnjačke zajednice porodici Dehari a pre svega roditeljima pokojnog Astrita želim izraziti moje duboko saučešće za smrt svoga sina uz nadu da se ovaj slučaj rasvetliti i da će organi pravde odraditi svoj posao u skladu sa Ustavom Republike Kosova, vladavinom prava poštujući sve zakonske regulative bez bilo kakve vrste pritisaka koje dolaze sa

bilu koje strane a ne da zbunjuju sve nas i nas kolege poslanike ovde u parlamentu i medije, javnost i sve građane Kosova sa raznim različitim svakodnevnim izjavama zar ne treba i zbog toga da se snosi odgovornost pozivam Ministarku pravde i Ministra unutrašnje poslova da bolje kontrolišu naš pravosudni sistem. Zahvaljujem!

KRYESUESI: Zonja Dërguti e ka fjalën.

AIDA DËRGUTI: Faleminderit, kryesues!

Zonja dhe zotërinj,

Qytetarë të Kosovës,

Po i kthehem edhe njëherë kronologjisë se si ka ardhur deri te thirrja e kësaj seance, e cila është kërkuar menjëherë pas vdekjes së Astritit.

Pasi që u mbush një javë nga vdekja e aktivistit Astrit Dehari, në Qendrën e Paraburgimit në Prizren dhe institucionet të rendit dhe drejtësisë nuk dhanë kurrfarë sqarimi për vdekjen përveçse deklaratave kontradiktore të pamatura, Lëvizja “Vetëvendosje” mbledhi mbi 40 nënshkrime për thirrjen e një seance të jashtëzakonshme parlamentare.

Kërkesa në emër të Lëvizjes “Vetëvendosje” dhe e mbështetur nga AAK-ja dhe “Nisma”, si dhe disa deputetë të mazhorancës u finalizua e u dorëzua nga Visar Ymeri, më 15 nëntor në Kryesinë e Kuvendit. Kërkesa ishte për seancë të jashtëzakonshme në lidhje me zhvillimet në rastin e vdekjes së aktivistit Astrit Dehari, i paraburgosur në Qendrën e Paraburgimit në Prizren nëpërmjet së cilës synohej edhe nxjerrja e një rezolute që kërkonte hetim të pavarur për rastin, marrë parasysh keq administrimin që i është bërë rastit nga organet përgjegjëse.

Më 15 nëntor 2016, Kryesia e Kuvendit e filloi mbledhjen e vetë duke filluar edhe shqyrtimin e kërkesës për seancë të jashtëzakonshme. Por, në fillim të kësaj mbledhjeje menjëherë pasi procedohet në kërkesën vjen njoftimi nga Administrata për tërheqje të nënshkrimit nga deputeti i PDK-së, Bislim Zogaj. Dhe në këtë mënyrë Kryesia nuk e shqyrtoi fare kërkesën.

Pasi që deputeti Zogaj e tërhoqi nënshkrimin nga presioni, Grupi Parlamentar i Lëvizjes “Vetëvendosje” siguroi sërish nënshkrimin e 40 të deputetëve. Dhe po atë ditë, pra më 15 nëntor përmes një kërkeje për thirrjen e mbledhjes së kryesisë e cila është e drejtë, e ndarë për grupet parlamentare ose më së paku të gjashtë deputetëve duke e shfrytëzuar një të drejtë të garantuar me Rregulloren e Kuvendit, Grupi Parlamentar i yni kërkoi thirrjen e mbledhjes së kryesisë, por kryetari i Kuvendit nuk e përfilli dhe më vjen keq që tash nuk ndodhet këtu.

Arsyetimi nga Kabineti i tij ishte se shefi nuk mban telefon dhe nuk po mund ta kontaktojmë, por u kuptua më vonë se arsyeja ishte diku tjetër, bëhej fjalë për një presion të ri që të pamundësohej numri i 40 i nënshkrimeve. Pra, Kryesia e Kuvendit neglizhoi mbajtjen e mbledhjes së radhës së

Kryesisë së Kuvendit të kërkuar nga ne, duke mundësuar që të ushtrohet trysni edhe ndaj deputetëve të tjerë për tërheqje nënshkrimi.

Më 16 nëntor 2016, pasi mbledhja nuk po thirrej bëhej presion në deputetët që të tërhiqeshin nga nënshkrimet, kështu deputeti Danush Ademi nga Grupi “6+” dhe deputeti Veton Berisha nga LDK i tërhoqën po ashtu nënshkrimet e tyre dhe më datën 17 nëntor 2016, në mbledhjen e cila u thirr nga kryetari i Kuvendit, Kryesia konstatoi se nuk plotësohen kushtet për ta mbajtur seancën. Në këtë mënyrë ne e bojkotuam këtë mbledhje të Kryesisë për shkak të dijenisë se nënshkrimet u tërhoqën nga presioni i këtij koalicioni.

Arsyetimet e deputetëve që tërhoqën nënshkrimin në të tri rastet ishin përafërsisht të ngjashme duke dhënë se e shohin të udhës të pritët raport nga organet e hetuesisë dhe të merret vesh më shumë për rastin, por ky ishte vetëm arsyetimi formal publik pasi që në bisedat private me deputetët e opozitës ata kanë pranuar trysninë që është ushtruar ndaj tyre nga partitë e koalicionit qeverisës, PDK e LDK.

Në seancën e 17 nëntorit, ne shfrytëzuam të drejtën e futjes në rend të ditës të një çështje urgjente në përputhje me nenin 49 të Rregullores së Kuvendit që kërkesa për seancë të jashtëzakonshme të shqyrtohet si çështje urgjente për çfarë e pati mbështetjen nga dy partitë opozitare AAK e “Nisma”, por jo edhe nga LDK e PDK. E në votimin që u mbajt në mungesë kuorumi votuan 45 deputetë prej të cilëve 25 votuan për, 16 ishin kundër dhe 4 nga ta abstenuan. Pas të gjitha këtyre përcjelljeve me shkelje të shumta procedurale, Lëvizja “Vetëvendosje” e lëshoi seancën e rregullt.

Lëvizja “Vetëvendosje” e ka vazhduar përpjekjen e vet që të mbledhë edhe një nënshkrim të vetëm për t’u plotësuar kushti procedural për t’u dorëzuar kërkesa për seancë të jashtëzakonshme, por ka qenë e pamundur sepse sipas shumë deputetëve presioni nga koalicioni qeveritar është i tmerrshëm dhe nuk guxojnë ta bëjnë një gjë të tillë. Në mbledhjen e Kryesisë së mbajtur, më 6 dhjetor 2016, pra ka qenë mbledhje e mbyllur për media me nënkryetarët unë kam kërkuar që seanca të mbahet për një kohë tjetër, pra më datën 13 dhjetor dhe jo më 14 dhjetor siç kishte thënë kryetari i Kuvendit publikisht në seancën e mbajtur, kam kërkuar që të lëviz një ditë më herët dhe jo të shtyhet me një arsyetim të vetëm që një numër i deputetëve të opozitës i kanë pasur të caktuar seancat gjyqësore po më datën 14 për rastin e hedhjes së gazit në Kuvend.

Ndërsa, dje më 19 dhjetor pra 44 ditë pas vdekjes së Astritit me të filluar mbledhja e Kryesisë së Kuvendit, kryetari i Kuvendit procedoi me një kërkesë për seancë të jashtëzakonshme në formë jo të shkruar, të pa protokolluar, pa nënshkrime, duke vendosur datën dhe orën e mbajtjes së seancës. Pra, u vendos për mbajtjen e kësaj seance të jashtëzakonshme, për rastin e Astrit Deharit duke e shkelur Rregulloren e Kuvendit. E në këtë situatë këta njerëz nuk dinë formë tjetër

veprimi përpos të paligjshmes, arbitrare, shantazhit, taktizimit dhe në një mënyrë apo tjetër kultivimit të poshtërsisë.

Ju nuk do të dukeni mirë as para publikut, por as para mbështetësve të juaj. Vdekja e Astritit është një pikë kthese për Kosovën, është një pikë kthese për të gjithë ne. Pengesa juaj për të mbajtur seancën me kërkesën tonë e inicioi një petition që për pak ditë mbledhi mijëra nënshkrime. Ju e shpërfillët kërkesën e tyre për seancë dhe kërkesat e tyre... Prandaj, e thirrët këtë seancë të jashtëzakonshme pikërisht për ta shpërfillur petitionin e qytetarëve me kërkesa shumë të qarta lidhur me rastin Dehari.

Duke e shkelur kështu Kushtetutën e Kosovës dhe duke ia mohuar qytetarëve të drejtën e fituar me shumë mund të pjesëmarrjes direkt në vendimmarrje. Ju nuk mund të përdorni këto mjete pushteti për shumë gjatë, por koha e juaj do të mbarojë shumë shpejt.

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Ymeri e ka fjalën. Nait Hasani e ka pasur fjalën më herët, qenka kthyer. Merre fjalën, Nait.

NAIT HASANI: Faleminderit!

Përshëndetje për kolegët deputetë,

Përshëndetje për ministren e Drejtësisë,

I nderuar kryetar i Kuvendit,

Parimisht gjërat në këto seanca janë mjaftë të ndjeshme, mjaft të dhimbshme dhe të flasësh për raste të tilla është bukur vështirë. Por, unë sot do të anashkaloj këtë temë do të flas për një mekanizëm tjetër që e kemi në Kosovë, një mekanizëm që ne e kemi quajtur dhe e quajmë EULEX, që ai është komplet në institucionet tona, të cilët kanë një përgjegjësi dhe mban një përgjegjësi për zhvillimet në vend.

Kam kërkesë nga punëtorët shqiptarë që kanë punuar dhe punojnë në institucionet e EULEX-it dhe ata kanë kërkuar që t'u adresohem juve, t'i drejtohem kryeministrit të vendit, presidentit, kryetarit të Kuvendit, ministres së Drejtësisë, ministrit të Punëve të Brendshme për sjelljet e EULEX-it ndaj punëtorëve shqiptarë brenda EULEX-it.

Ata thonë që stafi vendor po ankohet dhe është ankuar tek OMBUS Personi dhe në Bashkimin Evropian, edhe në Gjykatën për Punësim në Kosovë për shkak që trajtohen jo drejtë, jo mirë në favor që i favorizon komunitetet tjera dhe komunitetin serbë. Kjo tregon që Qeveria jonë duhet të rishikojë proceset të selektimit dhe verifikim të procedurave të ndërmarra ndaj EULEX-it, për ndërprerjen e kontakteve ku stafi vendor ka qenë denoncues i brendshëm pikërisht për shkak të rrethanave politike ata dhe të shikojë testet "Bulats" që është një nga mënyrat më të lehta për përjashtimin e punëtorëve shqiptarë që punojnë aty.

Për neve që janë disa pika që na kanë drejtuar dhe a ka mundësi t'i hiqet imuniteti EULEX-it pyesin. A ka mundësi të ngrihet padi në gjykatat tona? Nëse jo, a mund të paraqesim rastet e tyre kush e di dhe që shkelën. Po thotë: unë kërkoj nga Parlamenti të rishikojë procedurat e "Bulats" dhe rezultatet e testit për shkak se janë përjashtuar rreth 500 punëtorë me qëllim që ai të jetë i pastër në proceset e ardhshme pas vitit të ri. Prandaj, unë po flas që ato që do të na ndodhin pas vitit të ri se para vitit të ri jemi duke i parë krejt.

Pas vitit të ri do ta kemi një gjykatë speciale, të cilën e kanë paralajmëruar që do të fillojë punën më 1 janar dhe kjo tregon që largimi i punëtorëve shqiptar aty do të thotë jep mundësi trajtimi të veçantë gjitha rasteve të gjykatës speciale edhe ku do të jenë vetëm punëtorët shqiptar mungesë, ndërsa punëtorët që kanë qenë të komuniteteve tjera dhe komuniteti serbë janë duke punuar për t'i ruajtur sekretet atje.

Mandej, ka pasur edhe kërcënime ku stafi është kërcënuar nga ndërkombëtarët sikur Mickel Sabatini dhe është kërcënuar vendorëve dhe ju ka drejtuar edhe me fjalët "ju duhet të jeni të lumtur që punoni në EULEX, përndryshe akoma do të ishit duke gropuar në minierën e Trepçës", pra janë fyerje që u janë bërë nga EULEX-i punëtorëve shqiptarë për veprat aty ose "do të ishit duke u vozitur me traktorë duke ikur nga vendi juaj".

Mendoj që Qeveria duhet ta mbrojë stafin vendor, duhet të kërkojë nga EULEX-i trajtim njerëzor dhe t'i mbrojë të drejtat e punëtorëve edhe Ministria e Punës, edhe Ministria e Drejtësisë, edhe kryeministri dhe të gjithë. Prandaj, të gjitha këto janë mendoj që nëse nuk i trajtojmë dhe nuk i mbrojmë në punëtorët tanë që punojnë, atëherë cila është arsyeja që themi kjo është e drejtë ose ajo është e padrejtë për EULEX-in.

Unë besoj që Qeveria është dashur dhe duhet të ketë konsultime, duhet të del të mbrojë punëtorët tanë dhe duhet ta thërras EULEX-in në debat apo diku që edhe këtu vjet na raportoi për punën e tyre që e bëjnë. Për më shumë, Gjykata Speciale i ka diskriminuar, do t'i diskriminojë punëtorët në Kosovë, punëtorët shqiptarë që punojnë pranë EULEX-it dhe prokurorët dhe gjyqtarët vendor. Mendoj që në bazë të amendamentit 24 që e kemi pasur në Kushtetutën e Kosovës neni i ri 162, që çfarë do të bëjë Qeveria që të sigurojë pjesëmarrjen e stafit vendor në Gjykatën Speciale, e cila për momentin po i ndalon dhe i diskriminon qytetarët e Kosovës, prandaj duhet edhe në bazë të kësaj të shqyrtohet.

Si mund kjo Gjykatë Speciale të shihet si e drejtë dhe e paanshme ku të gjithë refuzojnë të punësojnë qytetarët shqiptar pikërisht kur janë hapur konkurset dhe në ato konkurse asnjë vendor nuk është vetëm të komuniteteve tjera, në këtë rast komunitetit serbë. Mendoj që Qeveria duhet ta ketë këtë dhe ta kemi një transparencë tani të Gjykatës Speciale dhe Gjykata Speciale duhet t'i trajtojë çështjet për të cilat është.

Mendoj që rasti për të cilën u thirr seanca është edhe njëherë them e dhimbshme, e ndjeshme mjaftë është e politizuar, por nëse duam transparencë prandaj, po kërkoj nga të gjitha grupet dikush e tha që edhe i drejtohet kryeministrit nëse duhen investime ose shpenzime të bëhen të gjitha shpenzimet për mbulimin e atyre që duhet edhe ta bëjnë një transparencë nga çfarëdo ekspertë i fushave të drejtësisë apo të mjekësisë ligjore që ta kemi të paktën një gjendje të mirë dhe të flemë të qetë.

Përndryshe, kemi qenë pjesë e burgjeve edhe jetën e brendshme të burgjeve dhe të burgut të Prizrenit e njohim mjaftë mirë, kam qenë diku nga 3 vjet në Burgun e Prizrenit për dijeninë e shumëkujt, pikërisht në ato dhoma ku ka ndodhur rasti kam qenë dhe e di si është gjendja e brendshme, e di si hekurat e burgut nuk ka mundësi brenda minutave të këputen dhe të ngjiten. Ka mundësi transparenca të jetë e plotë, ka mundësi me ato kamerat që është bërë verifikimi dhe incizimi të merren dhe të bëhet ekspertizë e tyre që të japin një rezultat pozitiv ta dimë si është gjendja. Unë nuk po merrem për shkaqet, shkaqet mund të jenë politike, mund të jenë të drejtësisë, mund të jenë ndaj çrregullimit e tjera, e tjera. Ato le të mbeten çështje të drejtësisë, për mua është çështje që transparenca neve na qetëson të gjithëve dhe i jep kuptim zhvillimit të vendit tonë. Faleminderit!

(Drejtimin e mbledhjes e merr kryetari i Kuvendit, z. Kadri Veseli.)

KRYETARI: Faleminderit! Shqipe Pantina e ka fjalën, bëhet gati Gëzim Kelmendi.

SHQIPE PANTINA: Në fakt duke qenë se para se të bëhesha pjesë e këtij Kuvendi dhe para se t'i bashkohesha Lëvizjes "Vetëvendosje", unë kryesisht aktivitetin tim e kam pasur si pjesë e shoqërisë civile, e një letër e dërguar nga shoqëria civile plotësisht u injorua sot, unë mora përsipër që ta lexoj me zë para jush letrën, të cilën secili prej nesh e kemi në kutitë tona postare.

Prishtinë, 20 dhjetor 2016.

I nderuar deputet/deputete,

Me këtë shkresë ne Grupi i Shoqërisë Civile ripërsërisim kërkesën tonë drejtuar Kuvendit të Kosovës për të shqyrtuar kërkesën e 23 mijë e 774 qytetarëve të Republikës së Kosovës, të shprehur përmes peticionit "Drejtësi për Astritin". Ky peticion padrejtësisht në shkelje të rëndë të Kushtetutës dhe të të drejtës së qytetarëve në vendimmarrje nuk u trajtua nga institucionet e Republikës në shpërfillje të plotë të të gjitha procedurave dhe praktikës parlamentare edhe pse Komisionit Parlamentar përkatës e dha rekomandimin që Kryesia e Kuvendit të vendosë për thirrjen e seancës sipas kërkesës së parashtruar.

Në këto kushte, përmes kësaj letre kërkojmë që ju si deputetë në respekt të kushtetutshmërisë dhe të betimit tuaj, t'i trajtoni seriozisht kërkesat e mijëra qytetarëve të nënshkruar në peticion dhe që këto kërkesa të dalin si rezolutë nga seanca e jashtëzakonshme e Kuvendit të Republikës së

Kosovës që po mbahet sot, më 20.12.2016. Kërkesat tona dhe të 23 mijë e 774 qytetarëve të Republikës së Kosovës janë si më poshtë:

1. Hetim i pavarur dhe transparent për rastin e vdekjes së Astrit Deharit në Burgun e Prizrenit
2. Dorëheqjen e udhëheqësve të Ministrisë së Drejtësisë dhe Ministrisë së Punëve të Brendshme për mos gatishmërinë morale e ligjore për të kërkuar dhe dhënë përgjegjësi për vdekjen e Astrit Deharit.
3. Fillimin e menjëhershëm të ndjekjes penale të përgjegjësve që dështuan të garantojnë sigurinë e jetës së Astritit në institucionet e shtetit dhe shkarkimin e zyrtarëve përgjegjës në tërë zinxhirin hierarkik për mos trajtimin dinjitoz të Astritit në qendrën e paraburgimit dhe pas vdekjes së tij.

Urojmë që të veproni sipas mandatit dhe detyrës që e keni. Pra, unë e jap mbështetjen time dhe votën time për këto tri kërkesa të drejtuara nga qytetarët për Shoqërisë Civile dhe shpresoj që të njëjtën ta bëni edhe ju. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Zoti Kelmendi fjala për ju, ndërkohë përgatitet zoti Bislim Zogaj.

GËZIM KELMENDI: Faleminderit, i nderuar kryetar!

E nderuar familje Dehari,

Të nderuar kolegë deputetë dhe deputete,

Mysafirë të nderuar,

Debati për rastin e vdekjes së Astrit Deharit mendoj që është një debat i vonuar, një seancë e vonuar ngase ne kohë më parë e kishim një kërkesë nga Lëvizja “Vetëvendosje”, kërkesa e cila nuk arriti të realizohet në një seancë të jashtëzakonshme. Kanë qenë shumë arsye pse është dashur të mbahet ajo seancë e jashtëzakonshme e iniciuar nga Lëvizja “Vetëvendosje”, përveç natyrës, formës dhe vendit të vdekjes ka qenë një solidarizim së paku me kolegët parlamentar, ngase mos të harrojmë Lëvizja “Vetëvendosje” është parti parlamentare, është pjesë e Parlamentit të Kosovës nëse për ndonjë aspekt nuk është dashur të mbështet së paku në këtë pikë është dashur të solidarizohemi me Lëvizjen “Vetëvendosje” për faktin se bëhet fjalë për një aktivist të Lëvizjes “Vetëvendosje”.

Prandaj, unë mendoj që ky debat është i vonuar dhe vonesën e këtij debati e bën edhe më të rëndë fakti se ky debat vjen pas verdiktit përfundimtar të institucioneve të drejtësisë kosovare, ku vdekja e Astrit Deharit konsiderohet si vetëvrasje pa dashur të paragjykojë, ngase ne sot i kemi dy verdikte: e kemi një që e cilëson në vetëvrasje, ndërsa verdikti tjetër e ekspertëve ligjor e cilësor si vrasje.

Pa dashur të paragjykoj aktin se si ka ndodhur, unë mendoj që ne si Parlament i Kosovës jemi të pavarur nga institucionet e drejtësisë dhe në asnjë moment nuk duhet të presim verdiktin e

institucionit të drejtësisë, ngase është thënë dhe po thuhet në vazhdimësi se Parlamenti nuk guxon të përziejë në kompetenca të drejtësisë, ne me këtë seancë të sotme me këtë debat të sotëm thuajse jemi përzier tërësisht, ngase kemi mirëprit një verdikt final dhe tash ne flasim mbi atë verdikt se si ka ndodh vdekja, vrasja apo vetëvrasja e Astrit Deharit. Prandaj, kërkesa dhe debati i tillë është dashur të zhvillohet shumë më herët, të jetë më parimor pavarësisht verdiktit përfundimtar.

Jemi duke jetuar në një shtet demokratik, ku synojmë në integrimin e strukturave euro atlantike edhe në Bashkimin Evropian. Vdekja e Astrit Deharit ka paraqitur dhe ka qitur në pah një situatë që ekziston në burgjet e Kosovës, mos të harrojmë se dy vite më parë në një burg tjetër, jo në Prizren, por konkretisht në Dubravë një qytetar i Kosovës për një dënim të shkallës civile në vonesë të pagesave të taksave është dhunuar seksualisht nga shokët e tij të dhomës. Do të thotë, gjendjen e tillë të vdekjeve dhe rasteve të tilla në burgjet e Kosovës, vdekja e Astrit Deharit duhet të jetë një moment kur vërtet bëhen reforma pozitive në shërbimin korrektues në burgjet e Kosovës, respektohen liritë dhe të drejtat e qytetarëve të Kosovës, të konsiderohen të gjithë të barabartë.

Fatkeqësisht jo vetëm në liri këtu edhe në politikë, por edhe në burgje ka diskriminime në raport me shqiptarëve dhe serbëve. E dini i akuzuari për terrorizëm për vepra terroriste i cili para dy vjetësh u arrestua pranë Ambasadës Amerikane një natë para Krishtlindjeve, me 13 kg eksploziv, tash i është zvogëluar dënimi nga 13 vjet në 11 vjet, atij i është transferuar burgu nga një burg tjetër në një burg tjetër ngase nuk ka qenë komod, ndoshta brenda kësaj vere pritet ta dërgojnë edhe në pushime verore. Ndërsa shqiptarët e Kosovës ballafaqohen me këto diskriminime edhe vdekje brenda burgjeve të Kosovës pa dashur të paragjykojë verdiktin final të formës së vdekjes së Astrit Deharit, kërkoj që të bëhet vërtetë një hetim ndërkombëtar, njëherë e përgjithmonë të zbardhet ky rast, por edhe të fillojë reforma pozitive, të respektohen liritë dhe të drejtat e qytetarëve të Kosovës në burgjet e Kosovës pa dallim nacionaliteti, feje e race. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Atëherë, ndërkohë zoti Abdyl Ymeri reagoi Grupi Parlamentar i PDK-së. Zoti Abdyl Ymeri e ka fjalën, përgatitet Albin Kurti.

ABDYL YMERI: Faleminderit, kryetar!

Të nderuar kolegë deputetë,

Sot për të gjithë ne që jemi në këtë sallë është e vështirë të diskutojmë dhe të gjejmë fjalët e duhura për vdekjen tragjike të Astritit. Familjarë, miq e shok të Astritit nga këtu ju shpreh ngushëllimet e mija më të sinqerta për Astritin. Lajmi i dhënë në media të shkruara dhe elektronike për vdekjen e Astrit Deharit në Qendrën e Paraburgimit në Prizren, ishte lajm shokues dhe tronditës, i cili preku thellë në zemrat dhe shpirtin e familjarëve, miqve, shokëve dhe çdo qytetari të Kosovës pa marrë parasysh mënyrën apo formën e vdekjes, sepse ai ndërroi jetë në një institucion korrektues.

Unë personalisht nuk e kam njohur Astritin dhe familjen Dehari, por pas rastit tragjik një mik i imi më ka folur për familjen Dehari, për të bëmat dhe veprat e kësaj familje si një familje e respektuar dhe me traditë patriotike ku kontributi i saj në çështjen kombëtare ishte i veçantë. Portreti i Astritit i shfaqur me një buzëqeshje të lehtë dhe i paraqitur në një foto, të cilën e shohim kudo na tregon për dimensionin dhe karakterin e tij, i cili rrezaton dije, frymëzim, guximin si vlerë, përkushtim dhe gjallëri, të cilët u shuan së bashku me ëndrrat, të cilat i ëndërronte Astriti.

Familjarë, miq e shokë të Astritit ju kuptoj se dhimbja është e madhe dhe e pakrahasueshme. Sepse, është shuar tepër i ri Astriti i cili para vetes kishte studimet dhe aktivitetet politike, por gjejeni ngushëllimin në kujtimet, në punën dhe përkushtimin e tij ndaj familjes, miqve dhe shokëve. Kurse, për ne si shoqëri ajo buzëqeshje e ngrirë në portretin e tij na thërret edhe na obligon që të kemi një hetim transparent dhe të gjithanshëm për të ardhur deri tek e vërteta dhe vetëm e vërteta në mënyrë që sado pak t'ia lehtësojmë dhimbjen të gjithë atyre që kanë zemrat e thyera dhe shpirtin e lënduar.

E unë besoj që ky është një rast që ka prekur çdo qytetarë dhe dhëntë Zoti që asnjëherë të mos kemi raste të tillë. Për mua ka qenë shqetësuese mënyra e komunikimit me publikun nga organet kompetente, sepse kemi pas deklarata kontradiktore, të cilat e kanë bërë vdekjen edhe më të mistershme. Në rastin e tillë duke e ditur se kemi të bëjmë me një rast të ndjeshëm, me një aktivist politik, organet kompetente është dashur të jenë shumë të kujdesshme në deklarimet e tyre para publikut dhe të kenë transparencë në maksimum, në mënyrë që mos të lihet hapësirë apo diç për dyshim, sepse nuk e besoj që dikush apo shteti siç thonë disa që ka pasur ndonjë interes që ta vrasë Astritin.

Në anën tjetër, nuk duhet të politizohet ky rast për qëllime politike, por duhet lënë organet e drejtësisë ta thonë të vërtetën, të kursehem deri në zbardhjen e plotë të rastit dhe mos të luhet me ndjenjat e asaj familje dhe qytetarëve në përgjithësi, sepse ajo familje është lënduar shumë dhe para se gjithash ne duhet të tregojmë një minimum të humanitetit dhe solidaritetit me këtë familje.

Po ashtu, gjatë kësaj periudhe kemi dëgjuar deklaratat më të ndryshme e në shumë raste dhe jo profesionale nga ata që vërtetë duhet të ishin profesionistë. Deklarata të paragjykuara, të cilat sjellin huti në opinionin e gjerë dhe që nuk ndihmojnë aspak në procesin e zbardhjes së rastit, siç janë deklaratat e avokatit të familjes së të ndjerit, një manipuluesi të zhdërvjelltë i cili për gjithçka ka më shumë mendime politike se juridike.

Apo siç thotë gazetari Vehbi Kajtazi në një shënim “Avokati Tomë Gashi është profesionist për manipulimin e masës në interes të klientëve të tij, i cili në debate televizive veç sa nuk i ka shpallur fajtor”. Për mua çka do që thotë babai, nëna dhe motra e Astritit ju jap të drejtë, sepse në

popull thuhet “nuk ka asgjë më të vështirë në këtë botë, se sa kur prindërit e përcjellin fëmijën e tyre në botën e amshueshme”. Kurse, të tjerët duhet të rezervohen nga deklaratimet për përfitime politike. Nëse familja Dehari nuk u beson organeve kompetente të hetuesisë, policisë, shërbimit korrektues, atëherë ne duhet të jemi me familjen Dehari dhe të kërkojmë hetim krejt të pavarur në mënyrë që ne të kemi vetëm një të vërtetë për vdekjen e Astritit, sepse këtë duan ta dinë secili qytetarë. Do të thotë, të kemi një super ekspertizë siç po thotë kryetari i Kuvendit nga ekspertët ndërkombëtar dhe ta dimë të vërtetën për vdekjen e Astritit, pasi që tani ne kemi dy të vërteta rreth këtij rasti, ato të institucioneve që mbrojnë konkluzionin se i ndjeri është vetëvrarë, kurse “Vetëvendosja”, familja dhe avokati e mbrojnë konkluzionin e tyre se i ndjeri është vrarë.

Sido që të jetë organet e drejtësisë duhet të thonë fjalën e tyre dhe kushdo që të jetë përgjegjësi për vdekjen e Astritit të vihen para drejtësisë. Pas fjalimeve të disa kolegëve më duhet të them nuk mund të debatojmë këtu sa të doni, ne mund të debatojmë këtu sa të doni, por këtyre të “Vetëvendosjes” edhe nëse ua vendosim të gjitha faktet këtu përpara nuk i pranojnë dhe përsëri i mohojnë se pse e kanë versionin e tyre politik me të cilin e kanë manipuluar publikun gjatë gjithë kësaj kohe. Faleminderit!

KRYETARI: Zoti Kurti fjala për ju, bëhet gati zonja Xhevahire Izmaku.

ALBIN KURTI: Deputetë të Kuvendit të Kosovës,
Qytetarë të Republikës,

Astrit Dehari ishte aktivist i jashtëzakonshëm i Lëvizjes “Vetëvendosje”. Ai sigurisht që ishte edhe njeri i mirë, student shembullor, banor i kryeqytetit, por para se gjithash e mbi të gjitha ishte aktivist i jashtëzakonshëm.

Meqenëse ishte aktivist politik ne nuk mund të flasim për Astritin, e të mos flasim për politikën, e çka do që flasim ne për politikën teksa flasim për Astritin nuk jemi duke politizuar. Politizimin e ka bërë sistemi shtetëror në Kosovë, posaçërisht policia dhe drejtësia ku politikisht e kanë përzgjedhur Astritin që së pari ta akuzojnë pa faj, e mandej pasi që e morën në pranga ta nxjerrin të vdekur nga burgu.

Drejtësia dihet që i nxjerr jashtë shoqërisë kriminelët dhe i fut brenda në burg, mirëpo në Kosovë drejtësia dhe sistemi prej burgut tek gjyqësia, prej Qeverisë tek prokuroria dhe policia janë bërë vetë ato vende të krimit. Mbi Astrit Deharin është kryer krimi prej ditës kur është arrestua e deri atëherë ku e humbi jetën, më 5 nëntor. Në kohën ku po dështonte përfundimisht procesi kundër Astrit Deharit, proces ky i montuar kur u pa që është e pamundur të ngrihen aktakuza përkundër shpifjeve dhe fabrikimeve ndodhi kjo tragjedi jo vetëm për familjen Dehari e lëvizjen tonë, por për mbarë Kosovën, sepse ai ishte shqiptar, ishte shtetas i Republikës sonë.

Mirëpo, Astriti nuk ishte thjeshtë në burg, Astriti ishte i paraburgosur, pra as dënim as aktakuzë. Është situatë tjetër atëherë kur vdes në burg një person i dënuar e në vuajtje të dënimit dhe është diçka krejtësisht ndryshe, atëherë kur dikush vdes në paraburgim. Astriti ishte në paraburgim dhe rrjedhimisht i pafajshëm, jo vetëm moralisht e politikisht, por e ligjërisht e nominalisht. Në Burgun e Prizrenit, në qelinë A3, ka vdekur një i pafajshëm. Nuk ka vdekur me medikamente të tepruara, ekspertiza ligjore ka konstatuar që për 11 lloje të drogave janë zhvilluar teste dhe në asnjërën prej tyre Astriti nuk ka dal pozitiv. 11 lloje të drogave, kurrfarë medikamenti, trup i shëndoshë plotësisht në aspektin psikik e fizik.

Të dënuarit me dënime dhjetëra vjeçare ose me burgime të përjetshme, edhe bëjnë vetëvrasje. Po ashtu, ata me probleme psikike, edhe ata bëjnë vetëvrasje, por jo njerëzit e shëndoshë në paraburgim që s'kanë as aktakuzë se lëre më gjykim e dënim. Këto raste ndodhin shpesh në Rusi, në Rusi vdesin shumë njerëz në paraburgim pa e pritur gjyqin asnjëherë. Të vdesësh në paraburgim i bie sikur të kishe vdekur pak a shumë në stacion policor dhe për mua nuk është e rastësishme që pasi që u mësua vdekja e Astritit, më 5 nëntor, i pari që foli nuk ishte drejtori i burgut, as Ministria e Drejtësisë, as zonja ministre, por ishte kryepolici i rajonit të Prizrenit, zoti Nexhmi Krasniqi.

Thua jse, Astriti na vdiq në rrugë ose në stacion policor. Ai fizikisht ishte tek regjistri i Ministrisë së Drejtësisë, por realisht e politikisht, e proceduralisht duket se ishte në regjistrin e Ministrisë së Punëve të Brendshme dhe sërish nuk është e rastësishme që 68 ditë nuk u morë në pyetje fare. Prokuroria nuk e merrte në dorë fare Astritin, ia linte policisë disi. Prandaj, edhe Nexhmi Krasniqi është i pari i cili flet dhe jo vetëm që flet, por gënjen. Flet për medikamente të paqena, për teprime në medikamente të paqena.

Ne kemi fituar si Lëvizje “Vetëvendosje” ditën kur është anëtarësuar Astrit Dehari në lëvizjen tonë dhe secilën ditë që prej atëherë, ne kemi fituar, por më 5 nëntor, ka përfutur ky regjim dhe prandaj dhimbja jonë është e dyfishtë, sepse në njërin anë ne nuk e kemi më Astritin e në anën tjetër ka përfutur regjimi, se ky regjim është forcuar ca duke mos qenë në jetë më Astriti.

Nëse Astriti do të lihej në liri të plotë, ose me detyrim të paraqitej në Polici, atëherë do të mund të mos ngutej prokurori. Mirëpo, të mbahet në paraburgim pa u intervistuar asnjëherë, e të mos i ngutet fare prokurorit, atëherë kjo është së paku tendencë për izolim, e kurrresi për të vërtetën ose drejtësinë.

Me Kodin e Procedurës Penale, masat për sigurinë e të pandehurit në procedurën penale janë të përcaktuara me nenin 173. Masa e paraburgimit është masa e fundit e përcaktuar me këtë nen, para saj vijnë masat tjera më të lehta. Gjykata duhet ta ketë parasysh kur të vendosë për sigurimin e të pandehurit te procedura masën më të butë, kur nuk nevojitet masa më e rëndë. Ky është parim universal i gjykatës, por edhe i Prokurorisë si kërkuese e masës. Nuk ekziston asnjë

rast që aktivistët e “Vetëvendosjes” i kanë ikur Prokurorisë e Gjykatës. Ne nuk u jemi përgjigjur atyre në ftesa për vepra politike. Gjykata nuk mund ta faktojë asnjë rast që ndonjë aktivist yni ka ikur për Shqipëri a Suedi, siç ka bërë, ta zëmë, Xhabir Zharku e të tjerë. Gjykata ka mundur, për shembull, me procedurë të kërkojë nga i pandehuri të mos e braktisë vendqëndrimin, gjë të cilën ne nuk e kemi bërë asnjëherë. Në shumë raste deputetët, pra aktivistët tanë, janë paraqitur në Polici që është masa e pestë e përcaktuar me këtë nen apo, siç e kemi rastin e aktivistëve në arrestin shtëpiak, më herët tre e tash pesë sosh. Asnjëri prej tyre nuk e ka shkelur masën, asnjëherë. Gjykata ka mundur me aktvendim t’ua konfiskojë atyre pasaportën e shumë gjëra të tjera, por nuk e ka bërë, sepse qartazi synimi nuk ka qenë e vërteta dhe drejtësia, synimi ka qenë izolimi e mbase edhe më keq se kaq.

Regjimi që e kemi në fuqi po e akuzon për çdo gjë opozitën, mentalitetin e popullit dhe kulturën e shoqërisë, prandaj ai i njëjti tash po e akuzon edhe të burgosurin për çfarëdo që i ndodh atij.

Arrestimi i gjashtë aktivistëve të “Vetëvendosjes”, përveç Qeverisë është përgatitur edhe këtu, në këtë sallë, në fillim të muajit gusht. Teksti fillestar i deklaratës, e cila dënonte sulmin me predhë mbi Kuvend, e fajësonte opozitën, përkatësisht Lëvizjen “Vetëvendosje”. Këtu është përgatitur teksti, mandej ka vazhduar Policia me konferenca shtypi pas arrestimit që e bëri, por këta prokurorë, këta policë e këta gjykatës janë bërë për tu intervistuar e për tu hetuar ata vetë, në vend se të lejohen të intervistojnë apo hetojnë dikë tjetër.

Dy dhoma të Policisë së Kosovës, të sigurisë së lartë të provave, janë vjedhur, askush nuk është gjykuar apo dënuar për këtë gjë. Jo vetëm që bëhen krimet, sepse edhe mundësimi i krimit është krim, por në të njëjtën kohë bëhet krimi shtesë, sepse nuk ndëshkohet ai paraprak.

Kryepolici i rajonit të Prizrenit, Nexhmi Krasniqi, pati thënë i pari që Astriti ka vdekur nga doza e tepërt e medikamenteve. Kryeprokurori i Gjykatës Themelore në Prizren, Syl Hoxha, konstatoi se Astriti është vetëvrarë ende pa u bërë e pa u kryer hetimet. Kjo tregon se edhe në Polici edhe në Prokurori nuk kemi pasur si synim të vërtetën e drejtësinë, por një qëllim tendencioz. Pra, ka ekzistuar një qëllim para drejtësisë. Dhe, ky është problemi pse ne nuk mund t’i besojmë sistemit të drejtësisë, jo vetëm për rastet e tjera, por sidomos për këtë rast. Prej Nexhmi Krasniqit te Sylë Hoxha na kanë treguar se e kanë një qëllim tjetër, tendencioz, që është prioritet në raport me të vërtetën faktike dhe drejtësinë. Ata neve na kanë treguar, jo ne atyre.

Mandej, është ditur që raporti i autopsisë do të thotë se shkaku i vdekjes është asfiksia mekanike, pra bllokimi i rrugëve të sipërme të frymëmarrjes nga mjeti i fortë, një shishe e plastikës. Kjo ka qenë e ditur. Këtë raport të autopsisë tre ekspertët shtetërorë të Mjekësisë Ligjore kanë mundur ta bëjnë menjëherë pas obduksionit, që u krye më 7 nëntor. Më 8 nëntor kanë mundur ta thonë këtë gjë, mirëpo nuk e thanë më 8 nëntor. Ata kanë pritur deri më 18 nëntor, 11 ditë më vonë. A e dini pse? Njëmbëdhjetë ditë u është dashur atyre të presin për t’i thënë tri fjalë: “dëmtime të

vetëshkaktuara me hezitim”. Për t’i thënë këto tri fjalë u janë dashur njëmbëdhjetë ditë, përndryshe raporti i autopsisë ka mundur të publikohet të nesërmen.

Është e thellë ndërhyrja politike në këtë rast dhe në gjithë situatën e krijuar. Ju e mbani mend që kryetari i Kuvendit, i instaluar nga mazhoranca me katapult direkt nga nëntoka, pati thënë që “po e vrani veten”, disa ditë para se të vdesë Astriti. “Kujdes, se po e vrani veten!” Ky duhet të na tregojë neve se për çka e kishte fjalën. Çfarë figure kishte në mendjen e tij, teksa na e bënte këtë pyetje neve. A e kishte në mendje Dino Hasanajn, Hamdi Sopën apo ndonjë tjetër?

Çka do të thotë kjo: “po e vrani veten...” vetëm disa ditë para se të vdesë Astrit Dehari? Nuk ka dhënë përgjigje për këtë gjë. Fjalimi i zonjës Hadërgjonaj në thelb ishte plagjiaturë, atë e ka kopjuar nga ndonjë delegat i Kuvendit krahinor në vitin 1981, teksa fliste për manipulimin e rinisë, “Vetëvendosja” po manipulon rininë”. Ky fjalim është plagjiaturë, ky fjalim është i vjetër 35 vjet.

Sa për vizitat në burg, po, ka qenë Sami Kurteshi e ka vizituar Astrit Deharin, ka qenë Dardan Molliqaj e ka vizituar Astrit Deharin. Pas Dardanit në rend ka qenë Zgjim Hyseni, pas Zgjimit në rend kam qenë unë, pas meje në rend ka qenë Liburn Aliu. Dhe, të ju them të drejtën, edhe unë jam befasuar ca, përse po na lejojnë të shkojmë ta vizitojmë kaq kollaj. Edhe unë kam qenë i befasuar ca! Akuzë për terrorizëm, akuzë më e rëndë s’është e mundshme, por po na lejojnë t’i vizitojmë!

Unë e kam veç një shpjegim, që të na përgojnë, nuk kanë prova, u ka kolapsuar procesi. “Lëri le të vijnë ata të “Vetëvendosjes” e mos po marrim vesh ndonjë gjë, mos po e kapim ndonjë fjalë që ua përdorim në gjyq...”, nuk ka shpjegim tjetër. Me të vërtetë, si bëhet që na lanë të shkojmë në vizitë, të gjithë me leje janë. Edhe unë kam pasur, po të ishte gjallë, të shkoj pas nja dy javësh, pas Zgjimit. Ne u gëzuam që na lejuan, por nuk ka shpjegim tjetër kjo, përveçse të mbledhin prova në situatën kur ato nuk i kishin. Dhe, unë i shoh dy motive të mundshme të regjimit për atë çfarë i ka ndodhur Astritit.

I pari është ky, pra, ka kolapsuar procesi. A din çka do të thotë gjashtë të rinj t’i akuzosh për terrorizëm e emrat e tyre t’ua futësh në listën e të akuzuarve për terrorizëm në Botë. Shërbimet e ndryshme sekrete e jo sekrete, policore e të drejtësisë, në mbarë Evropën, në Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe shumë më gjerë se perëndimi, tash i kanë emrat e gjashtë aktivistëve të “Vetëvendosjes”.

Qëllimi është që të thuhet se po luftohet terrorizmi dhe “Kush të akuzohet për terrorizëm? - “Vetëvendosja”. De kur u kolapsi procesi... tash duhet me bë diçka. Këtu është motivi i mundshëm i këtij regjimi. Ju ka kolapsuar procesi! Na lejonin në vizita, se mos po flasim ndonjë

gjë, a po kuptoni, se s'kishin prova. Sot janë krejt në arrest shtëpiak. Pesë veta për terrorizëm i ke te shtëpia sot, janë duke e parë seancën ndoshta, nëse s'kanë ndonjë punë më të mençme.

A po e kuptoni!? U ka kolapsuar procesi, me i shti në lista të amerikanëve e të evropianëve gjashtë të akuzuar për terrorizëm e mos me mujt me bë kurrgjë, natyrisht se duhet me bë diçka. edhe motivi i dytë është që kanë hequr dorë prej neve që jemi këtu, brezi i mesëm i politikanëve, kanë filluar ta sulmojnë brezin e ri, patriotëve të rinj të këtij shekulli, të socialdemokratëve të rinj, të idealistëve, të militantëve të rinj, këtë po e sulmojnë. Prej meje kanë hequr dorë më, unë jam bërë aktivist veteran tash. Më 14 dhjetor unë e pata gjyqin, gjykatësi Kalludra pati kërcënuar që ma lëshon fletarrestim, më 14 dhjetor Flora Brovinës tha po ia lëshoj fletarrestim. Ka hequr dorë prej meje, a po kuptoni? S'duan të më marrin mua më, duan brezin e ri, këta që i kanë nga 20 e ca vjet. Po, edhe kjo ta kujton pak shekullin e kaluar, apo jo!? Jo neve më, Visarin, Glaukun, Bacin Ismajl, Donikën, Albulenën, s'na marrin neve më, por duan këta të rinjtë t'i tmerrojnë, se mos po mësohen edhe këta me burg e duhet t'u thuhet që "ti hyn në burg, por mund të mos dalësh", po kuptoni? Këto janë dy elementet e motivit të mundshëm të këtij regjimi.

Pra, ka dështuar ky proces, pra Astriti sot nuk është fizikisht midis nesh,...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARI: Regjia, mos ia ndal, se mendon se ia kam ndalë unë, lejoja gjithë ditën.

ALBIN KURTI: ...por ai nga një njeri i mirë, student shembullor e qytetar aktiv, aktivist politik, sot është shndërruar në simbolin e betejës shoqërore për drejtësi.

Sigurisht se këtë betejë do ta fitojmë, jo vetëm për Astritin, po për të gjithë qytetarët e Republikës, jo vetëm për këtë brez, por edhe për gjeneratat e ardhshme. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Zonja Xhevahire Izmaku e ka fjalën, bëhet gati zoti Visar Ymeri.

XHEVAHIRE IZMAKU: Faleminderit, kryetar, për fjalën!

I nderuar nënkryetar,

E nderuar ministre,

Të nderuar kolegë deputetë,

Qytetar,

E nderuar familje Dehari,

Nuk është aspak e lehtë sot të gjenden fjalët e përshtatshme, reale dhe të cilat nuk do të prekin dikë në këtë rast, kur polarizimet janë thelluar tërësisht. Por, edhe me koston që të quhem "hipokrite", më lejoni që para se të filloj fjalën time edhe unë si kolegët e mi të tjerë, dua që

përmes kësaj ulëse të institucionit më të lartë të vendit, t'i shpreh ngushëllimet e mija familjes së Astritit, gruas së tij dhe gjithë atyre që e njohën, punuan dhe jetuan këto vite me të ndjerin.

Ngushëllimet i shpreh edhe juve kolegë deputetë të “Vetëvendosjes”, sepse e keni pasur brenda vetes një aktivist, i cili sot nuk është. Dhe, vdekja e tij sigurisht se ju ka lënduar, por as juve, asnjërit, përfshirë edhe familjen, nuk u lejohet që mbi dhembjen e humbjes së një djali të ri të gjykoni kë ju del përpara për vrasje, për amoral, pa dallim gjykime pa argumente.

Ju pyesni “Si vdiq Dehari?”. Por, pyetjen ua shtroj edhe unë juve, si qytetare dhe deputete: A e dini pse vdiq Dehari?

Kolegu Konjfuca e përmendi faktin se ndihet i mërzhitur dhe kishte dhembje të madhe me rastin e humbjes së shokut të tij. Unë e besoj plotësisht dhe i shpreh ngushëllime sinqerisht, mirëpo a e mendoni që edhe ne si njerëz, si deputetë, si prind, gjithë këto javë kemi përjetuar, jemi përballë me fyerje të orkestruara në rrjete sociale, me ç’rast ka qenë problem edhe me shprehë ngushëllime, sepse kanë qenë fyerje të orkestruara, për të cilat asnjëri prej juve nuk është distancuar dhe i keni fryrë zjarrit në atë drejtim, që ende pa dalë rezultatet, të besojë i gjithë opinioni se kjo është një vrasje.

Hapja e debatit apo dëshira për zbardhjen e rastit Dehari, sot konsiderohet të jetë prioritet i të gjithëve, ndërsa kërkesa për adresim të përgjegjësisë pa zbardhjen e rastit tregon se dikujt i konvenonte më shumë një kërkesë politike të dalë në pah se sa ana humanitare e këtij rasti.

Kush nuk u trondit këto ditë, nga fotot që i sillte në dorë i ashtuquajtur i avokat, Tomë Gashi. Foto me plagët e vdekjes në fytyrën e re të Astritit, foto të cilat më parë u akuzuan mediet për to, i sillte në dorë, por në sytë e tij unë aspak, së paku personalisht, nuk pashë një dhembje, por dëshirë që të atakohen fajtorë për këto, të ketë atakim fajësie për këto. Ai njeri, sipas mendimit tim, më s’duhet të jetë a të qëndrojë në pozitën e avokatit, sepse është bërë avokat i vetëm një subjekti duke fyer e sharë të tjerët pa fakte, duke u thirrur në vlerësime të paqena. Andaj, pas sjelljes së tij aq joprofesionale në këtë rast, kërkoj si deputete nga Shoqata e Avokatëve të Kosovës të rivlerësojë licencën e tij. Nëse nga ana e parimeve të etikës, pa përmendur kriteret tjera, duhej tutje të qëndrojë, duhet tutje të mendojmë nëse duhet të qëndrojë apo jo në atë pozitë si avokat. Askush s’e pranon si të paqenë papërgjegjësinë që ndodhi, sepse një kujdes i shtuar nuk do ta linte pa mbikëqyrje një djalë, i cili kishte megjithatë precedencë në familje, sepse vëllai i tij kishte kryer vetëvrasje dy vjet më parë. Organet do të duhej ta mbikëqyrnin atë vazhdimisht, do të duhej ta mbanin nën vëzhgim me trajtimin e psikologëve dhe specialistëve, këtë nuk e bënë dhe për pasojë ndodhi vdekja e Astritit në rrethana shumë të errëta.

Menjëherë pas vdekjes së Deharit, “Vetëvendosja” doli me konstatimin se kjo është vrasje. Si guxuat, kolegë të nderuar? Sepse, kjo deklaratë nga ana e jashtme po tregon një kategorizim të

rëndë e nga ana tjetër, ju nuk pranuat dhe nuk jeni të gatshëm të pranoni kurrfarë versioni tjetër për këtë rast tragjik, pos vrasjes, sepse kështu ju konvenon. Unë s’ di si ta përkthej ndryshe.

Tani, më lejoni që të citoj vlerësimet e një agjencie lajmesh, të cilën “Vetëvendosja” për një kohë të gjatë i bëri trofe, sa ishte koha e përgjimeve dhe tani po citoj fjalët e “Insajder”-it, pra, të cilat në këtë rast, çuditshëm, janë edhe mendime të mijat, pra nuk janë plagjiaturë, sepse po citoj: “Vetëvendosje” e përdori vdekjen e Deharit kryekëput për qëllime politike, duke hequr dorë kështu nga parimi njerëzor i trajtimit të një tragjedie në mënyrë pak më humane.

Nëse nuk duhet tu besohet ekspertëve mjekoligjorë të departamentit të Mjekësisë Ligjore të Shtetit, të cilët kryejnë të gjitha ekspertizat në Kosovë, pse duhet tu besohet ekspertëve nga Shqipëria? Pra, më së paku ata quhen të pavarur, kur i angazhon një subjekt politik, pse jo edhe familja. Pos kësaj, avokati Gashi po manipulon me ekspertizat mjekoligjore, sepse asnjë raport nuk flet nëse dikush është vrarë apo vetëvrarë, ekspertët konstatojnë vetëm shkaqet e vdekjes, ndërsa hetuesit dhe Prokuroria janë ata që nxjerrin rezultatin përfundimtar, nëse dikush është vrarë apo vetëvrarë. Në gjithë këtë histori, Tomë Gashi më së paku është avokat.”

Rasti i Deharit duhet të jetë mësim i mirë, po e them tash unë personalisht, për sistemin e drejtësisë, sepse s’ka justifikim as vetëvrasja, por edhe ju, të nderuar kolegë, që gjykuat si vrasje, na gjykuat të gjithë neve pa dallim, pushtetin, deputetët kolegët e juaj, të keni kujdes, sepse akuzat e pabaza ju bëjnë të pabesueshëm edhe kur ju do të keni të drejtë në rastet tjera.

Edhe diçka, do të jem e pasinqertë nëse nuk do ta them, personalisht mendoj se askush më mirë se ju, si kolegë, nuk e din pse erdhi deri në atë gjendje Dehari. Kaq!

KRYETARI: Faleminderit! Zoti Ymeri, fjala për ju.

VISAR YMERI: Të nderuar qytetarë të Republikës së Kosovës,
Të gjithë ju që po e ndiqni këtë seancë nëpërmjet ekraneve tuaja televizive,
Është interesant edhe ajo që po e dëgjojmë sot këtu në sallë, po në përgjithësi, ajo që është thënë nga eksponentët e partive në pushtet, nga kreu i këtyre dy partive të koalicionit, se si “Vetëvendosja” po përfituaka prej rastit të Astrit Deharit dhe po synon të nxjerrë poenë politike nga kjo!

Ndërkohë, që në anën tjetër e kemi situatën kështu: Shoqëria Civile në peticionin e nënshkruar nga mbi 23 mijë qytetarë, në përgjithësi të gjithë ata që kanë marrë pjesë nëpër marshe të organizuara nëpër Kosovë, të gjithë ata që kanë qenë në të pame të familja Dehari, familja Dehari, po, po, edhe Lëvizja “Vetëvendosje”, vazhdimisht kanë insistuar që për rastin e Astritit duhet të ketë drejtësi. Pra, “Drejtësi për Astritin” ka qenë slogani përmbledhës i të gjitha këtyre aktiviteteve që kanë ardhur nga organizime të ndryshme shoqërore dhe të tjera.

Dhe, drejtësia për Astritin automatikisht nga krerët e subjekteve politike në pushtet, transmetohet në përfitim politik për Lëvizjen “Vetëvendosje”, që i bie se drejtësia, ose nga drejtësia përfiton Lëvizja “Vetëvendosje”. Por, jo. Nga drejtësia përfitojnë qytetarët e Republikës, përfiton Republika e Kosovës. Nga drejtësia përfiton secili. Të vetmit që i frikësohen drejtësisë, janë ata që janë të angazhuar në krim, ata i frikësohen drejtësisë. Pra, janë ata që duan ta ndalin drejtësinë, janë ata që fjalën “drejtësi” në aludimet e tyre dhe në konotacionet që ata i tërheqin, i japin kuptim të keq, të “përfitimit partiak”. Jo pra, drejtësia është për të gjithë, përveç për klanin “Pronto”, eh klani “Pronto” i frikësohet drejtësisë. Natyrisht, që i frikësohet klani “Pronto” drejtësisë, se në tërë karrierën e tyre politike të pasluftës, pjesën më të madhe e kanë në nëntokë, shumë vonë kanë dalë në sipërfaqe. Pra, fytyra e Kadri Veselit vonë është parë, por veprat e tij njihen prej vitit 1999.

Prandaj, drejtësia për Astritin, e cila është realisht drejtësi për Kosovën, është “halë në sy”, në këtë syrin e Kadri Veselit që mbyllet në RTK, në emisionin e Ridvanit, sepse ky i frikësohet drejtësisë. Rrjedhimisht, po, edhe “Vetëvendosja” përfiton nga drejtësia edhe qytetarët e Republikës përfitojnë nga drejtësia, ju nuk përfitoni nga drejtësia. Po, nuk ishte dashur ju të përfitoni, sepse përfitimi juaj është përfitim i krimit të organizuar, prandaj edhe nuk duhet lejuar përfitimi nga ju.

U përmend këtu raporti i autopsisë, është shumë interesant, disa herë, pra edhe i mjekoligjorëve, tre mjekoligjorëve të angazhuar nga Instituti për Mjekësi Ligjore në Prishtinë dhe pastaj edhe ky raporti tjetër i autopsisë, i cili është përpiluar nga dy ekspertët e angazhuar nga familja, të cilët njëri vjen nga Tirana e tjetri nga Londra. Dhe, këto janë kontradiktore njëra me tjetrën, po qe besa, edhe raporti i autopsisë i mjekoligjorëve, përkundër asaj që e tha ministria, që e përmend fjalën “vetëvrasje”, nuk e përmend fjalën “vetëvrasje” askund. Aty, siç e keni parë ju të gjithë, në dy versionet e dërguara në publik të këtij raporti, ka një lloj manipulimi të numrave në listë për të krijuar një të vërtetë, e cila nuk ka qenë e vërtetë as në raportin që thuhet. Pra, është keqpërdorur nga Sylë Hoxha, në mënyrë që të dalë me konstatimin e tij për vetëvrasje, kinse duke u bazuar në raportin e autopsisë, kur raporti i autopsisë, në fakt, nuk e thotë këtë, as ai i mjekoligjorëve. Ka shumë shkarje tjera, edhe logjike, edhe shkencore, por nuk e thotë që ka qenë vetëvrasje e aq më pak ky i dy mjekëve të pavarur.

Pra, unë dua t’i lexoj disa pjesë të këtij raportit të fundit, se me sa e pash unë, nuk e keni lexuar asnjëri, edhe pse i referoheshit atij, ose mbase, edhe ju jeni sikur ata nxënësit e “PISA”-s, që lexoni e nuk kuptoni. Aty thuhet kështu: pika e parë, të përfundimet, që “vdekja është e dhunshme dhe e menjëhershme. Ka ardhur si pasojë e asfiksionit mekanike, të dhunshme, traumatike”. Pra, kjo është të përfundimet, që i nxjerrin këta dy mjekoligjorë në bazë të një raporti, që e kanë përpiluar edhe duke qenë pjesë të autopsisë, të pranuar zyrtarisht nga Prokuroria dhe pastaj duke i analizuar edhe dëshmitë tjera në formë të fotografive, të cilat eventalisht ua ka dhënë në dispozicion Prokuroria edhe atyre.

Te pika e 5-të thuhet kështu, në mes tjerash, pra një pjesë e tekstit është kështu: “Mbyllja e laringut, pra, në fundin e gojës, një ngufatje e tillë kryhet gjatë dhunimit, zakonisht, me qëllim të pengimit të britmës për ndihmë të viktimës së sulmuar tek të rriturit. Asfiksi mekanike e shkaktuar nga mbyllja e vrimës së gojës pa mbyllur vrimat e hundës, nuk parandodhin zakonisht.” Dhe, tek konkluzioni është vetëm një konkluzion, po e lexoj të tërën, sepse i ka trekatër rreshta, thuhet kështu: “Bazuar në të dhënat e mësipërme dhe në kriteret mjekoligjore bashkëkohore, vdekja e të paraburgosurit Astrit Dehari ka ardhur si pasojë e asfiksionit mekanike, traumatike, si lëndimet e shkaktuara nga mungesa e oksigjenit, për shkak të pengesave mekanike të bllokimit të rrugëve të frymëmarrjes së brendshme nga ngjeshja me forcë e një mjeti me konsistencë të fortë. Asfiksia klasifikohet e dhunshme, me ndërprerje të plotë të frymëmarrjes dhe vdekje e shpejt me dëmtime në trajtë simulimi dhe shenja të vetëmbrojtjes”. Këtë e thonë dy mjeko-ligjorët.

Tash, as këta nuk konstatojnë asgjë. Këta, pra, tregojnë se si e kanë parë këta, si e kanë konstatuar shkencërisht shkakтарin e vdekjes dhe në bazë të dëshmive tjera, si e kanë parë këta mundësinë se si ka ndodhur kjo vdekje në Burgun e Prizrenit, nuk konstatojnë.

Po, çka është këtu me rëndësi? Këtu e rëndësishme është deklarimi i Sylë Hoxhës. Ju thatë këtu “Vetëvendosja” nuk po e pranon raportin e autopsisë së tre mjekoligjorëve zyrtarë. Pra, edhe po të kishte qenë e vërtetë, ç’rëndësi ka? Pse, mos është “Vetëvendosja” duke i bërë hetimet? Jo. Çka ka lidhje çka pranon, tek e fundit, “Vetëvendosje”? Ama, Sylë Hoxha ka thënë që “unë nuk dua ta marr parasysh këtë raport”, e kjo është e rëndësishme. Se, Sylë Hoxha është në krye të hetimeve dhe ai nuk do, madje as në nivel të dyshimit, t’i trajtojë këto që i kanë thënë këta mjekë, dy mjekë të angazhuar nga familja.

Pra, ky është problemi i hetimeve, sepse qëllimisht lehet një pjesë e hetimeve, një pjesë e pistave të mundshme të hetimit, anash nga kryeprokurori i Prizrenit, në krye të këtij rasti. Po, ky është problemi që do të duhej të ju brengoste edhe juve, që po derdhni lot krokodili këtu, se si drejtësia për Astritin qenka e domosdoshme. Ja ku e keni rastin, të kërkojmë nga Prokuroria që t’i marrë parasysh të gjitha të dhënat, kjo nuk është ndërhyrje në drejtësi, tek e fundit. Ne nuk po themi “konstato kështu”, ose “konstato ashtu”. Ne nuk e parashkruajmë rrëfenjën, të cilën duam ta shtyjmë në publik. Krejt çfarë po themi është, ja ku e keni edhe një material, pse nuk e merrni parasysh, pse nuk jepni përgjegjësi për këtë, pse nuk jepni llogari për këtë, se kjo, tek e fundit, është bërë nga dy ekspertë. Tash, ju ose do ta kontestoni ekspertizën e tyre, ose të merrni për bazë të vërtetat që ata i thonë në këtë raport, që e kanë studiuar. Në këtë drejtim, mendoj që ky është njëri prej problemeve këtu.

Po, çfarë ka ndodhur gjatë kësaj kohe? U përmend këtu disa herë, se i dëgjova edhe disa prej deputetëve të Partisë Demokratike të Kosovës, që thonë se është e pafalshme, ose është e papranueshme, se si ka deklaruar edhe drejtori i Policisë ashtu dhe kërkuan, madje, në të

ardhmen kujdes të shtuar. Thua ti, kjo paska ndodhur nga pakujdesia, pra paska qenë i ngutshëm deklarimi i Nexhmi Rexhës. Kjo është ose mund të jetë e vërtetë, po çka nëse nuk është?! Çka, nëse nuk është!? Drejtori Policisë së Prizrenit, ç'rëndësi ka, po e dini për kë po flas. Po, çka nëse kjo nuk është e vërtetë? Çka, nëse tjetra është e vërtetë? Çka, nëse kjo nuk është nga pakujdesia, po është deklaratë e qëllimshme? A është marrë në pyetje ai? A është marrë në pyetje ai nga prokurori për këtë deklaratë? Pse e ka thënë? Kush ia ka thënë?

Se ju po doni të më thoni mua, që një komandant Policie është aq i padijshëm, sa që mos ta dijë që një konstatim të një vdekjeje nuk mund ta japë një orë pasi që ka ndodhur ajo, pa kurrfarë hetimi... Pra, kaq i padijshëm qenka ky komandant Policie?! Apo mund të jetë tjetra, çka nëse ai është shtyrë ta thotë një gjë të tillë dhe, nëse po, me çfarë qëllimi? Pra, a nuk ishte kjo njëra prej deklaratave fillestare, që e tregonte rrëfenjën që pushteti donte ta ndërtonte për rastin e Astritit, e cila pastaj u përcoll edhe nëpër deklaratat tjera, deri te konstatimi i Sylë Hoxhës më 18 nëntor, që vdekja paska qenë “vetëvrasje”. Pra, si vetëvrasje nisi një orë pas vdekjes, si vetëvrasje përfundoi 13 ditë pas vdekjes, pa kurrfarë argumenti, pa kurrfarë baze.

Dhe, nëse këta persona nuk janë marrë në pyetje për deklarinimet e tyre, atëherë natyrisht se hetimi është i dyshimtë. E këta persona nuk janë marrë në pyetje për deklarinimet e tyre. Askund nuk ka asnjë transparencë, asnjë informatë, se kush dhe pse është intervistuar në rastin e vdekjes së Astrit Deharit, sepse këtu tashmë po dihet, faktet nuk kanë rëndësi, e rëndësishme është çfarë po do pushteti që opinioni të besojë për rastin e Astritit. I tërë procesi i, kinse, hetimeve është zhvilluar në këtë drejtim. Prokuroria dhe Policia kanë qenë më shumë të angazhuara në propagandë publike përmes medieve të caktuara, se sa që kanë qenë të angazhuara në hetimin, hulumtimin dhe zbardhjen e së vërtetës për rastin e Astrit Deharit, sepse kështu, dorën në zemër, ishin të angazhuar në rastin e gjashtë aktivistëve të Lëvizjes “Vetëvendosje”. Pra, ka pasur konferenca, deklarime e emisione të panumërta të eksponentëve të Policisë, për të treguar se si këta gjashtë aktivistë paskan qenë ata që e kanë kryer sulmin mbi Kuvendin, ndërkohë që asnjëherë nuk janë marrë në pyetje këta gjashtë aktivistë, deri pas vdekjes së Astritit. Dhe tash, jemi në një situatë ku gjashtë persona të akuzuar për...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARI: Regjia, jepja fjalën, pesëmbëdhjetë minuta.

VISAR YMERI: Tash, janë pesë të akuzuar për terrorizëm. Të gjithë janë në arrest shtëpiak. Astriti me dy të tjerë, me Egzonin dhe Atdheun, kanë qenë duke u mbajtur në burg, ndërkohë që tre të tjerë në arrest shtëpiak. Dhe, pa ndryshuar asnjë rrethanë në procesin e hetimeve për rastin, akuzën për terrorizëm, edhe këta dy të tjerët nga paraburgimi lëshohen në arrest shtëpiak. Pra, a nuk është kjo e çuditshme, se s'ka ndryshuar asgjë, asgjë nuk ka ndryshuar në rastin, nuk është se, për shembull ta zëmë, Prokuroria pas një kohe i ka marrë të gjitha, të them kështu, raportet e

Forenzikës, mjetet e gjetura e kështu me radhë, dhe prandaj nuk ka më nevojë të mbahen ata në paraburgim, sepse tashmë i kemi mbledhur dëshmitë dhe vetëm presim procesin e ngritjes së aktakuzës. Nuk është ashtu!

Ato dëshmi që i kanë pasur më 30 gusht, që po thonë se i kanë pasur, kur i kanë arrestuar këta aktivistë, të njëjtat i kanë edhe sot. Atëherë i dërguan në burg, tash po mbajnë në arrest shtëpiak. Dhe, kjo natyrisht se është e lidhur me rastin e Astritit, sepse Astriti ishte pjesë e këtij grupi që u dërgua në burg dhe, Astriti u nxor nga burgu në arkivol. Pra, është e lidhur me rastin dhe këtu përgjegjësia e shtetit është e pashmangshme, është e drejtpërdrejtë dhe “shtetit”, po nënkuptoj “shtetit të kapur” të këtyre personave, të cilët edhe e montuan edhe gënjyen për rastin e gjashtë aktivistëve të arrestuar dhe pastaj të njëjtit u morën edhe me shkatërrimin, keqmenaxhimin e qëllimshëm të hetimit për rastin e Astrit Deharit, në mënyrë që të vijmë këtu ku jemi sot. Dhe, sot jemi në një situatë kur Kuvendi i Republikës së Kosovës, më saktësisht deputetët e Kuvendit të Republikës së Kosovës, disa prej tyre nga koalicioni qeverisës, të cilët e kanë thirrur këtë seancë vetëm e vetëm për ta shmangur mbajtjen e një seance sipas kërkesave të qytetarëve.

Kjo është, mendoj unë, pse është thirrur kjo seancë sot, jo për të kërkuar drejtësi për Astrititn, sepse e di që ju nuk jeni të interesuar në këtë drejtim, por vetëm e vetëm që të mos kërkojnë, të realizohen ose të votohen ato kërkesa të qytetarëve, të cilat janë sjellë këtu me peticion të nënshkruar. Pra, prapë, tash e kemi Kuvendin në këtë rast, kryetarin e Kuvendit me manipulimet e tij, i cili do domosdoshmërisht ta kontrollojë të vërtetën, ta kontrollojë atë që del, atë që flitet, kur flitet dhe si thuhet, siç bën me Policinë, siç bën me gjyqësorin, siç bën me ndërmarrjet publike, tash edhe me Kuvendin, të njëjtën lojë.

E pengoi, me të gjitha ato që munda, mbajtjen e një seance të thirrur nga Lëvizja “Vetëvendosje” dhe tash të njëjtën gjë po e bën, vetëm sa për ta penguar mbajtjen e një seance të thirrur nga qytetarët. Dhe, unë nuk e kuptoj pse ka nevojë për kështu manipulimi nëse çdo gjë qenka në rregull, pra nëse jeni të sigurt në rrëfenjën tuaj, pse po doni ta manipuloni rrëfenjën, pse po doni ta manipuloni të vërtetën? Sepse, po doni ta fshihni të vërtetën. Kjo është dyshimi dhe përshtypja ime. Natyrisht, se fakte për këtë nuk kam, përveç këtyre që i përmenda. Pra, më shumë po ngre dilema, se sa që po jap përgjigje, por unë mendoj që janë shumë të rëndësishme këto dilema që kam ngritur, sepse nuk bën të kalohen pa u hetuar.

Tash, hetimi i pavarur çka do të nënkuptonte? Qe besa, parakusht i një hetimi të pavarur për këtë rast është që personat që kanë qenë të përfshirë në hetimin deri tash, të mos jenë më aty, duke e përcjellë zinxhirin komandues. Pra, hetuesit e Policisë që janë marrë deri tash me rastin, të drejtuar nga ministri i Policisë apo ministri i Rendit, nuk duhet të jenë më aty. E njëjta ndodhë pastaj edhe me Shërbimin Korrektues dhe ministrin e Drejtësisë, sepse këta kanë qenë të përfshirë drejtpërsëdrejti, qoftë në ekzekutimin, qoftë në mbrojtjen politike të manipulimit të provave. Dhe tash, një hetim i pavarur nuk mund të kryhet nga ata, por nuk mund të kryhet as në

prani të tyre, kur këta e kanë pushtetin dhe mundësinë për të ndërhyrë vazhdimisht në këtë rast dhe në këtë hetim.

Parakusht i kësaj është që këta të largohen, pastaj mund të flasim për hetim të pavarur, përndryshe kështu nuk ka hetim. Kështu ka vetëm propagandë të pushtetit, për ta orientuar opinionin publik aty kah ata po duan e jo aty ku është e vërteta. Faleminderit!

KRYETARI: Bislim Zogaj e ka fjalën.

BISLIM ZOGAJ: I nderuar kryetar,

Të nderuar deputetë,

Astrit Dehari, para se të ishte i “Vetëvendosjes”, ai ishte qytetar i Kosovës. Astrit Dehari, para se të ishte i “Vetëvendosjes” ai ishte djalë i një familjeje atdhetare. Prandaj, vdekja e tij nuk ishte dhembje vetëm për “Vetëvendosjen”, ishte dhembje për tërë Kosovën, sepse kishte humbur jetën një djalë i ri dhe me perspektivë.

Madje, ky djalë rridhte nga një familje patriotike dhe kjo bënte që dhembje të ishte edhe më e madhe. Pajtohem që dhembjen më të madhe, pas familjes së Astritit, e kishte “Vetëvendosja”, sepse astriti ishte aktivist i devotshëm i “Vetëvendosjes”. Por, pavarësisht kësaj nuk kanë të drejtë, as “Vetëvendosja” e as kushdo tjetër të mundohet që në fatkeqësinë e tij të përfitojnë politikisht.

Por fatkeqësisht, ne shqiptarët që kishim disa tradita, që na i lakmonin shumë popuj të botës, në këtë pluralizëm politik i kemi humbur pothuajse të gjitha, e kemi humbur dhembshurinë, solidaritetin, sakrificën që bënim për tjetrin. Tani, të gjitha këto i kemi kthyer në interes. Megjithatë, nuk kam mundur apo nuk kam dashur të besoj, se kemi arritur deri në këtë shkallë sa edhe në fatkeqësinë e një familjeje, që tërë jetën ia kushtoi Kosovës, në vend se ta kursenim dhe ta ndihmonim në këtë fatkeqësi, ne përkundrazi, në çdo ditë po ia ngacmojmë plagën.

Prandaj, është për tu ardhur keq, se si “Vetëvendosja” ka arritur në këtë nivel, në fatkeqësinë e një familjeje kaq të devotshme të mundohet të përfitojë. Kemi dëgjuar, për një muaj e më tepër, sa akuzat i bënë në adresë të të tjerëve, kurse ato që i thotë në cilën bazë i argumenton?! Gjithherë kërkohet që ministrat të largohen, sepse ka ndodhur një vrasje apo vetëvrasje, unë megjithatë i besoj versionit zyrtar, që është vetëvrasje.

Dhe, akuzohen këta se duhet dhënë dorëheqje. Mirë, po për ato deklarata që i jepni ju, se ka qenë vrasje, por që nuk keni argumente, për mendimin tim, bindëse, kush do të japë përgjegjësi? A do ndjeheni ndonjëherë fajtorë? A do të ndjeheni përgjegjës përpara kësaj popullate që e keni terrorizuar me gjithë këto deklarata apo do të ndjeheni fajtorë edhe përpara kësaj familjeje, të

cilën fatkeqësisht e manipuluar dhe në raste të tilla, siç e thashë edhe më lart, të gjithë do ta mbronin, kurse ju e keqpërdorët duke dhënë deklarata edhe para medieëve.

Prandaj, ju lutem keni kujdes, sepse populli pret prej nesh. Mos manipuloni! Mos e shfrytëzoni foltoren për interesa personale! Ju lutem, po bëhen katër orë me demagogji nga gjysmë ore, duke folur një deputet, të shumtën e rasteve duke i përsëritur gjërat, nuk ia leni mundësinë drejtësisë. Herë në momente thoni ka drejtësi, herë s'ka drejtësi, herë i pranojmë këto institucione, herë nuk i pranojmë. Ka apo s'ka institucione?

Për mendimin tim, derisa s'ka një version tjetër zyrtar, versioni i parë është valid dhe është e drejtë e çdokujt, e mbështes plotësisht se duhet të vazhdojë të hetohet ky deri në fund, sepse çdo qytetar i Kosovës është i interesuar ta dijë realitetin për këtë rast. Por, ju lutem, mos luani me ndjenja të njerëzve, mos luani me ndjenjat e qytetarëve, mos luani me ndjenjat e asaj familjeje të nakatosur pas luftës. Ju lutem edhe një herë, keni mirëkuptim ndaj qytetarëve të Kosovës, mbi të gjitha ndaj kësaj familjeje të dëmtuar kaq shumë.

KRYETARI: Bekim Haxhiu e ka fjalën.

BEKIM HAXHIU: Faleminderit, i nderuar kryetar!

E nderuar ministre,

Të nderuar kolegë deputetë,

Fillimisht, dua të ndaj dhembjen time me familjen Dehari dhe me gjithë miqtë e familjes Dehari dhe me kolegët e Fakultetit të Mjekësisë.

Them, a është e mundur që deformimet politike dhe ambiciet për pushtet të shkojnë deri këtu, që të lëndohet kaq shumë një familje e vlerësuar dhe e respektuar, siç është familja Dehari.

Nuk do ta zgjas shumë diskutimin tim, por dua të ngre vetëm dy hipoteza apo dilema, të cilat janë ngritur në opinion për rastin.

Po flas për hipotezën e parë, a është e mundur që institucionet e hetuesisë dhe drejtësisë për qëllime politike rastin e sulmit mbi Kuvendin t'ia mveshin disa aktivistëve të "Vetëvendosjes"! A është e mundur, që Policia e Kosovës e vlerësuar si më e mira dhe më profesionalja në rajon, të merret me montime e jo me hetime? A është e mundur që pushteti për qëllime politike të manipulojë një sistem të tërë të hetuesisë, prokurorisë dhe gjyqësisë. Dhe, në fund të fundit, cili është motivi i shtetit që të ndërhyjë në vrasje apo vetëvrasje të Astrit Deharit?

Po flas tani për hipotezën e dytë, a është e mundur që për qëllime politike të shfrytëzohet një djalë i një familjeje të respektuar, e cila familje tërë qenien e vet ia përkushtoi lirisë së kombit

shqiptar dhe tani djali i tyre të indoktrinohet aq shumë sa që, hipotetakisht po them, që të godasë institucionin më të lartë të vendit.

Njëra nga hipotezat apo opinionet, apo vlerësimet, është e mundur që të jetë e vërtetë dhe unë ia lë opinionit të vlerësojë vetë të vërtetën, por gjithsesi kësaj të vërtete ne duhet edhe t'i ndihmojmë. Si t'i ndihmojmë? T'i ndihmojmë me një super-ekspertizë ndërkombëtare, të paanshme, që vërtet e vërteta dhe drejtësia të dalë në shesh. Askush nuk ka pse i frikësohet të vërtetës dhe drejtësisë. Mendoj që edhe vetë “Vetëvendosje” është e interesuar që të ketë drejtësi, prandaj nuk ka pse t'i frikësohet një super-ekspertize ndërkombëtare.

Po gjithsesi, rasti Dehari dëshmon brishtësinë e sistemit tonë të drejtësisë, i cili domosdo duhet të reformohet, duhet të reformohet edhe për atë që “Vetëvendosje” thotë se është i ndikuar nga pushteti, por edhe për atë se si u pa në rastin Dehari që është i ndikuar herë pas here edhe nga kryetari i “Vetëvendosjes” dhe nga presione tjera që vijnë nga ai dhe subjekti i tij.

Kthehemi te rasti Dehari, por dhe rastet tjera, të cilat kanë ndodhur në institucionet korrektuese. A është ky rasti i parë i vdekjes në institucionet korrektuese? Jo, sigurisht. Po ata të tjerët a kishin familje dhe cila është përgjegjësia e ndërmarrë për rastet tjera? Unë po dua ta potencoj vetëm një rast të një vdekjeje vitin e kaluar, për një të burgosur e cila ishte e sëmurë nga epilepsia dhe vdiq në burg, vdiq për shkak të sulmit epileptik të cilin e kishte pësuar gjatë qëndrimit në institucionin korrektues. Cila ishte llogaridhënia për këtë rast dhe a ishte marrë në përgjegjësi dikush? Llogaridhënie duhet të ketë edhe për të gjitha rastet tjera dhe nuk është ndërmarrë masat e duhura, qoftë për ruajtjen e shëndetit dhe mbrojtjen e jetës së të gjithë atyre që janë në institucione korrektuese.

Të nderuar kolegë deputetë,

Kjo që po them tani, është më shumë mesazh për qytetarët, se sa për ne politikanët që jemi këtu në këtë sallë. Shumë qytetarë në takimet e tyre shprehin dyshimet dhe dilemat e tyre në momente të caktuara. Çka është sot patriotizëm, atdhedashuri, në liri, kur e kemi shtetin, institucionet tona të zgjedhura dhe këto institucione të zgjedhura me votën e lirë të popullit dhe qytetarëve të saj, sepse në emër të këtij patriotizmi po tentohet të manipulohet një pjesë e rinisë. E them me plotë bindje, se sot për vendin mund të kontribuojmë nëse secili e bëjmë punën tonë me profesionalizëm deri edhe në përkushtim, nëse mjeku i përkushtohet pacientit, mësuesi i përkushtohet nxënësit, nxënësi librit, bujku tokës, inxhinieri projekteve dhe politikanët qytetarëve, ndërsa gjykatësit të mos bëjnë politikë po të ndajnë drejtësi.

Sikur të gjitha subjektet politike t'i mbështesin këto parime dhe të mos bëjnë manipulime me ndjenjat e rinisë dhe të patriotizmit të tyre, atëherë ne sot nuk do të kishim temë për debat dhe, në fund të fundit, dua t'i përgjigjem Visarit, se është e vërtetë se ai ka dëgjuar për Kadri Veselin në vitin 1999. Ne të tjerët, që kemi qenë të angazhuar në procesin e lirisë, për Kadri Veselin kemi

dëgjuar shumë më herët, në vitet e '90-ta, por atëherë Visari nuk ka qenë i angazhuar për lirinë e vendit, por ka qenë i angazhuar për kualitetin e makiatove të Londrës, prandaj edhe nuk ka mundur të dëgjojë për Kadri Veselin.

KRYETARI: Faleminderit! Jemi gati në përfundim të seancës. Zonja Deliu-Kodra e ka fjalën. I lus deputetët...

BLERTA DELIU-KODRA: Faleminderit, kryetar!

E nderuar ministre e Drejtësisë,

Të nderuar kolegë dhe kolege deputete,

Natyrisht, se edhe unë, meqë jam në fund, do t'i bashkohem ngushëllimit, meqë vdekja e bashkëqytetarit tonë Astrit Deharit, mendoj se është e rëndë jo vetëm për familjarët, por edhe për miqtë dhe bashkëpunëtorët e tij edhe për ne që sot jemi këtu në këtë sallë të Kuvendit. Me këtë rast edhe unë dua të ngushëlloj familjen Dehari, të ngushëlloj edhe të afërmit për vdekjen e Astritit.

Mendoj se të gjithë e kemi për detyrë, para së gjithash njerëzore, që të mbështesim zbardhjen e shkaqeve dhe të rrethanave të vdekjes së hershme të Astritit në Qendrën e Paraburgimit në Prizren, ajo për çfarë ne të gjithë, pa dallim, duhet të bëjmë një unitet të plotë, është që të respektojmë drejtësinë e pavarur, të respektojmë rezultatet e ekspertizës vendore mjekoligjore.

Analizat e institutit të Mjekësisë Ligjore dhe ato të prokurorisë themelore kanë konstatuar se vdekja e të ndjerit Dehari kishte ardhur si rezultat i asfiksionit mekanik, pra mbyllje ose bllokim i rrugëve të sipërme të frymëmarrjes, si pasojë e dëmtimit të vetshkaktuar, të cilat kanë qenë të shoqëruara me gjakderdhje të jashtme. Për më tepër, të nderuar kolegë deputetë, mendoj që duhet ta rikujtojmë edhe deklaratën e kryeprokurorit të Prokurorisë Themelore të Prizrenit një muaj më parë, kur është konfirmuar gjetja e autopsisit dhe të hetimeve për rastin Dehari, duke theksuar se janë marrë në pyetje gati 20 persona, 4 prej të cilëve janë rimarrë në pyetje mu për këtë rast.

Megjithatë, edhe në këtë rast jashtëzakonisht të rëndë për familjen Dehari, e cila fatkeqësisht, siç e dimë të gjithë, po përjeton dhembje e dhembje të papërshkrueshme pas humbjes së birit të tyre, Lëvizja “Vetëvendosje” nuk u kursye asnjëherë nga keqpërdorimi i kësaj tragjedie, me të cilën sot e kësaj dite po vazhdojmë të solidarizohemi, jo vetëm ne, por të gjithë qytetarët e Kosovës.

Mendoj se nuk i bën nder askujt politizimi i kësaj tragjedie, e aq më keq, nuk i bën nder që përmes rastit Dehari të tentohet që të merret aty-këtu ndonjë votë. Si mund ta kthejmë besimin tek institucionet tona, kur anëtarët e Lëvizjes “Vetëvendosje” në mënyrë permanente po i degradojnë këto institucione tona. Kujt i besojnë përfaqësuesit e Lëvizjes “Vetëvendosje”, nëse jo institucioneve tona, atëherë pse është kërkuar që të mos ketë hetim ndërkombëtar. Pse është kërkuar sot që të ndërpriten të gjitha hetimet për rastin Dehari. Në këtë seancë u kërkua që të

mos ketë më hetim të mëtutjeshëm për rastin Dehari. Unë dua të pyes këtu, kolegë deputetë, kujt i konvenon sot që të fshihet e vërteta për rastin Dehari. Apo, përfaqësuesit e Lëvizjes “Vetëvendosje” po kërkojnë prova, të cilat e konfirmojnë të vërtetën të cilën e duan vetëm ata.

Janë po këta përfaqësues, të cilët kritikuan mediet në mënyrën më të vrazhdë për shkelje të privatësisë, në mënyrën kur u publikuan pamjet nga burgu dhe kur u publikuan pjesë të ditarit të të ndjerit dhe janë po këta përfaqësues, të cilët shkelën në mënyrën më të rëndë nëpërmjet avokatit të tyre publikimin e pamjeve që terrorizuan në mënyrën më të rëndë opinionin, ku u publikuan pamjet në momentet më të rënda të rastit “Dehari”.

Të dëshpëruar nga dështimet e njëpasnjëshme shumëvjeçare për të ardhur në pushtet, drejtues të këtij subjekti politik sërish nuk befasuan, por vazhduan me grushtet e tyre të njohura ndër breza. Protagonistë të episodit të radhës së manipulimeve të “Vetëvendosjes” ishin të ashtuquajturit ekspertë të pavarur mjeko-ligjorë nga Shqipëria, të cilët hynë në vallen mashtruese, të paskrupullt të kësaj lëvizjeje, e cila i imponoi ata kinse si të angazhuar të familjes Dehari.

Të nderuar kolegë deputetë,

Si mund të thuhet se mjeko-ligjorët nga Shqipëria janë ekspertë të pavarur, pra të paanshëm, kur ata nuk janë asgjë më shumë as më pak se sa mbështetës të kësaj lëvizjeje, janë ithtarë të kësaj lëvizjeje.

Blerja e ashtuquajturve ekspertë mjeko-ligjorë nga Lëvizja “Vetëvendosje” është dëshmi e radhës se nuk ka kufij, se sa poshtë mund të shkojë kjo parti vetëm e vetëm të jetësojë epshet joreale dhe iluzore politike.

Dikush mund të pyesë si është e mundshme që personat në fjalë nga Shqipëria të jenë ekspertë të rremë, të pavarur mjeko-ligjorë. Kjo është shumë e thjeshtë.

Besim Ymaj, i cili për vite me radhë drejtoi Institutin e Mjekësisë Ligjore në Shqipëri, ndër të tjera ka aktakuzë për dëmtim të buxhetit të Shqipërisë në vlerë prej 12 milionë lekë të vjetra. E shkelje të panumërta janë regjistruar nga ai në cilësinë e drejtorit të po këtij instituti.

Për më tepër, është pikërisht Instituti i Mjekësisë Ligjore në Shqipëri që e kishte paditur Ymajin në Gjykatën e Tiranës, meqë ky i fundit nuk i kishte kthyer asnjëherë mjetet financiare.

Në mungesë të çfarëdo argumenti, siç tash jemi mësuar të shohim te Lëvizja “Vetëvendosje”, ajo sërish u përcaktua për një metodë thellësisht jokreative, kundërproduktive dhe të dëmshme vetëm e vetëm për të manipuluar me vdekjen e të ndjerit Dehari dhe dhimbjen e thellë, dhimbjen e thellë të familjes Dehari.

Duke e angazhuar kështu Ymajn, i cili sot ka një studio private mjeko-ligjore, nëpërmjet të cilit thyen të gjitha normat e etikës mjekësore që do të duhej t'i kishte ai.

Është mëkat që individë të caktuar brenda kësaj lëvizjeje, të dëshpëruar nga dështimet e pareshtura të tyre në politikë, përgjatë viteve e viteve po ngulmojnë në politikat makiaveliste, duke mos kursyer kështu metodat joetike, metodat jo të ulëta, metodat më çnjerëzore, me shpresë se kjo është rruga e duhur për të ardhur në pushtet.

Prandaj, të nderuar kolegë deputetë, edhe pse tashmë i kemi rezultatet e analizave të Institutit të Mjekësisë Ligjore si dhe ato të Prokurorisë Themelore, mendoj se, si të zgjedhur të popullit, në radhë të parë e kemi obligim që të gjithë njëzëri ta mbështesim punën e drejtësisë së pavarur, të punojmë me përkushtim për avancimin e shkallës së sigurisë nëpër të gjitha burgjet e Republikës së Kosovës dhe të sigurojmë se të gjitha qendrat e paraburgimit t'i plotësojnë standardet evropiane dhe askush në vendin tonë nuk do të duhej të guxojë të jetë aq i paskrupullt që të keqpërdorë dhembjen e rëndë që e ka pllakosur familjen Dehari për humbjen e të birit vetëm e vetëm për motive politike.

KRYETARI: Faleminderit! Urdhëroni, nëse jeni gati! E ka kërkuar fjalën Fisnik Ismajli.

FISNIK ISMAJLI: Me keqardhje se po përfundon kjo seancë me një shpifje kaq të rëndë prej zonjës Deliu, e cila i akuzoi dy patologë dhe foli veç për njërin. E për tjetrin, as nuk e ceku se tjetri, faktikisht, nuk është prej Shqipërisë. Ai është Besim Latifaj. Është një patolog, të cilin e njoh personalisht, prej Anglisë, i cili vepron në Mbretërinë e Bashkuar prej fillimit të viteve '90-ta, i cili ka mbi 6 000 autopsi, të saktësoj, në University Hospitals of North Midlands. Është ekspert, i cili është shumë i shquar në Mbretërinë e Bashkuar dhe shumë i respektuar, të cilin zonja shpifëse as nuk e përmendi, me qëllim të shpifë, ta njollosë Lëvizjen "Vetëvendosje", ashtu qysh u munduat ta njollosni "Vetëvendosjen" edhe me një copë, një pasus të vogël, të ditarit të Astritit, ku Astriti veç sa e përmend se Dardan Molliqaj ka ardhur për njëfarë vizite të vogël, dhe në asnjë rast tjetër nuk keni mundur të gjeni kurrgjë në atë ditar, me të cilin do të kishit mund ta akuzoni Lëvizjen "Vetëvendosje". Por, çka keni bërë ju? Atë pasus ia keni dhënë një medias dhe jeni munduar të shpifni dhe të duket thuajse Lëvizja "Vetëvendosje" ka ndikuar në rastin e Astritit.

E unë, po ju pyes: pse s'po keni guxim ta publikoni krejt ditarin e Astritit? A e dini pse? Sepse, me plot bindje e them, çdo fjalë që e ka shkruar ai aty bie në kundërshtim me krejt atë që ju po thoni për Lëvizjen "Vetëvendosje", përfshirë edhe këtë shpifjen e fundit që zonja në fjalë e tha sot. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Zoti Hajdar Beqa e ka fjalën!

HAJDAR BEQA: Kryetar, unë desha të flas pikërisht si reagim. U përmend ditari, e unë me sa e kam vërejtur, e kam cituar ditarin, e nuk e di a ka folur ndonjë deputet tjetër për ditarin. Dhe unë, kur e citova ditarin, thashë është i publikuar në të gjitha portalet dhe në media të Republikës së Kosovës.

Ai është ditari, e a është i madh a i vogël, nuk është shumë relevante. Mediat kanë thënë se realisht ai është ditar i të ndjerit Astrit Dehari dhe unë e citova atë çfarë është thënë në ditar.

Pra, kur zoti Dehari thotë se kur ka biseduar për faktet që janë gjetur, do të thotë nga organet e hetuesisë, zoti Molliqaj, në këtë rast sekretar apo ideatori i shumë gjërave të këqija që ndodhin në Republikën e Kosovës, i thotë: “Mos u merr ti me çështjen e fakteve, sepse me këtë çështje do të merremi ne, Lëvizja “Vetëvendosje”.

Kjo ishte në ditar. Ditarin e kam lexuar në media. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Jemi në fazën e përfundimit të debatit parlamentar lidhur me rastin tragjik të Astrit Deharit. E ftoj kryetarin e Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike të Kosovës, si iniciues i kësaj seance të jashtëzakonshme plenare, që ta marrë fjalën.

ZENUN PAJAZITI: Faleminderit, zoti kryetar!

Të nderuar kolegë deputetë,

Qytetarë të Republikës së Kosovës,

Sot debatua për një rast, siç e thamë të ndjeshëm, për një rast i cili ka shqetësuar tej mase opinionin dhe një rast i cili pa dyshim ka ngjallur kërkesat edhe të qytetarëve, edhe të deputetëve që sot të debatojmë bashkërisht.

Unë i falënderoj edhe në emër të tyre që kanë kërkuar dhe të gjithë ata të cilët sot kanë kontribuar në mënyrën e vet për të sqaruar sadopak dhe për të shprehur shqetësimin e tyre për këtë rast.

Unë nga ky debat që sot u zhvillua këtu mendoj se mund të dalim me diçka që mund të jetë e përbashkët nga ato të paktën që u nxorën si qëndrime ose deklarata që mund të përputhen nga të gjithë ne.

Sot, edhe si iniciues, propozoj të dalim me një rekomandim, prandaj edhe më lejon ta lexoj një tekst, i cili besoj se shpreh shqetësimin e shumicës nga ne.

1. Kuvendi i Republikës së Kosovës, me qëllim të mbrojtjes së Kushtetutës dhe vlerave kushtetuese të Republikës së Kosovës, edhe një herë shpreh përkushtimin e vet që në Republikën

e Kosovës të gjithë të jenë të barabartë para ligjit dhe që secili individ të gëzojë të drejtën për jetë.

2. Vdekja e shtetasit të Republikës së Kosovës, Astrit Dehari, në Burgun e Prizrenit, e cila ka sjellë reagime deri në politizim të skajshëm, duhet të zbardhet në mënyrë transparente dhe të mos u lihet hapësirë manipulimeve politike.

3. Kuvendi i fton të gjitha institucionet përgjegjëse që t'i marrin masat e duhura në kuadër të kompetencave ligjore dhe të mos lënë asnjë pikë dyshimi për këtë rast, dhe

4. Familja Dehari, në rast të dyshimeve në ekspertiza të institucioneve përgjegjëse, mund të kërkojë nga Qeveria e Kosovës të bëjë ekspertiza shtesë, edhe jashtë vendit, nga cilido vend i BE-së dhe SHBA-ja, që ajo dëshiron.

Me këtë rast Qeveria e Kosovës duhet t'i mbulojë tërësisht shpenzimet për çdo ekspertizë shtesë.

Ju lutem që ta mbështesim këtë rekomandim, në mënyrë që në njëfarë mënyre t'i japim përgjigjen si Kuvend këtij debati dhe rasti. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Fjalën e ka Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Kosovës, kryetari Ismet Beqiri.

ISMET BEQIRI: Ne jemi dakord për t'i përkrahur këto rekomandime. Faleminderit!

KRYETARI: Grupi Parlamentar i Lëvizjes “Vetëvendosje”, Shqipe Pantina, është paraqitur edhe Glauk Konjufca. Fjalën e ka Glauk Konjufca!

GLAUK KONJUFCA: Nëse mund të konstatojmë një të vërtetë objektive se qysh duhet të kontekstualizohet drejt rasti “Dehari”, pra humbja e jetës së Astrit Deharit në burgun e Prizrenit, atëherë unë do të thosha se përgjegjësia duhet të shtrohet në formën e përpjekjes së pushtetit për ta shpallur terroriste subjektin kryesor politik të opozitës. Dhe, konsekuenca e fundit e kësaj përpjekjeje është humbja në burg e jetës së Astrit Deharit.

Këto nuk janë të shkëputshme. Këto janë kompakte, janë ngjarje kompakte. Ka filluar me një tendencë politike të shpalljes së “Vetëvendosjes” si terroriste, është manifestuar me keqpërdorimin e policisë dhe për këtë ende s'ka dhënë kurrkush përgjegjësi, me keqpërdorimin e policisë, duke e shtyrë njësitin antiterror për t'u futur brenda zyrave të opozitës, brenda zyrave politike të opozitës dhe pas një viti ka kulmuar me arrestimin e 6 aktivistëve të “Vetëvendosjes” dhe të shpallur për terrorizëm. Njëri prej këtyre të 6-ëve e ka gjetur vdekjen në burgun e Prizrenit.

Këto ngjarje nuk janë fragmentare, nuk mund t'i shkëputni nga njëra-tjetra.

Është ngjarje unike. Fillon me ndërhyrjen më 28 nëntor 2015, në zyrë të “Vetëvendosjes”, me 36 pjesëtarë të njërive antiterror. Ata kanë hyrë aty në “Vetëvendosje” me pushkë të gjata dhe të gatshëm të vrasin njerëz.

Duhet të jepet përgjegjësi për një vendim politik, kush e ka marrë këtë vendim politik të thyhen zyrat e “Vetëvendosjes” më 28 nëntor 2015.

Unë mendoj se ai që është përgjegjës për thyerjen e zyrës së “Vetëvendosjes”, me garanci të plotë është përgjegjës edhe për vdekjen e Astrit Deharit në burg.

Është e njëjta përpjekje. Nuk janë ngjarje të shkëputura. Këtë duhet ta kuptoni si një proces të vetëm.

Dhe, pikërisht për këtë arsye unë konsideroj se ne këtu duhet ta votojmë një dokument alternativ, të cilin e kemi përgatitur në formë të rezolutës.

Çka përmban kjo rezolutë? Kjo rezolutë e përmban fjalë për fjalë tekstin e peticionit të 23 774 qytetarëve.

Ne konsiderojmë që kërkesat e atyre që sot po protestojnë atje në rrugë, e është shoqëria civile që e ka organizuar peticionin, të cilët edhe na e kanë dërguar një letër për të gjithë deputetët këtu të Republikës së Kosovës, e ata i kanë 3 kërkesa. 4 kanë qenë në peticion, por kërkesa e 4-t ka qenë për të mbajtur seancë të jashtëzakonshme dhe ajo tash u mbajt dhe po përfundon.

Dhe tash, më lejoni ta prezantoj rezolutën, e cila nuk është thjesht as e “Vetëvendosjes”, as e AAK-së, as e “Nismës”, por është kërkesë e qytetarëve të Republikës së Kosovës që kanë nënshkruar peticion dhe ne si opozitë jemi koordinuar të gjitha subjektet...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARI: Të nderuar kolegë deputetë, jemi në përfundim dhe nëse ka mundësi për vëmendje, ta dëgjojmë propozimin e Lëvizjes “Vetëvendosje”.

(Ndërhyrje)

Më fal! Ju e thoni. Ne e kemi një propozim që është i Partisë Demokratike të Kosovës dhe Lidhjes Demokratike të Kosovës, kurse tash e kemi një propozim të ri që është duke u lexuar nga

kolegu Konjufca dhe shpresoj e thekson ndoshta në emër të të gjitha grupeve parlamentare, e këtë nuk e di, ndoshta e qartëson. Urdhëroni!

GLAUK KONJUFCA: Pra, ne vetëm po e përfaqësojmë si grupe opozitare atë kërkesë që ka ardhur nëpërmjet peticionit dhe më lejoni t'i lexoj 3 kërkesat e peticionit.

1. Hetim i pavarur dhe transparent për rastin e vdekjes së Astrit Deharit në burgun e Prizrenit.
2. Dorëheqjen e udhëheqësve të Ministrisë së Drejtësisë dhe Ministrisë së Punëve të Brendshme për mosgatishmërinë morale e ligjore për të kërkuar dhe për të dhënë përgjegjësi për vdekjen e Astrit Deharit.
3. Fillim i menjëhershëm i ndjekjes penale të përgjegjësve që dështuan të garantojnë sigurinë e jetës së Astritit në institucionet e shtetit dhe shkarkimin e zyrtarëve përgjegjës në tërë zinxhirin hierarkik për mostrajtim të dinjitetshëm të Astritit në Qendrën e Paraburgimit edhe pas vdekjes së tij.

Kjo është kërkesën e 23 774 qytetarëve dhe unë kërkoj që sot kjo të hidhet në votim, ashtu siç na janë drejtuar edhe me letër ata.

KRYETARI: Faleminderit! Tani e ka fjalën Time Kadrijaj nga Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës. Ju kisha lutur për vëmendje!

TIME KADRIJAJ: Faleminderit, kryetar i Kuvendit!

Thamë qysh në fillim se rasti i Astrit Deharit është politizuar shumë dhe skajshmërisht, e kjo u pa edhe sot nga ky debat, i cili u karakterizua me akuza dhe kundërakuza, por megjithatë ne do ta përkrahim rezolutën që është nga shoqëria civile dhe nga nënshkrimet e qytetarëve të Kosovës.

KRYETARI: Faleminderit! Zafir Berisha nga Grupi Parlamentar “Nisma” e ka kërkuar në ndërkohë fjalën.

ZAFIR BERISHA: Faleminderit, kryetar!

Natyrisht se rezoluta, pasi u konsultuam edhe me Palin, edhe me Glaukun, është në përputhje edhe me kërkesat e qytetarëve, e gjithsesi edhe me qëndrimet tona publike deri tash, ku me theks të veçantë është kërkuar përgjegjësi nga personat përgjegjës në institucione, duke i përfshirë edhe dy ministrat. Unë i kisha ftuar kolegët edhe nga mazhoranca që të votojnë rezolutën e propozuar nga 3 subjektet politike, sepse qasja joserioze e dy partive më të mëdha tregon se kjo mbledhje është ftuar vetëm për ta plogështuar kërkesën dhe interesimin e qytetarëve për t'i nxjerrë para përgjegjësive personat që duhet të dalin para përgjegjësive dhe, për çudi, edhe kryetari i Grupit të PDK-së, ishte shumë interesant, ka bërë disa rekomandime duke ngurruar ta quajë edhe rezolutë,

por nuk e di kujt i dedikohen ato rekomandime. Apo, ndoshta vetëm e vetëm për ta përmbyllur disi këtë seancë dhe të thuhet para opinionit se, qe, ne u morëm me këtë rast. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! E keni parasysh, të nderuar deputetë! Tash i kemi dy ndarje, fatkeqësisht, e do të ishte mirë ta kishim pasur vetëm një përfundim.

Rezoluta, në bazë të Rregullores, nuk mund të aprovohet sot, edhe pse kishim dëshiruar. Pra, në bazë të nenit 52, parashtrimi i mocioneve përmbajtjesore, veçanërisht pika 2.

“Mocioni përmbajtësor nëse është rezolutë, i dërgohet Zyrës për propozime dhe parashtresa jo më vonë se 8 ditë pune para debatimit në mbledhje, përveç kur është një çështje urgjente.

Zyra për propozime dhe parashtresa e përkthen mocionin në gjuhët zyrtare të Kuvendit, e bën redaktimin dhe ua dërgon deputetëve jo më vonë se 5 ditë pune para debatit në mbledhje”.

Urdhëroni, Glauk, merreni fjalën!

GLAUK KONJUFCA: Ajo që e kemi propozuar ne, në aspektin ligjor është plotësisht e barabartë me atë që e ka propozuar Zenun Pajaziti nga Grupi Parlamentar i PDK-së dhe të cilën e përkrah edhe LDK-ja. Pse? Shiko pse!

KRYETARI: Më fal! Mos e ndërpre, Glauk! Nuk është rezolutë, ta kesh parasysh, është rekomandim, për atë arsye edhe e ndërruam.

GLAUK KONJUFCA: Po, le të jetë çfarëdo dokumenti, s’ka lidhje kjo.

KRYETARI: Por, të kihet parasysh, dhe kjo ishte arsyeja se në dokument tani kur e sollën, ua tërhoqa vërejtjen se e kanë shkruar “rezolutë”. Nuk mundet, vetëm rekomandimi mundet, ta kesh parasysh këtë. Urdhëro!

GLAUK KONJUFCA: Vetëm pak! Unë e kam për ty një pyetje si kryetar i Kuvendit.

Nëse gjendet një precedent në Kuvendin e Republikës së Kosovës që ju, si udhëheqës i Kuvendit, gjatë udhëheqjes tuaj dhe kur pikërisht keni qenë ulur në atë vend keni futur rezoluta, të cilat janë propozuar aty për aty. Pra, nëse kjo ka ndodhur gjatë udhëheqjes tuaj, a jepni ju përgjegjësi dhe a jepni dorëheqje?

KRYETARI: Në qoftë se kjo ka ndodhur ndonjëherë...

GLAUK KONJUFCA: Nëse ka ndodhur një rast gjatë mandatit tënd.

KRYETARI: Në qoftë se ka ndodhur ndonjëherë gjatë mandatit në Kuvendin e Republikës së Kosovës, më përcill se s'më ka mbetur shumë zori të jap dorëheqje apo të mbes kryetar i Kuvendit.

GLAUK KONJUFCA: Po! Por, po dua ta dish, se nëse s'na e pranon neve, atëherë je tendencioz. Po ta bëj një pyetje: nëse në këtë Kuvend të Kosovës, e unë jam shumë i sigurt dhe e di rastin saktësisht...

KRYETARI: Po, më lejo të përgjigjem, më lejo të përgjigjem, e pastaj ty prapë ta jap fjalën.

GLAUK KONJUFCA: Sepse, unë e di që ka ndodhur!

KRYETARI: Ok! Në qoftë se ka ndodhur ndonjëherë gjatë këtyre 16 vjetëve të ekzistimit të Kuvendit...

GLAUK KONJUFCA: Jo, jo! Në mandatin tënd ka ndodhur.

KRYETARI: Në mandatin tim!? Atëherë, do të ndodhë prapë!

GLAUK KONJUFCA: Jo të ndodhë prapë, por kjo nuk ka bazë në justifikimin tuaj. Nuk ka bazë...!

KRYETARI: Këtë desha ta them, jo vetëm në mandatin tim! Unë nuk po dëshiroj të bëj debat. A po më lejon ta përfundoj! Në qoftë se ka ndodhur ndonjëherë gjatë këtyre 16 vjetëve, se ju asnjëherë në këtë Kuvend s'keni mundur të merrni fjalën mbi 10 minuta. Kryetari i partisë tuaj e ka marrë diku 30 minuta.

GLAUK KONJUFCA: Ama kjo nuk ka lidhje me këtë që po dua të them.

KRYETARI: Jo, ka lidhje shumë! Sido që të jetë, nëse ka ndodhur, këtë desha ta them, do të futet edhe rezoluta juaj.

GLAUK KONJUFCA: Natyrisht se duhet të futet.

KRYETARI: Kjo ishte! Atëherë, kështu dhe më lejoni vetëm të theksoj. Kemi një rekomandim, kemi një projekt-rekomandim, të themi, dhe një rezolutë, të cilën unë do ta hedh në votim.

Nëse ka ndodhur, thjesht, më lejo, sepse duke folur ju, unë pyeta sekretarin: a ka ndodhur gjatë këtyre 16 vjetëve? Nëse një herë ka ndodhur, do të jetë prapë. Kjo është!

Glauk, unë po e lë në fjalën tënde, je publikisht. Pra, nëse ka ndodhur, se ju thatë edhe gjatë mandatit tim ka ndodhur. Pra, a ka ndodhur, veç përmende një rast, e do të ndodhë. Pra, është përgjegjësi juaja morale. Unë e thyej prapë Rregulloren. Sido që të jetë, nëse ka ndodhur, thuaje. Urdhëro!

GLAUK KONJUFCA: Nëse po do argumentim, me dokument, për 10 minuta mund ta porosis asistentin tonë të Grupit Parlamentar ta nxjerrë dokumentin dhe unë ta sjell aty, kur e paprotokolluar fare më herët, apo 24 orë apo 48 orë, vetëm propozimet janë votuar këtu, bile është votuar si në formë të rezolutës. Në formë të rezolutës është votuar, këtu, në Kuvend të Republikës së Kosovës!

KRYETARI: Glauk, faleminderit! Nëse nuk dëmtohet shteti për Rregullore të Kuvendit, edhe kështu e kam dëmtuar, kërkoj falje publikisht, e kam dëmtuar shpesh për hir të interesit qytetar.

Do të shkohet me dy votime. Po i shoh edhe disa nga kolegët deputetë... Do të shkojmë me dy votime, votohet njëra një herë, e pastaj tjetra.

Zoti Pajaziti, a ka nevojë edhe një herë ta lexojmë apo e përfunduam. Këto janë rekomandime. Pyes deputetët, a dëshironi të votojmë në mënyrë elektronike apo me ngritje të dorës?

Në mënyrë elektronike! Por, duhet të merrni pjesë, sepse nëse s'merrni pjesë mbi 60 vetë, atëherë nuk konsiderohet votim. Pra, vetëm dëmtohet procesi dhe pjesëmarrja juaj nuk merret se jeni në Kuvend.

Janë të pranishëm 71 deputetë në sallë. I kemi 90 kartela të regjistruara. Pra, 71 deputetë janë prezentë në sallë.

Pra, kolegë deputetë, jemi duke i votuar së pari rekomandimet e propozuara nga Zenun Pajaziti dhe i votojmë ato.

Lus regjinë e deputetët të përgatiten për votim të rekomandimeve dhe votojmë tash:

Faleminderit! Zotit Nuredin Ibishi, konstatuam që në fillim, nuk është duke i punuar elektronika. Le të kihet kjo parasysh. Pra, zoti Ibishi, cila është vota juaj? Jeni për!

Atëherë, me votimin e 62 deputetëve dhe të zotit Nuredin Ibishi, 49 vota janë për. Pra, 48 në mënyrë elektronike dhe vota e Nuredin Ibishi, bëjnë 49 vota.

Kanë abstenuar 13. I votuam pra rekomandimet.

E tash kalojmë në votimin e projekt-rezolutës, cila merr më shumë, ajo kalon dhe në Kuvendin e Republikës merret si e aprovuar.

Kolegë deputetë, tani jemi duke votuar projektrezolutën e propozuar dhe të lexuar nga kryetari i Grupit Parlamentar të Lëvizjes “Vetëvendosje”, Glauk Konjufca.

Lus deputetët që votimin ta bëjnë me për, kundër ose abstenim. Përndryshe, nuk merret e aprovuar. Pra, një votim duhet bërë.

Pra lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim dhe votojmë tash:

Zoti Ibishi, cili është qëndrimi juaj? Abstenim!

Atëherë, konstatojmë se 61 deputetë kanë votuar në mënyrë elektronike, plus vota e deputetit Nuredin Ibishi, 62.

Nga këto vota, 20 janë për, 17 kundër dhe 25 kanë abstenuar.

Pra, kalojmë rekomandimet e lexuara nga Zenun Pajaziti.

Pra, me këtë i mbyll punimet e kësaj seance. Faleminderit dhe mirupafshim në seancën e radhës!

*E përgatiti:
Njësia për Transkriptim dhe Lekturë*